



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 36, datë 28.01.2021

PËR

VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...}, ME QËLLIM GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatore znj. Brikena Ukperaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
KOMISIONI I VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE
VEPRIMTARISË PROFESIONALE

EKSTRAKT

RAPORT

VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL ME QËLLIM
PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT (GRADIMIN) E
GJYQTARIT {...}

**BURIMET E VLERËSIMIT DHE EVIDENTIMI I TË DHËNAVE QË
REZULTOJNË PREJ TYRE**

Në këtë pjesë të raportit të vlerësimit gjenden të listuara burimet e vlerësimit si dhe pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur dhe vetëm për aq sa është e nevojshme për këtë proces vlerësimi, të dhënat që rezultojnë nga aktet dhe dokumentet e përdorura në procesin e rivlerësimit kalimtar si dhe ato të marra rishtazi. Raporti i analizimit të aftësive profesionale të gjyqtarit, përgatitur nga organi kompetent në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, duke qenë një akt që përshkruan të dhënat e burimeve të vlerësimit dhe analizon gjetjet që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre, konsiderohet, për efekt gradimi, i barasvlershëm me raportin analitik, vetëm për burimet në të cilat ai referon.

POLI I DREJTËSISË

RRUGA “ANA KOMNENA”

TIRANË

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në nenin 171 pika 5 dhe 77 të Ligjit për Statusin, përbëhen nga dy grupe:

Grupi I : Aktet dhe dokumentet e përdorura në vlerësimin e aftësive profesionale nga organet e rivlerësimit të listuara si më poshtë:

1. Formulari i vetë deklaramit të gjyqtarit i cili administrohet në dosjen e rivlerësimit¹ dhe është përshkruar dhe analizuar në mënyrë të plotë si burim vlerësimi në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit {...} me nr. 3125/4 prot, datë 5.6.2018².

2. Të dhënat e dosjes personale të gjyqtarit e cila është administruar gjatë përgatitjes së Raportit për analizimin e aftësive profesionale me nr. 3125/4 prot, datë 5.6.2018 në kuadër të procesit të rivlerësimit duke u analizuar si burim vlerësimi në këtë raport.

3. Të dhënat statistikore për periudhën e vlerësimit³;

Referuar të dhënave statistikore për periudhën e vlerësimit tetor 2013-tetor 2016, administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se :

Gjatë periudhës së vlerësimit gjyqtari {...} ka ushtruar detyrën në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Gjatë kësaj periudhe, rezultojnë të dhënat statistikore si më poshtë, për çdo vit kalendarik:

Për vitin 2013 (7.10.2013-31.12.2013), gjyqtari ka përfunduar gjithsej 15 çështje nga të cilat 3 penale themeli dhe 12 masa sigurimi.

Për vitin 2014 (1.1.2014-31.12.2014), gjyqtari ka përfunduar 103 çështje nga të cilat 14 penale themeli, 1 kërkesë për sekuestro parandaluese, 79 masa sigurimi dhe 9 kërkesa penale.

Për vitin 2015 (1.1.2015-31.12.2015), gjyqtari ka përfunduar 52 çështje nga të cilat 9 penale themeli, 1 kërkesë për sekuestro parandaluese, 22 masa sigurimi dhe 20 kërkesa penale.

Për vitin 2016 (1.1.2016-7.10.2016) gjyqtari ka përfunduar 47 çështje, nga të cilat 9 penale themeli, 2 kërkesa për sekuestro preventive, 1 kërkesë për konfiskim pasurie, 22 masa sigurimi dhe 13 kërkesa penale.

5. Dosjet e përzgjedhura me short në procesin e rivlerësimit kalimtar (5 dosje), të përshkruara në mënyrë të detajuar në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të ish/Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë⁴, **si më poshtë:**

Dosja 1 - Çështja penale me nr. 180 regjistri, datë regjistrimi 24.11.2014, ndaj të pandehurve Augusto Priori, Vera Martinaj dhe Pavlin Fusha, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Trafikim i narkotikëve” në tentativë dhe “Moskallëzim krimi”, parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 22 dhe 300 të Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 145, datë 15.12.2014.

¹ Faqe 64 deri 73 e dosjes së rivlerësimit;

² Faqe 2368-2400 e dosjes së rivlerësimit;

³ Të dhëna statistikore të administruara në faqet 312-318 të dosjes së rivlerësimit.

⁴ Faqe 6 - 11 të Raportit, faqe 289-594 të dosjes së rivlerësimit;

Dosja 2 - Çështja penale me nr. 72 regjistri, datë regjistrimi 8.1.2015, ndaj të pandehurës Lendita Tallamishi, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Trafikim i narkotikëve”, në tentativë, parashikuar nga neni 283/a/1 dhe 22 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 40, datë 6.3.2015.

Dosja 3 - Çështja penale me nr. 49/201 regjistri, datë regjistrimi 4.12.2015, ndaj të pandehurve Mario Gjyzari dhe Gentian Guda, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Trafikim i narkotikëve”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/a/2-22 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 47, datë 7.4.2016.

Dosja 4 - Çështja me nr. 17 regjistri, datë regjistrimi 19.6.2016, me objekt “Caktimin e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive për pasurinë e paluajtshme kullotë prej 220 ha në Karaburun, si dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme të derivuara prej saj” e përfunduar me vendimin nr.11, datë 20.7.2016.

Dosja 5 - Çështja penale me nr. 411 regjistri, datë regjistrimi 20.8.2014, me objekt “Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” ndaj të dyshuarit Koxha Ismailaj për veprën penale “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, parashikuar nga neni 109/b i Kodit Penal”, përfunduar me vendimin nr. 411, datë 21.8.2014.

6. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim⁵ si më poshtë:

Vendimi 1 - Vendimi nr. 144, datë 11.12.2015 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me nr. regjistri 154, datë regjistrimi 29.7.2015, ndaj të pandehurve Muhamet Demrozi akuzuar për kryerjen e veprave penale “Trafikimi i narkotikëve”, në bashkëpunim, mbetur në tentativë parashikuar nga nenet 283/a/2-22 të Kodit Penal dhe “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, Bashkim Demrozi dhe Agim Demrozi, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i narkotikëve”, në bashkëpunim, mbetur në tentativë parashikuar nga nenet 283/a/2-22 të Kodit Penal.

Vendimi 2 -Vendimi nr. 51, datë 200.4.2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me nr. regjistri 12/127, datë regjistrimi 10.6.2015, ndaj të pandehurit Cesar Augusto Pelaez Triana, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i narkotikëve”, në bashkëpunim, mbetur në tentativë parashikuar nga nenet 283/a/2-22 të Kodit Penal.

Vendimi 3 -Vendimi nr. 5, datë 27.4.2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me nr. regjistri 01/14, me datë regjistrimi 28.4.2015, me kërkes/paditës Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, të paditur Kastriot Ismailaj dhe shoqëria “Adriatic Development Corporation LTD”, me objekt “*Konfiskimin e llogarive bankare të shtetasit Kastriot Ismailaj dhe shoqërisë Adriatic Development Corporation LTD.....*”.

⁵Vendimet e paraqitura nga gjyqtari së bashku me formularin e vetë deklarimit për aftësitë profesionale janë administruar në dosjen e rivlerësimit dhe janë përshkruar në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të përgatitur nga Inspektorati i KLD-së, faqe 6 deri 9 e Raportit, faqe 267-419 e dosjes së rivlerësimit.

6. Vendime të administruara për shkak të ankesave ose kryesisht nga organet e rivlerësimit që i përkasin periudhës së vlerësimit 2013-2016.

Në dosjen e dërguar nga organet e rivlerësimit, e cila përmban aktet e vlerësimit profesional të gjyqtarit, nuk rezulton të jenë administruar vendime gjyqësore të gjyqtarit {...}, për shkak të ankesave të publikut apo të marra kryesisht nga organet e rivlerësimit kalimtar, të cilat i përkasin periudhës së vlerësimit 2013-2016.

Lidhur me denoncimet nga publiku, referuar vendimit të KPK, rezulton se : *“Ndaj subjektit të rivlerësimit, z. {...}, janë depozituar 7 denoncime nga publiku...”*. Pasi ka marrë në shqyrtim faktet objekt denoncimi, për të shtatë rastet, KPK konkludon, në lidhje njërin prej tyre, se :*“Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin bashkangjitur këtij denoncimi, vlerëson se ankuesi gjatë gjithë deklarimit i referohet subjektit B. D. dhe nuk përmend subjektin e rivlerësimit, z. {...}, nuk jep asnjë indicie apo prova, që ta lidhë me çështjen në fjalë.”* (denoncimi 1). Në lidhje me gjashtë denoncimet e tjera, në vendimin e KPK, konkludohet në mënyrë të njëjtë se :*“Komisioni vlerëson se nuk ka indicie apo prova që mund të çojnë në një vlerësim negativ të subjektit të rivlerësimit në lidhje me vlerësimin profesional.”* (denoncimi 2,3,4,5,6,7)⁶.

Në vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me verifikimet kryesisht të kryera, parashtrohet se: *“...Komisioni, nisur nga disa indicie të tjera për sa i përket aspektit profesional ka konsideruar të arsyeshme të bëjë hetime të mëtejshme për verifikimin e disa çështjeve penale në ngarkim të disa shtetasve. Për këtë qëllim Komisioni ka kryer korrespondencë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, si dhe me Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda...”*. Për tre verifikimet e kryera kryesisht nga KPK, nuk ka rezultuar që gjyqtari {...} të ketë qenë pjesë e trupit gjykues ndaj personave për të cilët janë kryer verifikime.

7. Të dhëna nga burimet arkivore të KLD/KLGJ;

Referuar Raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit me nr. 3125/4 prot, datë 5.6.2018, rezulton se : *“Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013- 8 tetor 2016”, për gjyqtarin {...} janë paraqitur 2 ankesa (në vitin 2014) në Inspektoratin e KLD-së. Dy ankesat e paraqitura në vitin 2014 verifikuar bazuar në raportin periodik të vetë kryetarit në lidhje me vendimet e cenuara, i janë regjistruar gjyqtarit për vlerësim profesional dhe etik. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin {...} përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.”*

Në lidhje me dy ankesat për të cilat referon Raporti si më sipër, në aktet e dosjes së rivlerësimit nuk rezulton të jenë administruar të dhënat e plota për trajtimin e tyre. Për këtë arsye, është kërkuar nga arkiva e KLGJ-së, informacion dhe dokumentacion lidhur me trajtimin e ankesave dhe është administruar kopje e relacioneve të inspektoratit të KLD-së lidhur përfundimin e verifikimeve përkatëse si dhe urdhrat/vendimet për përfundimin e verifikimit të ankesave, akte të

⁶Vendimi i KPK nr. 227, datë 17.1.2020, faqe 60-63;

cilat janë bërë pjesë e dosjes së vlerësimit të gjyqtarit. Nga përmbajtja e dokumentacionit për verifikimin dhe trajtimin e ankesave, rezulton si më poshtë:

Materiali 1 – Me relacionin e datës 3.10.2016 të Inspektoratit të KLD, miratuar nga Kryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë më datë 16.12.2016, është trajtuar materiali i ardhur nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda dhe Gjykata e Lartë, lidhur me cenimin e disa vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, bazuar në urdhrin e verifikimit me nr. 3419/5 prot, datë 02.06.2014.

Vendimi i parë i trajtuar në këtë relacion është ai me nr. 13, datë 28.1.2013 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, i cili i përket çështjes penale me nr. 16/99, datë regjistrimi 15.10.2012, ndaj të pandehurit Artur Gjini, akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 278/a/1 i Kodit Penal. Kjo çështje është gjykuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Flora Hajredinaj (kryesuese), {...}, Gurali Brahimllari, Bardhyl Dhama, Luan Hasneziri (anëtarë). Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në përfundim të gjykimit, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit për veprën penale të parashikuar nga neni 278/a/1 dhe dënimin e tij me 7 vjet burgim. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda me vendimin nr. 23, datë 21.3.2013 ka vendosur ndryshimin e këtij vendimi dhe dënimin e të pandehurit për veprën penale të parashikuar nga neni 278/a/1 në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal, dënimin e tij me 7 vjet burgim si dhe uljen e dënimit me 1/3 për shkak të gjykimit të shkurtuar. Gjykata e Lartë me vendimin nr. 134, datë 20.7.2015 ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda duke ndryshuar masën e dënimit.

Objekt i verifikimit dhe analizës në raportin e Inspektorëve ka qenë disponimi i gjykatave lidhur me kërkesën e të pandehurit për procedim me gjykim të shkurtuar, kërkesë e cila nuk është pranuar nga gjykata e shkallës së parë ndërkohë që është pranuar nga gjykata e apelit.

Pas analizës së fakteve dhe citimit të konkluzioneve të vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë me nr. 2, datë 29.1.2003, vendimit të Gjykatës Kushtetuese me nr. 4, datë 01.2.2012, dhe vlerësimit të fakteve objekt verifikimi në raport me këto dy vendime, konkludohet se: *“..Për sa më sipër, duke marrë në konsideratë faktin që Gjykata e Lartë ka aplikuar gjykimin e shkurtuar duke zbritur dënimin për të pandehurin me 1/3, çmohet se aplikimi ose jo i tij është atribut i gjykatës që ka në shqyrtim çështjen sipas vendimeve të sipërcituara. Në këtë kontekst nuk konstatohet shkelje e vendimit unifikues nr.2, datë 29.1.2003 nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, por cenimi i vendimit të tyre duhet t’u mbahet në konsideratë gjyqtarëve për efekt të vlerësimit etiko profesional.”.*

Vendimi objekt verifikimi, nëpërmjet raportit si më sipër, mban datën 28.1.2013 dhe si i tillë, bën pjesë në periudhën e vlerësimit 2013- 2016. Pavarësisht se relacioni i datës 3.10.2016 i Inspektoratit të KLD, nuk është pjesë e dosjes së dërguar nga organet e rivlerësimit, ai përbën burim vlerësimi për efekt të procesit të gradimit, në zbatim të nenit 77 shkronja “dh” të Ligjit “Për Statusin”, sipas të cilit, të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj magjistratit gjatë periudhës së vlerësimit, konsiderohen burim vlerësimi. Ky burim vlerësimi referon vetëm në faktin e cënimit të vendimit nga një gjykatë më e lartë dhe si i tillë merrej parasysh në vlerësim, sipas parashikimeve të nenit 23 pika 1 shkronja “c” të Vendimit Nr. 261/2 dt.

14.04.2010 të ish/KLD “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”. Por ndryshe nga burimet e sistemit të mëparshëm të vlerësimit, Skema e re e Vlerësimit të Gjyqtarëve, e cila zbatohet në rastin konkret, nuk i parashikon si burim më vete vlerësimi, vendimet e cënuara nga gjykatat më të larta. Skema e Re e Vlerësimit ruan pavarësinë e gjyqtarit, prandaj vetëm përqindja e vendimeve të cënuara nga gjykata më e lartë, nuk përbën tregues për efekt të vlerësimit të aftësive profesionale në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit.

Vendimi i dytë i trajtuar është ai me nr. 69, datë 14.11.2012 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Klodian Kurushi (kryesues), {...}, Nertina Kosova, Iliriana Olldashi dhe Luan Hasneziri (anëtarë). Në këtë vendim gjykata ka rrëzuar kërkesën e të dënuarit për revokim të dënimit me gjobë. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda me vendimin nr. 1, datë 7.1.2013, duke interpretuar parimin e zbatimit të ligjit penal favorizues, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 69, datë 14.11.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda duke pranuar kërkesën e të dënuarit dhe duke revokuar vendimin e dënimit të tij me gjobë. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 450, datë 03.04.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit.

Në raportin e Inspektoratit të KLD, pasi analizohet situata e faktit dhe e ligjit, konkludohet se :”...2. *Cenimi i vendimit nr.69, datë 14.11.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda duhet të mbahet në konsideratë gjyqtarëve : Klodian Kurushi, {...}, Nertina Kosova, Iliriana Olldashi dhe Luan Hasneziri, për efekt të vlerësimit etiko profesional të tyre së bashku me analizën e mësipërme.*”.

Vendimi i cili ka qenë objekt verifikimi nëpërmjet raportit si më sipër, mban datën 14.11.2012 dhe si i tillë, nuk bën pjesë në periudhën e vlerësimit tetor 2013- tetor 2016. Por edhe nëse ky vendim do t’i përkiste periudhës së vlerësimit, në Ligjin nr.96/2016 dhe aktet nënligjore që plotësojnë Skemën e Vlerësimit, përqindja e vendimeve të cënuara nga gjykatat më të larta në kuadër të shqyrtimit të ankimit të palëve, nuk përbën një tregues për efekt të vlerësimit profesional të gjyqtarit.

Materiali 2 – Me relacionin e datës 16.12.2014 të Inspektoratit të KLD-së, miratuar nga Zëvendëskryetari më datë 30.12.2014, është verifikuar dhe trajtuar informacioni i ardhur nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda lidhur me cenimin e disa vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda bazuar në urdhrin e verifikimit nr.2498/2 prot, datë 26.11.2014. Një ndër vendimet e trajtuara në procedurën e verifikimit është vendimi nr. 40, datë 24.03.2014 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët {...} (kryesues), Dritan Hallunaj, Fran Prendi, Nertina Kosova dhe Klodian Kurushi (anëtarë). Në këtë vendim gjykata ka vendosur deklarimin fajtor dhe dënimin e të pandehurit për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/2 në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal.

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda me vendimin nr. 48, datë 15.05.2014 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë përse i përket cilësimit ligjor dhe deklarimit fajtor të të pandehurit duke ndryshuar vendimin për pjesën tjetër, duke dënuar të pandehurin për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/2 në lidhje me nenin 22 dhe 23/2 të Kodit Penal, dhe

uljen e dënimit për shkak të aplikimit të nenit 406 të K.Pr.P. Palët kanë ushtrua rekurs dhe deri në momentin e hartimit të relacionit nga Inspektorati nuk rezulton të ketë pasur një vendimmarrje të Gjykatës së Lartë.

Rezulton se shkak i ndryshimit të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nga Gjykata e Apelit ka qenë mospranimi prej sa i kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar, kërkesë e cila është vlerësuar e drejtë nga Gjykata e Apelit. Në lidhje me faktin objekt verifikimi, në Raportin e Inspektoratit, pasi parashtrihen pjesë të arsyesimit të vendimit të të dy gjykatave, vlerësohet se :”...Mospranimi i kësaj kërkesë nga gjykata e shkallës së parë nuk përbën shkelje të vendimit unifikues, për sa kohë që gjykata ka vlerësuar se çështja nuk mund të zgjidhet në gjendjen që ishin aktet, duke marrë edhe shpjegime dhe prova kryesisht si pyetja e dëshmitarit, kryerja e ekspertimit tahografik, referuar neneve 366,367 dhe 178 të K.Pr.P. Ndërkohë që gjykata e apelit vlerëson të kundërtën se marrja e këtyre provave, administrimi i të cilave nuk ka ndikuar mbi akuzën dhe aktet e vlefshme në funksion të provueshmërisë së saj, të cilat ishin pranuar edhe nga i pandehuri Berhami, mohimi i të drejtës për të proceduar sipas rritit të gjykimit të shkurtuar dhe në tërësi përfitimi ligjor i procesit duke përfshirë këtu ekonominë gjyqësore, vijën në vazhden e mosrespektimit të të drejtave dhe garancive ligjore që ligji procedural penal i ka njohur të pandehurit në procesin penal, pra nuk është shkak për të rrëzuar kërkesën për gjykim të shkurtuar. Për sa sipër, çmohet se nuk ka shkelje të vendimit unifikues nr.2/2003 nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe fakti që Gjykata Kushtetuese i ka dhënë të drejtë Gjykatës së Apelit të shqyrtojë vendimin e rrëzimit të kësaj kërkesë, kjo jo domosdoshmërisht do të thotë se është shkelur vendimi unifikues, pasi pranimi i kërkesës për gjykim të shkurtuar është më tepër atribut i vlerësimit të gjykatës dhe vendimi unifikues nuk ka përcaktuar rastet kur pranohet ose jo por e ka lënë të hapur interpretimin nga vetë gjykata rast pas rasti, kur vlerësohet prej tyre se çështja nuk mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet dhe që shërben për ekonomi gjyqësore, pra kur hetimi është i plotë dhe nuk ka dyshime rreth provave, fajësisë apo pafajësisë së të pandehurit. Në këto kushte vendimi i cënuar t’u mbahet në konsideratë gjyqtarëve për efekt të vlerësimit të tyre profesional dhe etik...Për sa më sipër, konkludohet se:....c) Cënimi i vendimit nr. 40, datë 24.03.2014 ti evidentohet gjyqtarëve {...}, Dritan Hallunaj, Fran Prendi, Nertina Kosova, Klodian Kurushi për efekt të vlerësimit profesional dhe etik të tyre.”.

Vendimi i cili ka qenë objekt verifikimi nëpërmjet raportit si më sipër, mban datën 24.03.2014 dhe si i tillë, bën pjesë në periudhën e vlerësimit 2013- 2016. Duke iu referuar përmbajtjes dhe konkluzioneve të relacionit, rezulton se nuk janë konstatuar shkelje në vendimmarrjen e gjykatës, pjesë e së cilës, në cilësinë e kryesuesit është edhe gjyqtari {...}. Vetëm referimi për t’u mbajtur në konsideratë si numër vendimi i cënuar nga gjykata më e lartë në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, bazuar në Ligjin nr.96/2016 dhe aktet nënligjore që plotësojnë Skemën e Vlerësimit, nuk përbën tregues për efekt të vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit.

Sa më sipër, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, gjatë së cilës ka filluar dhe përfunduar verifikimi nga Inspektorati i KLD-së, për dy vendimet e parashtruara në materialin 1 në të cilat gjyqtari ka pasur rolin e anëtarit, si dhe gjatë së cilës ka përfunduar gjykimi i 1 çështje të parashtruar në materialin 2, çështje në të cilën gjyqtari ka pasur rolin e kryesuesit të trupit gjykues, nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe analizuara në relacionet përkatëse, nuk

rezultojnë të dhëna që mund të analizohen dhe vlerësohen në drejtim të cënimit të etikës apo që mund të përdoren për vlerësimin e aftësive profesionale, pasi ato referohen vetëm si fakt që ndikon në përqindjen e vendimeve të cënuara, të cilat nuk përbëjnë burim më vete vlerësimi.

Referuar akteve të dosjes së rivlerësimit si dhe dosjes personale të gjyqtarit {...}, nuk rezulton që gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016, të jetë dhënë apo zbatuar masë disiplinore ndaj tij.

8. Të dhëna për pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese në periudhën e vlerësimit.

Referuar akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit dhe vërtetimit me nr. 454/1 prot datë 18.10.2016 të Shkollës së Magjistraturës, rezulton se gjyqtari është angazhuar në aktivitete trajnuese si me poshtë:

- Në cilësinë e ekspertit në Programin e Formimit Vazhdues në 11 aktivitete trajnuese, gjithsej 15 ditë, të zhvilluara në datat 9 tetor 2013, 21 mars 2014, 26 maj 2014, 11 qershor 2014, 2 dhjetor 2014, 3 dhjetor 2014, 16 dhe 17 dhjetor 2014, 23 dhe 24 prill 2015, 11 dhe 12 maj 2015, 2 dhe 3 nëntor 2015 dhe 7 prill 2016.

- Në cilësinë e pjesëmarrësit në Programin e Formimit Vazhdues në 15 aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 24 ditë trajnimi;

Rezultun gjithashtu se gjyqtari ka marrë pjesë në 21 aktivitete profesionale, gjithsej 50 ditë, jashtë Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës të cilat, rezultojnë të jenë aktivitete të formimit profesional si dhe aktiviteteve ndërinstitucionale të tilla si vizita studimore, mbledhje ekspertësh, tryeza të rumbullakëta, etj.

9. Raport për analizimin e aftësive profesionale përgatitur nga Inspektorati i KLD-së, për subjektin e rivlerësimit {...} me nr. 3125/4 prot, datë 5.6.2018, faqe 2368-2400 e dosjes së rivlerësimit. Pjesa përshkuese dhe analiza e gjetjeve në këtë akt nuk përsëriten në raportin e vlerësimit. Për çdo element të nevojshëm të analizës dhe vlerësimit, ky raport vlerësimi referon drejtpërdrejt në përmbajtjen e Raportit përkatës.

10. Vendimi nr. 227, datë 17.1.2020 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit⁷.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, pasi ka parashtruar dhe analizuar burimet e vlerësimit në lidhje me aftësitë profesionale të gjyqtarit⁸, etikën, kriterin e vlerësimit të figurës dhe pasurisë, ka konkluduar si vijon: “...*Trupi gjykues, referuar nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV, të nenit 51, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit, z. {...}*”:

a. ka kryer deklaram të mjaftueshëm dhe të saktë të pasurisë;

⁷ Vendimi nr. 227, datë 17.1.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka marrë formë të prerë për shkak të mosankimimit më datë 10.8.2020.

⁸ Vendimi i KPK nr. 227, datë 17.1.2020, faqe 51-64.

b. nga analiza financiare rezulton se me të ardhurat e fituara nga punësimi tij dhe i personit të lidhur me të, si dhe huatë ka pasur burime të mjaftueshme dhe të ligjshme financiare për kryerjen e investimeve dhe të shpenzimeve të deklaruar.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. {...}, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. {...}, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë” duke arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a, të ligjit nr. 84/2016.

Bazuar në këto konkluzione, si dhe nga vlerësimi tërësor i procedurave, në kuptim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, nga vlerësimi i secilit prej tri kriterëve: a. ka arritur nivel të besueshëm të pasurisë, sepse nuk ka kryer fshehje të pasurisë, nuk ka kryer deklaram të rremë, ka kryer deklaram të mjaftueshëm dhe të saktë të pasurisë, si dhe nuk rezulton me balancë financiare negative për vitet 2003 – 2016, duke përmbushur kushtet ligjore të germës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016; b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas nenit 59/b, të ligjit nr. 84/2016; c. konsiderohet “i aftë”, në vlerësimin e aftësive profesionale duke përmbushur kushtet ligjore të germës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.⁹”.

Grupi II : Çështjet e përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështje themeli me palë kundërshtare) si më poshtë:

Dosja 6¹⁰ (1) - Çështja penale me nr. 03/04/08/20/61 regjistri, datë regjistrimi 23.4.2010, ndaj të pandehurit Ilir Taraj, akuzuar për veprat penale “Trafikimi i personave” dhe “Vrasje me dashje”, parashikuar nga nenet 110/a/3 dhe 76 të Kodit Penal, , përfunduar me vendimin nr. 74, datë 26.3.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Çështja është regjistruar në datë 23.4.2010 dhe me shortin e datës 27.4.2010 i është caktuar gjyqtarit {...} në cilësinë e kryesuesit. Më urdhrin e datës 27.4.2010 është formuar trupi gjykues me pesë gjyqtarë për gjykimin e çështjes.

Me vendimin e datës 27.4.2010, pas caktimi me short, çështja është vënë në lëvizje nga gjyqtari kryesues duke caktuar seancën gjyqësore më datë 14.5.2010 dhe urdhëruar njoftimin e palëve (Prokurori, i pandehuri, mbrojtësi i të pandehurit). Për njoftimin e të pandehurit, duke marrë në konsideratë faktin që ai është hetuar në mungesë, gjyqtari ka urdhëruar njoftimin nëpërmjet shërbimeve të policisë gjyqësore të vendbanimit të njohur të tij, në përputhje me parashikimet e nenit 140 të K.Pr.P, nëpërmjet një urdhri të posaçëm në të cilin përshkruhen në mënyrë të detajuar veprimet që duhet të kryhen për njoftimin e rregullt të të pandehurit.

Janë zhvilluar gjithsej **107 seanca gjyqësore**, të cilat janë dokumentuar nëpërmjet procesverbalit të seancës gjyqësore të mbajtur nga sekretarja gjyqësore.

⁹Po aty, faqe 63-64.

¹⁰ Dosjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit, numërtohen në vijim të 5 dosjeve të përzgjedhura për procedurën e rivlerësimit kalimtar, vetëm për efekt referimi të tyre në raport.

Seancat e datave 14.5.2010, 21.5.2010, 4.6.2010, pas verifikimit të paraqitjes së palëve dhe relatimit të akteve të njoftimit të palëve në proces dhe mbrojtësve të të pandehurit, janë shtyrë përkatësisht për të bërë të mundur pjesëmarrjen e prokurorit në seancë, përsëritjen e njoftimit për të pandehurin si dhe për të mundësuar prezencën e mbrojtësve të të pandehurit. Për çdo seancë, pas relatimit të akteve të njoftimit, është disponuar me vendim për veprimet procedurale që duhet të kryhen me qëllim njoftimin efektiv të të pandehurit si dhe njoftimin e prokurorit dhe mbrojtësve të të pandehurit, shoqëruar me aktet e njoftimit të cilat janë të plota dhe të detajuara lidhur me mënyrën e realizimit të njoftimit për të pandehurin në përputhje me parashikimet e nenit 140 të K.Pr.P.

Seanca e datës 18.6.2010, pas verifikimit të paraqitjes së palëve, relatimin e njoftimeve për të pandehurin dhe legjitimitetit të mbrojtësve të zgjedhur me prokurë nga familjarët e tij, ka vijuar me marrjen e vendimit për zhvillimin e gjykimit në mungesë në referim të nenit 351 të K.Pr.P. Pas këtij momenti seanca ka vijuar me shpalljen e gjykatës dhe dhënien e fjalës palëve për të parashtruar kërkesat paraprake. Seanca është shtyrë pas kërkesës së mbrojtësve për të pandehurit për t'u njohur me aktet e dosjes.

Seancat e datave 24.6.2010, 9.7.2010, 16.7.2010, janë shtyrë për të mundësuar përsëritjen e njoftimit të mbrojtësve të të pandehurit, për shkak të mosparaqitjes së tyre. Gjykata në secilën seancë, pasi ka relatuar lidhur me dijeninë dhe aktet e njoftimit për mbrojtësit, ka vendosur shtyrjen e seancës gjyqësore duke mos disponuar për zëvendësimin e mbrojtësve për shkak se ishin mbrojtës të zgjedhur me prokurë të posaçme, shkak i cili është relatuar në çdo vendimmarrje. Seanca e datës 16.7.2010, është shtyrë për në datë 14.9.2010, për shkak të pushimeve vjetore në muajin Gusht si dhe për faktin se gjykata është vënë në dijeni për arrestimin e të pandehurit me qëllim ekstradimi në shtetin e Spanjës.

Seancat e datave 14.9.2010 dhe 29.9.2010, janë shtyrë për të mundësuar përsëritjen e njoftimit të mbrojtësve të të pandehurit, për shkak të mosparaqitjes së tyre.

Në seancën e datës 12.10.2010, pasi verifikohet prezencja e palëve, gjykimi ka vijuar me dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve. Gjykata ka shqyrtuar kërkesën e mbrojtësve të të pandehurit për shpalljen e pavlefshmërisë së vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër për deklarimin e moskompetencës lëndore për gjykimin e çështjes (*gjykata paraprakisht në këtë seancë ka relatuar vendimin e Gj.Rr.Gj.Gjirokastër për deklarimin e moskompetencës lëndore dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente*). Gjykata, pasi është tërhequr në dhomë këshillimit, ka marrë vendim për ngritjen e mosmarrëveshjes së kompetencës në Gjykatën e Lartë, duke urdhëruar njoftimin e këtij vendimi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër si dhe duke përcaktuar të drejtën dhe afatin e ankimit ndaj këtij vendimi. Në dosje administrohet vendimi i zbardhur dhe i arsyetuar me nr. 61, datë 12.10.2010 për ngritjen e mosmarrëveshjes së kompetencës në gjykimin e çështjes.

Në seancën e datës 26.1.2011, caktuar pas dërgimit të vendimit të Gjykatës së Lartë lidhur me konfliktin e kompetencës, seanca ka vijuar me relatimin e vendimit me nr. 00-2010-1372, datë 8.11.2010 dhe vijohet me verifikimin e paraqitjes së palëve. Pas relatimit të mosparaqitjes së

mbrojtësve të të pandehurit, gjykata ka relatuar njoftimin me datë 12.7.2010 për arrestimin e të pandehurit në shtetin e Spanjës me qëllim ekstradimin. Pasi ka dëgjuar prokurorin, ka disponuar për shtyrjen e seancës, njoftimin e mbrojtësve si dhe kërkimin nga Zyra e Interpol Tirana të informacionit mbi fazën në të cilën ndodhej procedura e ekstradimit të të pandehurit si dhe vendndodhjen e tij në shtetin e Spanjës.

Seancat e datave 9.2.2011, 22.2.2011, 4.3.2011, 18.3.2011, 30.3.2011, 27.4.2011 dhe 11.5.2011, janë shtyrë për të mundësuar përsëritjen e njoftimit e mbrojtësve të të pandehurit si dhe pritjen e përgjigjes dhe/ose përsëritjen e kërkesës drejtuar Interpol Tirana në lidhje me procedurën e ekstradimit dhe vendndodhjen e të pandehurit në shtetin e Spanjës si dhe për ti lënë kohë prokurorit, me kërkesë të tij, për të marrë informacion nga Prokuroria e Përgjithshme lidhur me ecurinë e procedurave të ekstradimit të të pandehurit.

Në seancën e datës 25.5.2011, pas verifikimit të paraqitjes së palëve dhe relatimit të akteve të njoftimit, seanca është shtyrë për të njoftuar mbrojtësit e të pandehurit dhe njëkohësisht, në zbatim të neneve 142, 509 të K.Pr.P dhe nenit 3 dhe 15 pg 6, të Konventës së Këshillit të Evropës “Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën penale” dhe protokollet shtesë të saj, është disponuar për dërgimin e letër porosisë për autoritetet spanjolle, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, lidhur me ecurinë e procedurës së ekstradimit të të pandehurit si dhe vendin e ndalimit të tij.

Seancat e datave 9.6.2011, 24.6.2011, 30.6.2011, 8.7.2011, janë shtyrë, pas verifikimit të paraqitjes së palëve dhe relatimit të akteve të njoftimit dhe korrespondencës me Ministrinë e Drejtësisë, përkatësisht për shkaqe të tilla si mos formimi i trupi gjykues, për të pritur përgjigjen e Ministrisë së Drejtësisë lidhur me letër porosinë, njoftuar avokatët e të pandehurit, plotësimin e kërkesës për dërgimin e letër porosisë të kërkuar nga M.D (lidhur me përkthimin). Në seancën e datës 8.7.2011 është caktuar përkthyesi i gjuhës spanjolle me qëllim përkthimin e akteve objekt letër porosie, sipas kërkesës së M.D. Në këtë seancë është caktuar përkthyesi duke respektuar parashikimet e nenit 126/2 të K.Pr.P, duke u realizuar përkthimi i akteve brenda të njëjtës ditë (duke i lënë përkthyesit kohën e nevojshme për të kryer detyrën), dhe është disponuar për shtyrjen e seancës me qëllim dërgimin e letër porosisë dhe njoftimin e avokatëve. Seanca është shtyrë për në datë 12.9.2011 duke respektuar afatin e përcaktuar nga Konventa për ekzekutimin e letër porosisë.

Seancat e datave 12.9.2011, 26.9.2011, 11.10.2011, 26.10.2011, 10.11.2011, 23.11.2011, 7.12.2011, 21.12.2011, 27.12.2011, 11.1.2012, 25.1.2012, 3.2.2012, 17.2.2012, 15.3.2012, 29.3.2012, 13.4.2012, 26.4.2012, 11.5.2012, 23.5.2012, 6.6.2012, 19.6.2012, 3.7.2012, pas verifikimit të paraqitjes së palëve dhe relatimit të akteve të njoftimit, janë shtyrë për mos formimin të trupit gjykues (një seancë) , mosparaqitjes së prokurorit (një seancë) dhe për të përsëritur njoftimin për M.D, lidhur me ekzekutimin e letër porosisë së dërguar nga gjykata. Në disa seanca relatohet korrespondenca me M.D dhe informacioni i ardhur prej saj lidhur me ekzekutimin e letër porosisë.

Në seancën e datës 17.7.2012, pas verifikimit të paraqitjes së palëve dhe relatimit të akteve të njoftimit, gjykata ka vendosur të ridërgojë edhe njëherë letër porosinë në drejtim të autoriteteve

spanjolle, për shkak të mos njoftimit për ekzekutimin e letër porosisë së parë për një periudhë të gjatë kohe.

Seancat e datave 10.9.2012, 20.9.2012, 4.10.2012, 18.10.2012, 22.10.2012, pas verifikimit të paraqitjes së palëve dhe relatimit të akteve të njoftimit, janë shtyrë përkatësisht për shkak të mosformimit të trupit gjykues (3 seanca), mosparaqitjes së prokurorit (1 seancë), pritjes së informacionit lidhur me ekzekutimin e letër porosisë si dhe dhënies kohë avokatit të ri të të pandehurit për t'u njohur me aktet.

Në seancën e datës 30.10.2012, pas verifikimit të paraqitjes së palëve, është relatuar përgjigja e ardhur nga Ministria e Drejtësisë lidhur me ekzekutimin e letër porosisë drejtuar autoriteteve spanjolle sipas të cilës ka rezultuar se i pandehuri është lënë i lirë për shkak të mosparaqitjes së kërkesës për ekstradimin e tij brenda afatit. Pasi janë dëgjuar palët, gjykata ka shtyrë seancën gjyqësore me qëllim kryerjen e njoftimit për të pandehurin si dhe kërkimin e tij sipas parashikimeve të neneve 140 dhe 141 të K.Pr.P, duke iu drejtuar autoriteteve përkatëse të policisë së shtetit.

Seanca e datës 14.11.2012, pas verifikimit të paraqitjes së palëve dhe relatimit të përgjigjeve të ardhura nga instancat përkatëse të policisë së shtetit lidhur me njoftimin dhe kërkimin e të pandehurit, është shtyrë në referim të neneve 342/2 dhe 348 të K.Pr.P duke urdhëruar kërkimin e të pandehurit, pasi është vlerësuar se veprimet nuk janë kryer konform dispozitave procedurale dhe urdhërimit të gjykatës.

Seancat e datave 27.11.2012 dhe 12.12.2012, pas verifikimit të paraqitjes së palëve, relatimit të akteve për njoftimin e të pandehurit, dhe legjitimitit të mbrojtësit të caktuar nga familjarët me tagrat e mbrojtësit kryesisht sipas parashikimeve të nenit 49/5 të K.Pr.P si dhe deklarimit të mungesës së të pandehurit në referim të nenit 351 të K.Pr.P, janë shtyre për të përsëritur njoftimin (seanca e parë) dhe për ti dhënë kohë prokurorit për t'u njohur me kërkesat paraprake të paraqitura me shkrim nga mbrojtësi i të pandehurit.

Seancat e datave 19.12.2012, 28.12.2012, 11.1.2013, 24.1.2013, pas verifikimit të paraqitjes së palëve dhe relatimit të njoftimeve, janë shtyrë përkatësisht për shkak të mosparaqitjes së avokatit për shkaqe shëndetësore (2 seanca), mosparaqitjes së prokurorit dhe për t'i lënë kohë prokurorit të ri të caktuar për përfaqësimin e organit të akuzës për t'u njohur me kërkesat paraprake të paraqitura nga mbrojtja e të pandehurit.

Seancat e datave 30.1.2013, 13.2.2013, 27.2.2013 dhe 13.3.2013, pas verifikimit të paraqitjes së palëve, janë shtyrë me kërkesë të prokurorit (2 seanca), për t'i lënë kohë për të marrë mendimin e Prokurorisë së Përgjithshme lidhur me kërkesat e mbrojtësit të të pandehurit si dhe për të pritur përgjigjen përkatëse nga Prokuroria e Përgjithshme, për mënyrën e procedimit lidhur me kërkesat me natyrë komplekse të paraqitura nga mbrojtja lidhur sa i përket kompetencës dhe elementë të tjerë proceduralë të çështjes si dhe për shkak të mosparaqitjes së prokurorit (një seancë).

Seanca e datës 21.3.2013, pas verifikimit të paraqitjes së palëve, ka vijuar me parashtrimin e qëndrimit të prokurorisë lidhur me kërkesat e mbrojtësit të të pandehurit dhe kërkesat e paraqitura nga prokurori në këtë fazë. Më pas gjykata është shprehur me vendim në lidhje me kërkesat paraprake të mbrojtësit dhe të prokurorit, duke parashtruar edhe arsyet mbi të cilat mbështetet disponimi për secilin kërkim. Pas këtij momenti prokurori ka kërkuar të ndryshojë akuzën ndaj të pandehurit duke kërkuar kohë për të paraqitur një kërkesë të re për gjykim si dhe listën e provave që kërkohet të merren në mbështetje të akuzës. Pasi është dëgjuar qëndrimi i mbrojtësit, gjykata ka shtyrë seancën gjyqësore për t'i dhënë kohë prokurorit për t'u përgatitur me shkrim për akuzën e re ndaj të pandehurit me qëllim njoftimin e këtij të fundit.

Në seancën e datës 28.3.2014, pas verifikimit të paraqitjes së palëve, seanca ka vijuar me paraqitjen e akuzës së re me shkrim nga ana e prokurorit, marrjen e mendimit të mbrojtësit dhe më pas, bazuar në nenet 372, 376, 132/2 të K.Pr.P, seanca është shtyrë duke urdhëruar njoftimin e të pandehurit për ndryshimin e akuzës, komunikimin e një kopje të ekstraktit të procesverbalit të seancës, urdhërimin e Prokurorisë për të bërë njoftimin e akuzës për të pandehurin si dhe për ti lënë kohë avokatit të tij për të përgatitur prapësimet me shkrim lidhur me akuzën e re ndaj të pandehurit.

Seancat e datave 8.4.2013, 23.4.2013, 2.5.2013, 14.5.2013 dhe 21.5.2013, 28.5.2013, 5.6.2013 dhe 14.6.2013, pas verifikimit të paraqitjes së palëve, relatimit të akteve të njoftimit dhe kërkesave të palëve në proces, janë shtyrë përkatësisht për ti dhënë kohë prokurorit për të mundësuar njoftimin e akuzës të pandehurit (2 seanca), për mosparaqitje të mbrojtësit (4 seanca), mosparaqitje të prokurorit (1 seancë) dhe mos formim të trupit gjykues (1 seancë).

Seanca e datës 21.6.2013, pas verifikimit të paraqitjes së palëve, relatimit lidhur me njoftimin e akuzës të pandehurit, ka vijuar me dëgjimin e prapësimeve të mbrojtjes lidhur me akuzën e ndryshuar ndaj të pandehurit. Më pas është deklaruar i hapur shqyrtimi gjyqësor, i është dhënë fjala prokurorit për të parashtruar faktin dhe provat që kërkon të merren në gjykim, është dëgjuar mbrojtja dhe është disponuar me vendim për lejimin e paraqitjes së provave të kërkuara nga palët. Pasi i është dhënë fjala prokurorit për përcaktimin e radhës së marrjes së provave, seanca është shtyrë për të mundësuar njoftimin e dëshmitarëve për tu paraqitur në seancë.

Seanca e datës 5.7.2013 është shtyrë për shkak të mosformimit të trupit gjykues, duke urdhëruar përsëritjen e njoftimit për dëshmitarët që nuk ishin paraqitur në seancë.

Seancat e datave 11.7.2013, 22.7.2013, 9.9.2013, 17.9.2013, 27.9.2013, 7.10.2013, 17.10.2013, 29.10.2013, 8.11.2013, 18.11.2013, 27.11.2013, 2.12.2013, 13.12.2013, 23.12.2013, 6.1.2014, kanë vijuar me pyetjen e dëshmitarëve, duke disponuar sipas kërkesave të palëve, me vendime të ndërmjetme për lejimin e kundërshtimit të dëshmitarëve në referim të nenit 362 të K.Pr.P, lejuar leximin e deklarimeve të dëshmitarëve gjatë hetimit sipas parashikimeve të nenit 369/3 të K.Pr.P, etj., dhe shtyrjen e tyre për të bërë të mundur njoftimin dhe prezencën e dëshmitarëve në seancë si dhe për të shkak të mosparaqitjes së mbrojtësit (6 seanca) dhe mosparaqitjes së prokurorit (1 seancë). Në çdo rast në të cilin seancat janë shtyrë për të mundësuar apo përsëritur njoftimin e dëshmitarëve, gjyqtari ka urdhëruar marrjen e masave për të mundësuar njoftimin ose shoqërimin e tyre duke dërguar njoftimet apo urdhrat e shoqërimit në organet përkatëse. Seanca

e datës 6.1.2014, pas marrjes së dëshmisë së dëshmitarëve të paraqitur në këtë seancë, si dhe marrjen e provave shkresore, është shtyrë me kërkesë të mbrojtësit të të pandehurit, për t'i lënë kohë për te përcaktuar provat që kërkon të merren në gjykim.

Në seancën e datës 14.1.2014, pas verifikimit të paraqitjes së palëve, gjykata kë dëgjuar kërkesën e mbrojtësit për marrjen e provave duke lejuar me vendim marrjen e tyre dhe seanca është shtyrë për të bërë të mundur njoftimin e dëshmitarëve të kërkuar nga mbrojtja.

Seancat e datave 24.1.2014, 4.2.2014, 12.2.2014, 25.2.2014, 12.3.2014, 18.3.2014, kanë vijuar me përsëritjen e njoftimeve për thirrjen e dëshmitarëve të mbrojtës dhe marrjen e dëshmive të tyre në seancë, për të siguruar prezencën e mbrojtësit të të pandehurit (1 seancë), mos formim të trupit gjykues (1 seancë). Në seancën e datës 18.3.2014, gjykata pas përfundimit të marrjes së provave me dëshmitarë të kërkuara nga mbrojtja, ka disponuar me vendim në lidhje me kërkesat e avokatit përkryerjen e ekspertimit grafik si dhe mospranimin e kërkesës për marrjen e një dëshmie. Pasi i është dhënë fjala palëve për të parashtruar nëse kanë prova apo kërkime të tjera në dobi të gjykimit, seanca është shtyrë për ti dhënë palëve kohë për diskutimin përfundimtar me shkrim.

Seanca e datës 1.4.2014, është shtyrë për shkak të mosparaqitjes së prokurorit dhe mbrojtësit të të pandehurit, seanca e datës 7.4.2014 për shkak të mosparaqitjes së avokatit të të pandehurit, ndërsa në seancën e datës 14.4.2014, pas verifikimit të paraqitjes së palëve, prokurori ka kërkuar ri çeljen e hetimit gjyqësor me qëllim plotësimin e akuzës ndaj të pandehurit. Pasi është dëgjuar mbrojtësi, i cili ka kërkuar kohë për tu shprehur lidhur me këtë kërkesë, seanca është shtyrë për ti lënë kohë mbrojtësit duke urdhëruar njoftimin e akuzës së re ndaj të pandehurit në bazë të nenit 376 të K.Pr.P.

Në seancën e datës 23.4.2014, pas verifikimit të paraqitjes së palëve dhe relatimit të aktit të njoftimit të akuzës në drejtim të të pandehurit, janë dëgjuar kërkesat e mbrojtjes dhe qëndrimi i prokurorit lidhur me to, seanca është shtyrë për t'i lënë kohë avokatit për të përgatitur qëndrimin lidhur me akuzën e re të njoftuar të pandehurit.

Në seancën e datës 5.5.2014, pas verifikimit të paraqitjes së palëve, është dëgjuar qëndrimi i mbrojtësit lidhur me akuzën e re si dhe kërkesa e tij për të kryer verifikime lidhur me vdekjen e viktimës. Pasi është marrë mendimi i prokurorit, gjykata ka vendosur të pranojë kërkesën e mbrojtjes duke shtyrë seancën gjyqësore me qëllim marrjen e informacionit nga Zyra e Gjendjes Civile lidhur me vendbanimin e fundit të viktimës, nëse figuron i vdekur apo i zhdukur, etj.

Seanca e datës 19.5.2014, pas verifikimit të paraqitjes së palëve dhe administrimit të shkresës së dërguar nga ZGJC, është shtyrë për të kryer verifikime në një zyrë tjetër të gjendjes civile ku rezulton i regjistruar viktimia. Seanca e datës 29.5.2014 është shtyrë për të bërë të mundur njoftimin e mbrojtësit të të pandehurit i cili nuk është paraqitur, ndërsa në seancën e datës 5.6.2014, pas verifikimit të paraqitjes së palëve, janë lexuar aktet e ardhura nga ZGJC lidhur me informacionin e kërkuar nga gjykata të cilat janë administruar në dosjen gjyqësore dhe janë ftuar palët për të paraqitur diskutimin përfundimtar. Pasi janë dëgjuar konkluzionet me shkrim të

prokurorit, seanca është shtyrë për t'i dhënë kohë mbrojtësit për paraqitjen e diskutimit përfundimtar me shkrim.

Seanca e datës 16.6.2014 është shtyrë për shkak të mosparaqitjes së mbrojtësit ndërsa në seancën e datës 23.6.2014, pas verifikimit të paraqitjes së palëve, është dëgjuar diskutimi përfundimtar i mbrojtjes dhe, pas deklarimit të mbyllur të shqyrtimit gjyqësor gjykata është tërhequr në dhomë këshillimi për të marrë vendimin përfundimtar, vendim i cili është shpallur në po këtë seancë, duke përfunduar gjykimi i çështjes.

Vendimi përfundimtar me nr. 74, datë 23.6.2014 përmban pjesën hyrëse ku evidentohet gjykata, koha dhe vendi i zhvillimit të gjykimit, palët dhe përfaqësuesit e tyre, gjeneralitetet e të pandehurit, masa e sigurimit ndaj tij, gjykimi në mungesë, mbrojtësi, akuza dhe kërkimet përfundimtare të palëve.

Në pjesën përshkruese arsyetuese rezulton të jetë ndjekur një strukturë e organizimit të vendimit në nënndarje ku secila përmban titullin përkatës dhe përmbajtjen sipas titullit.

Pjesa e parë e titulluar “Rrethanat procedurale të çështjes”, përshkruan në mënyrë kronologjike ecurinë procedurale nga momenti i regjistrimit të saj për shkak të shpalljes së mos kompetencës lëndore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, procedurës së ndjekur për njoftimin e të pandehurit duke përshkruar ezaurimin e të gjitha mundësive procedurale për njoftimin e tij, duke evidentuar edhe shkakun kryesor për kohëzgjatjen e gjykimit si dhe detyrimin për të respektuar parashikimet e neneve 140-142 të K.Pr.P për njoftimin e të pandehurit. Në këtë aspekt referohet edhe neni 33 pika 2 i Kushtetutës në të cilin parashikohet se nuk përfiton nga e drejta për tu dëgjuar personi që i fshihet drejtësisë. Gjyqtari përshkruan veprimet procedurale të ndjekura për njoftimin e të pandehurit, shkaqet e vendimmarrjes për zhvillimin e gjykimit në mungesë të tij duke referuar në parashikimet e nenit 351 të K.Pr.P dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese duke cituar pjesë të vendimit nr. 30, datë 17.6.2010 në lidhje e legjitimitimit e mbrojtësve të zgjedhur nga familjarët e të pandehurit dhe tagrat e tyre në gjykim.

Më pas evidentohet ecuria procedurale e çështjes sa i përket kërkimeve të palëve lidhur me kompetencën lëndore për gjykimin e saj, vendimmarrja e gjykatës për ngritjen e konfliktit të kompetencës si dhe vendimmarrja e Gjykatës së Lartë që ka disponuar mbi këtë konflikt duke vlerësuar se kompetente për gjykimin e çështjes është Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Pas rifillimit të gjykimit të çështjes, parashtrahet ecuria e gjykimit duke u evidentuar veprimet procedurale të gjykatës për njoftimin e të pandehurit si dhe marrjen e informacionit për ecurinë e procedurës së ekstradimit të tij, dërgimin e letër porosisë nga gjykata, përgjigjen e ardhur nga autoritetet spanjolle si dhe vendimmarrja e gjykatës për të njoftuar të pandehurin pranë vendbanimit të njohur të tij në Shqipëri si dhe vendimi për zhvillimin e gjykimit në mungesë të tij. Sërish në këtë vendimmarrje gjyqtari evidenton qartë procedurat e njoftimit, bazën ligjore dhe arsyet e vendimmarrjes së saj për zhvillimin e gjykimit në mungesë, duke referuar sërish në praktiken e Gjykatës Kushtetuese, konkretisht në vendimin nr. 30/2010. Në këtë pjesë të vendimit gjyqtari evidenton se vendimmarrja për zhvillimin e gjykimit në mungesë është marrë duke patur parasysh edhe frymën e akteve ndërkombëtare rekomanduese apo detyruese për

gjykimin në mungesë si dhe deklarimin e dy prindërve të të pandehurit, të pyetur si dëshmitarë në seancë, të cilët kanë deklaruar se kanë komunikuar me të pandehurin duke e vënë në dijeni për gjykimin që zhvillohet ndaj tij nga kjo gjykatë.

Pjesa e dytë e titulluar “Rrethanat e faktit”, përshkruhet ecuria procedurale e çështjes duke filluar me momentin e regjistrimit të saj pranë Prokurorisë për Krime të Rënda për shkak të deklarimit të mos kompetencës territoriale fillimisht nga Prokuroria e Rrethit Lezhë ku është paraqitur kallëzimi nga babai i viktimës dhe më pas nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër e cila ka gjykuar çështjen për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal, dhe më pas në përfundim të gjykimit ka ndryshuar kualifikimin ligjor të faktit penal duke deklaruar mos kompetencën dhe urdhëruar dërgimin e akteve në gjykatën kompetente. Gjithashtu parashtrohet vendimmarrja e Gjykatës së Lartë lidhur me konfliktin e kompetencës së ngritur nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda si dhe akuza e re e ngritur nga Prokuroria gjatë gjykimit. Gjithashtu në këtë pjesë të vendimit gjen pasqyrim të qartë dhe në rend kronologjik, ecuria e ngjarjes gjatë së cilës ka ndodhur fakti penal objekt akuze.

Në pjesën e tretë të titulluar “Provat e marra gjatë shqyrtimit gjyqësor”, parashtrohen në mënyrë të strukturuar provat e marra gjatë gjykimit duke cituar në rastin e provave me dëshmitarë, vetëm pjesët të cilat kanë rëndësi thelbësore. Në paraqitjen e dëshmive të marra gjatë gjykimit, rezulton se ato janë strukturuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke cituar vetëm pjesë të tyre si dhe duke evidentuar në disa raste edhe pyetjet që i janë drejtuar dëshmitarëve, në dobi të qartësisë të përgjigjes së dhënë prej tyre e cila citohet ndërsa pjesa tjetër e dëshmive e cila nuk citohet, përshkruhet nga gjyqtari duke evidentuar faktet që kanë rezultuar prej tyre. Gjithashtu, i kushtohet rëndësi pasqyrimit të kundërshtimit të dëshmive të lejuara gjatë gjykimit dhe fakteve në të cilat ka konsistuar kundërshtimi i bërë.

Dëshmitë, pavarësisht citimit të tyre në pjesë të veçanta dhe me rëndësi për të provuar faktin objekt akuze, rezulton se janë organizuar dhe renditur në vendim në mënyrë logjike dhe në shërbim të fakteve të cilat synojnë të provojnë, duke ndjekur kronologjinë e ngjarjes si dhe provueshmërisë së elementëve të cilësuar thelbësore të cilët gjyqtari i ka evidentuar me kujdes, të tilla si rrethanat e largimit të viktimës nga qyteti i tij në drejtim të shtetit grek, komunikimin telefonik me familjarët pas largimit, rrethanat e udhëtimit të viktimës dhe personave të tjerë drejt shtetit grek, identifikimin e të pandehurit si autori veprës penale, rrethanat e identifikimit të tij dhe veprimet procedurale të kryera nga punonjësit e policisë gjatë paraqitjes për njohje nëpërmjet fotografisë të kryer në vitin 2006, etj. Organizimi dhe paraqitja e dëshmive ndjek rrjedhë logjike dhe është bërë në mënyrë të tillë që ti shërbejë fakteve të evidentuara si thelbësore nga gjykata në raport me faktin penal.

Më pas arsyetimi vijon me paraqitjen, përshkrimin dhe analizën e provave shkresore të administruara gjatë gjykimit, duke evidentuar edhe faktet për të cilat provat shkresore shërbejnë në drejtim të provueshmërisë së ngjarjes dhe autorësisë së të pandehurit, paraqitjen dhe analizën e provave të marra me kërkesë të mbrojtjes së të pandehurit, si dhe provat shkresore të kërkuara nga mbrojtja lidhur me faktin se viktimja e veprës penale rezulton i gjallë sipas akteve të gjendjes civile të administruara nga autoritetet e gjendjes civile të vendbanimit të tij.

Në pjesën e katërt të titulluar “Pretendimet e mbrojtjes së të pandehurit”, paraqiten në mënyrë të strukturuar të gjitha pretendimet e avokatit të të pandehurit lidhur me akuzën e ngritur nga prokuroria, mungesën e provueshmërisë së saj, mungesën e provueshmërisë së autorësisë së të pandehurit në lidhje me dy veprat penale për të cilat akuzohet, mungesën e provueshmërisë së pasojës në lidhje me vrasjen e të pandehurit, paligjshmërinë e procedurës së paraqitjes për njohje të kryer ndaj të pandehurit nëpërmjet fotografisë. Pretendimet e mbrojtjes në këtë pjesë paraqiten në mënyrë të detajuar dhe të strukturuar por nuk analizohet në lidhje me besueshmërinë ose jo të tyre, pasi ato merren në analizë në pjesën vijuese të arsyetimit të vendimit.

Në pjesën e pestë të titulluar “Analiza e faktit dhe e provave”, gjyqtari bën një analizë të mirëfilltë të provave duke i gërshetuar ato me njëra tjetrën dhe duke evidentuar peshën provuese të tyre në raport me faktin penal objekt akuze ndaj të pandehurit si dhe autorësinë e tij. Në këtë pjesë gjykata risjell pretendimet e mbrojtësit të të pandehurit, duke i integruar dhe analizuar në mënyrë të plotë në pjesën përkatëse ku analizohet prova apo fakti përkatës në mbështetje të të cilit ato analizohen. Analiza ligjore përqendrohet në mënyrë të veçantë në provueshmërinë e elementëve të të dy veprave penale për të cilat akuzohet i pandehuri, duke u risjellë dhe analizuar së bashku provat përkatëse në lidhje me secilin element të domosdoshëm të veprave penale për të cilat procedohet dhe veprimet e të pandehurit në drejtim të realizimit të tyre. Analiza e integruar e provave në drejtim të të provuarit të faktit objekt akuze, përmbillet me konkluzionin e gjykatës lidhur me provueshmërinë ose jo të elementëve të secilës vepër penale për të cilën akuzohet i pandehuri duke konkluduar se provohen plotësisht elementët e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal dhe se nuk provohen elementët e anës objektive dhe subjektive të veprës penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal.

Në pjesën e gjashtë të titulluar “Analiza ligjore mbi cilësimin juridik të veprës” gjyqtari analizon elementët e veprave penale për të cilat procedohet, duke integruar rrethanat e faktit të provuara në gjykim në raport me elementët e figurës së secilës vepër penale në mënyrë të veçantë. Citohet dhe analizohet neni 110/a i Kodit Penal, duke referuar dhe cituar edhe parashikimin e nenit 3 të protokollit 3 të Konventës së Palermos dhe Konventës së Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore” në lidhje me dhënien e kuptimit të trafikimit të qenieve njerëzore. Në dhënien e kuptimit të këtij koncepti sipas legjislacionit shqiptar, gjyqtari referon përputhjen e legjislacionit penal shqiptar me Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër kimit të organizuar dhe protokolleve shtesë të saj. Me tej arsyetimi vijon me evidentimin dhe analizën e objektit të përgjithshëm të veprës, objektit të drejtpërdrejtë dhe objekti dytësor të saj. Më pas analizohet ana objektive, ana subjektive dhe subjekti i veprës penale konkrete.

I kushtohet rëndësi saktësimi dhe evidentimit të zbatimit të ligjit të kohës në të cilën ka ndodhur vepra penale, duke zbatuar parimin e veprimit të ligjit penal në kohë, duke evokuar dhe analizuar normat penale, sipas ligjit të kohës kur ka ndodhur vepra penale dhe parashikimit të së njëjtës vepër në kohën e zhvillimit të gjykimit, duke konkluduar për zbatimin e ligjit penal favorizues sipas parashikimeve të nenit 3 të Kodit Penal.

Më pas arsyetimi ligjor vijon me analizën e elementëve të veprës penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal, analizë e cila ndërthuret me faktin e provuar në gjykim, duke konkluduar se

nuk provohet fakti që i dëmtuari të ketë ndëruar jetë dhe për pasojë, nuk provohet kryerja e kësaj vepre penale prej të pandehurit.

Në pjesën e shtatë të titulluar “Konkluzion”, gjyqtari parashtron konkluzionin e arritur lidhur me fajësinë e të pandehurit për veprën penale të parashikuar nga neni 110/a/3 të Kodit Penal, duke vijuat më pas me evidentimin e rrethanave që ndikojnë në caktimin e llojit dhe masës së dënimit, duke i renditur ato në mënyrë konkrete në lidhje me të pandehurin (*rrezikshmëria e veprës penale, rrezikshmëria e të pandehurit, faktin që i pandehuri i është fshehur drejtësisë, mënyrën e kryerjes së veprës penale nëpërmjet keqtrajtimit dhe veprimeve jo humane si dhe braktisjen e të pandehurit në gjendje të rënduar shëndetësore, faktin që i dëmtuari rezulton i zhdukur edhe në kohën e zhvillimit të gjykimit*).

Pas renditjes së të gjithë elementëve që ndikojnë në masën e dënimit, gjyqtari ka përcaktuar masën e dënimit të vlerësuar si të përshtatshme për të pandehurin në raport me veprën për të cilën ai është gjetur fajtor si dhe përcaktohet koha e fillimit të vuajtjes së dënimit për të pandehurin në mungesë si dhe momenti i fillimit të së drejtës së ankimit.

Pjesa urdhëruese e vendimit, pas përcaktimit të bazës ligjore në të cilën vendosen nenet e KPrP lidhur me disponimin e gjykatës, si dhe nenet e Kodit Penal që përbëjnë veprat penale për të cilat akuzohet i pandehuri, vijon me disponimet e gjykatës lidhur me fajësinë e të pandehurit për veprën penale të parashikuar nga neni 110/a/3 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 20 vjet burgim, deklarimin e pafajshëm të të pandehurit për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal duke përcaktuar edhe arsyen e deklarimit të pafajshëm të tij, për shkak se fakti nuk ekziston. Më pas përcaktohet koha e fillimit të vuajtjes së dënimit, disponimi për shpenzimet procedurale, e drejta, afati, koha e fillimit të afatit të ankimit dhe gjykata kompetente pranë të cilës mund të ushtrohet kjo e drejtë.

KONKLUZIONE

- Janë zhvilluar gjithsej 107 seanca gjyqësore. Seancat gjyqësore janë dokumentuar rregullisht në procesverbal dhe për çdo seancë është arsyetuar shtyrja për shkaqe të përligjura të cilat, në pjesën më të madhe të tyre lidhen me shkaqe procedurale të tilla si : kryerja e njoftimit të të pandehurit duke respektuar në mënyrë rigorozë dispozitat procedurale për njoftimin e rregullt të tij, pritja për kthimin e përgjigjes për letërporosinë e dërguar drejt autoriteteve spanjolle lidhur me ekstradimin e të pandehurit, garantimin e paraqitjes së prokurorit dhe mbrojtësit të të pandehurit në seancë, mos formim të trupit gjykues, njoftimin e dëshmitarëve, dhënien kohë palëve për tu përgatitur lidhur me ecurinë e gjykimit, kryerjen e procedurave të njoftimit të ndryshimit të akuzës dhe për ngritjen e një akuzë të re gjatë gjykimit, etj.
- Gjykimi ka zgjatur 3 vite e 11 muaj, tej standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime).
- Çështja është menaxhuar në mënyrë korrekte nga gjyqtari. Seancat janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afateve të parashikuara në nenin 342/2 të K.Pr.P, përveç kohës së pritjes për t’u shprehur Gjykata e Lartë lidhur me konfliktin e kompetencës, pushimeve vjetore të gjykatës në muajin Gusht si dhe kohës së pritjes për të marrë përgjigje për ekzekutimin e letër porosisë drejtuar 2 herë autoriteteve të shtetit të Spanjës.

- Gjykimi ka ndjekur të gjitha hapat procedurale të shqyrtimit gjyqësor, me procedurën e gjykimit të zakonshëm. Vendimet e ndërmjetme të gjykatës për drejtimin e procesit gjyqësor dhe shtyrjen e seancave gjyqësore, përmbajnë në çdo rast bazën ligjore procedurale dhe arsyetim të detajuar të disponimit të gjykatës lidhur me ecurinë e gjykimit, kërkesat e palëve, shkaqet e shtyrjes dhe masave të urdhëruar për të garantuar zhvillimin e seancës vijuese, etj.
- Vendimi i arsyetuar përmban elementët e domosdoshëm të vendimit përfundimtar të dënimit dhe pafajësisë për një të akuzuar, sipas një strukture standarde që ndjek gjyqtari, të qartë dhe të organizuar në mënyrë korrekte dhe logjike. Pjesa arsyetuese e vendimit është e strukturuar në nënndarje, përmban analizën e detajuar të faktit, provave dhe arsyetimin e gjykatës në lidhje me ekzistencën e veprës penale, autorësinë e të pandehurit, provueshmërinë e fakteve thelbësore si dhe individualizimin e dënimit. Analiza ligjore shoqërohet me referencën në dispozitat ligjore procedurale ose materiale, sipas rastit, në aktet ndërkombëtare të zbatueshme në shtetin shqiptar dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.
- Dosja gjyqësore është e plotë dhe e rregullt, aktet procedurale janë renditur në mënyrë logjike, sipas kategorisë (aktet procedurale të shortit, formimit të trupit gjykues, vendimet për caktimin e seancës gjyqësore, njoftimet dhe shkresat e kryera gjatë gjykimit, provat shkresore, kërkesat me shkrim dhe diskutimi përfundimtar i palëve, procesverbalet e seancave gjyqësore dhe vendimi gjyqësor përfundimtar) dhe në rend kronologjik (sipas datave ose momentit të paraqitjes së tyre) brenda së njëjtës kategori aktesh.

Dosja 7 (2) -Çështja penale me nr. 132 regjistri, datë regjistrimi 28.10.2013, ndaj të pandehurit Ylli Iljazi, akuzuar për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve”, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a/1-22 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 104, datë 2.12.2013 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Çështja është regjistruar në datë 28.10.2013 dhe me shortin e datës 29.10.2013 i është caktuar gjyqtarit {...} në cilësinë e kryesuesit. Më urdhrin e datës 29.10.2013 është formuar trupi gjykues me pesë gjyqtarë për gjykimin e çështjes.

Me vendimin e datës 29.10.2013, në të njëjtën ditë të caktimi me short, duke respektuar afatin procedural të parashikuar nga neni 333 pika 1 të K.Pr.P, çështja është vënë në lëvizje nga gjyqtari kryesues duke caktuar seancën gjyqësore më datë 12.11.2013 dhe urdhëruar njoftimin e palëve (*Prokurori, i pandehuri, mbrojtësit e të pandehurit*). Janë zhvilluar gjithsej **3 seanca gjyqësore**, të cilat janë dokumentuar nëpërmjet regjistrimit audio të seancave si dhe pasqyrohen të plota në ekstraktin e mbajtur me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Seanca e parë e datës 12.11.2013, pas relativitetit të shkakut të fillimit me vonesë të saj, ka vijuar me verifikimin e paraqitjes së palëve, legjitimitetin e mbrojtësit të zgjedhur prej të pandehurit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, disponimin me vendim për kërkesën e të pandehurit dhe mbrojtësit për procedim me gjykim të shkurtuar dhe pranimin e saj. Pas pranimit të kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar, seanca ka vijuar duke ndjekur hapat procedurale të zhvillimit të gjykimit të posaçëm sipas parashikimeve të nenit 405 të K.Pr.P dhe është ndërprerë në fazën e konkluzioneve përfundimtare të palëve, me kërkesë të tyre për të dhënë kohë për përgatitjen e diskutimit përfundimtar me shkrim.

Seanca e dytë e datës 25.11. 2013, pas verifikimit të paraqitjes së palëve dhe relatimit të shkakut të shtyrjes së seancës paraardhëse, ka vijuar me paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare nga ana e prokurorit dhe është shtyrë me kërkesë të mbrojtësit për ti lënë kohë për përgatitjen e diskutimit përfundimtar me shkrim.

Seanca e datës 2.12.2013, pas verifikimit të paraqitjes së palëve, ka vijuar me paraqitjen e diskutimit përfundimtar të mbrojtësit të të pandehurit dhe pasi i është dhënë fjala të pandehurit dhe prokurorit, është deklaruar i mbyllur shqyrtimi gjyqësor, gjykata është tërhequr në dhomën këshillimi për të marrë vendim dhe, pas kthimit, ka shpallur vendimin përfundimtar për deklarimin fajtor dhe dënimin e të pandehurit.

Vendimi përfundimtar me nr. 104, datë 2.12.2013, është i organizuar në tre pjesët kryesore: pjesa hyrëse, pjesa përshkuese arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit. Në tërësi vendimi përmban elementët e domosdoshëm sipas parashikimeve të nenit 383 të K.Pr.P.

Pjesa hyrëse e vendimit përmban të dhënat e plota lidhur me gjykatën, përbërjen e trupit gjykues, identitetin e palëve dhe mbrojtësit, akuzën si dhe kërkimet përfundimtare të palëve në mënyrë të përmbledhur.

Pjesa përshkuese- arsyetuese e vendimit është e organizuar në disa pjesë, të cilat identifikohen nëpërmjet përdorimit të numrave romakë në fillim të tyre si dhe përmbajtjes së secilës pjesë e cila përmban elementët e nevojshëm të pjesës arsyetuese të vendimit. Në pjesën e parë, arsyetimi i vendimit fillon me paraqitjen e çështjes si dhe disponimin e gjykatës lidhur me kërkesën paraprake të të pandehurit për procedim me gjykim të shkurtuar. Në evidentimin e vendimmarrjes lidhur me këtë kërkesë, gjyqtari referon në nenin 404 të K.Pr.P dhe vendimin unifikues nr. 2/20103, duke përcaktuar edhe arsyen e pranimit të kërkesës së të pandehurit.

Më pas vijohet me përshkrimin e përmbledhur të ngjarjes e cila përbën faktin penal objekt akuze dhe më pas me renditjen e provave mbi të cilat mbështetet fakti i provuar në gjykim, si dhe evidentimin e elementëve që provohen nga secila provë (*vendi i kapjes në flagrancë të të pandehurit, sasia e lëndës së sekuestruar, cilësia saj si lëndë narkotike etj.*).

Pas renditjes së provave, arsyetimi i vendimit vijon me konkluzionin për vërtetimin e faktit që i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe pas këtij konkluzioni, gjykata paraqet dhe analizon në mënyrë të integruar provat e marra në gjykim dhe faktet që rezultojnë prej tyre, në raport me faktin penal objekt akuze dhe autorësinë e të pandehurit.

Pas paraqitjes dhe analizës së integruar të provave, arsyetimi i vendimit vijon me analizën e elementëve të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 283/a/1 i Kodit Penal, duke i kushtuar rëndësi të posaçme objektit të veprës penale, formave të kryerjes së veprës si dhe mbetjen e saj në fazën e tentativës, për shkaqe të pavarura nga vullneti i të pandehurit. Në analizën e këtyre elementëve gjykata integron elementët e faktit që kanë rezultuar të provuar në gjykim si dhe referon në kuptimin e tranzitimit si formë e kryerjes së veprës penale, sipas Konventës së OKB-së “Për trafikun e paligjshëm të drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope”. Në mbështetje të argumentimit lidhur me këtë formë të kryerjes së veprës, gjykata referon edhe

në kuptimin e “tranzitimit” sipas parashikimeve të ligjit nr. 7975 datë 26.7.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”. Pas referimit dhe analizës së ligjit penal material, konventës dhe ligjit të posaçëm, gjykata referon edhe qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e Lartë në vendimin unifikues nr. 3, datë 24.1.2011 lidhur me format e kryerjes së veprës penale, duke cituar pjesën përkatëse të këtij vendimi. Pas analizës së faktit, provave dhe ligjit si më sipër, gjyqtari parashtron konkluzionin përfundimtar të arritur lidhur me akuzën ndaj të pandehurit dhe përgjegjësinë e tij në raport me këtë akuzë.

Më pas arsyetimi vijon me përcaktimin dhe përshkrimin e elementëve që ndikojnë në individualizimin e dënimit, duke iu referuar nenit 47 të K.Pr.P, dhe duke evidentuar rrethana që kanë të bëjnë konkretisht me të pandehurin të tilla si rrezikshmëria e veprës penale, mënyrën e kryerjes së saj, formën e fajit, mbetjen e veprës në tentativë, faktin që i pandehuri rezultoi i padënuar, llojin dhe sasinë e lëndës narkotike të trafikuar, si dhe rrethanat lehtësuese të tilla si pranimin e fajit dhe pendesën e të pandehurit, personalitetin e tij të mirë, gjendjen ekonomike dhe familjare të tij.

Më pas gjyqtari i kushton një pjesë të posaçme të arsyetimit kërkesës së mbrojtjes për uljen e dënimit nën minimum dhe pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, duke analizuar kriteret ligjore të nenit 53 dhe 59 të Kodit Penal në raport me rrethanat konkrete të pretenduara si shkaqe që përlligjin aplikimin e këtyre dispozitave nga ana e mbrojtjes së të pandehurit, duke arsyetuar për mosplotësimin e kriterëve ligjore për aplikimin e këtyre dispozitave por duke shpjeguar marrjen parasysh të rrethanave lehtësuese në lidhje me të pandehurin, për caktimin e masës së dënimit ndaj tij.

Më pas arsyetimi vijon lidhur me kërkesën e Prokurorisë në lidhje me provat materiale. Gjyqtari ka analizuar në mënyrë të posaçme lidhur me kërkesën për konfiskimin e mjetit me të cilin i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën procedohet, duke analizuar elementë që lidhen me pronësinë e ligjshme dhe përdorimin e mjetit duke u sjellë si pronar, në shërbim të konkluzionit të arritur për konfiskimin e këtij mjeti në përputhje me parashikimet e nenit 36/1/a të Kodit Penal dhe nenit 190/1/a të Kodit të Procedurës Penale.

Pjesa e dispozitivit të vendimit është e qartë dhe e plotë, përmban bazën ligjore procedurale dhe materiale të vendimmarrjes, disponimet mbi deklarinin fajtor të të pandehurit duke përmendur nenin përkatës, masën e dënimit, uljen e dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar, përcaktimin e momentit të fillimit të kohës së vuajtjes së dënimit dhe llojin e burgut në të cilin do të vuhet dënimi, disponimin për provat materiale në referim të nenit 190 të K.Pr.P, disponimin për shpenzimet procedurale, si dhe përcaktimin e qartë për të drejtën e ankimit, gjykatën pranë së cilës mund të ushtrohet ankimi si dhe afatin e ankimit dhe momentin e fillimit të tij.

KONKLUZIONE

- Janë zhvilluar gjithsej 3 seanca gjyqësore dhe nuk ka seanca jo produktive.
- Gjykimi ka zgjatur 1 muaj e 4 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale.

- Çështja është menaxhuar në mënyrë korrekte nga gjyqtari duke përfunduar në një afat të shkurtër. Seancat janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afateve të shkurtra dhe në çdo rast brenda afatit procedural 15 ditor të parashikuar në nenin 342 të K.Pr.P.
- Shtyrja e seancave ka ndodhur për shkaqe procedurale, me kërkesë të prokurorit dhe të mbrojtësit për të përgatitur diskutimin përfundimtar me shkrim.
- Gjykimi në tërësi është zhvilluar duke respektuar të gjithë hapat procedurale të zhvillimit të gjykimit penal të themelit, duke respektuar parashikimet e posaçme ligjore procedurale për gjykimin e shkurtuar. Vendimet e ndërmjetme për drejtimin e seancës dhe shtyrjen e tyre, në çdo rast evidentohen qartë, referojnë bazën ligjore përkatëse si dhe përmbajnë arsyen e vendimmarrjes.
- Vendimi i arsyetuar përmban elementët e domosdoshëm të vendimit përfundimtar të dënimit sipas parashikimeve të nenit 383 të K.Pr.P, sipas një strukture të qartë dhe të organizuar në mënyrë logjike. Pjesa arsyetuese e vendimit është e strukturuar mbi bazën e një forme standarde me nënndarje të cilat përmbajnë të analizuara ecurinë procedurale të procedimit, rrethanat e faktit, provat, analizën e integruar të tyre, argumentimin ligjor të gjykatës në lidhje me elementët e veprës penale për të cilën procedohet dhe provueshmërinë e saj, të autorësisë së të pandehurit, rrethanat për individualizimin e dënimit si dhe për kërkimin e prokurorisë lidhur me provat materiale.
- I kushtohet rëndësi e veçantë analizës së elementëve të anës objektive të veprës penale, veçanërisht formës së kryerjes së saj si dhe tentativës, duke referuar edhe parashikimet e akteve ndërkombëtare dhe ligjit të posaçëm lidhur me formën e kryerjes së veprës si dhe qëndrimin e vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë lidhur me këtë aspekt.
- Dispozitivi i vendimit është i plotë, i qartë dhe në përputhje të plotë me pjesën arsyetuese të vendimit.
- Dosja gjyqësore është e plotë dhe e rregullt, aktet procedurale janë renditur në mënyrë logjike, sipas kategorisë (aktet procedurale të shortit, formimit të trupit gjykues, vendimi për caktimin e seancës gjyqësore, njoftimet dhe shkresat e kryera gjatë gjykimit, provat shkresore të dorëzuara në seancë për shkak të paraqitjes së kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar, diskutimi përfundimtar i palëve, procesverbalet e seancave gjyqësore dhe vendimi gjyqësor përfundimtar) dhe në rend kronologjik (sipas datave ose momentit të paraqitjes së tyre) brenda së njëjtës kategori aktesh.

Dosja 8 (3) -Çështja penale me nr. 158 regjistri, datë regjistrimi 25.9.2014, ndaj të pandehurve Vladimir Jupe dhe Shkëlqim Sharra, akuzuar për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve”, në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 283/a/2-22 të Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 139, datë 1/12/2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Çështja është regjistruar në datë 25.9.2014 dhe me shortin e datës 30.9.2014 i është caktuar gjyqtarit {...} në cilësinë e kryesuesit. Më urdhrin e datës 30.9.2014 është formuar trupi gjykues me pesë gjyqtarë për gjykimin e çështjes.

Me vendimin e datës 2.10.2014, dy ditë pas caktimi me short, duke respektuar afatin procedural të parashikuar nga neni 333 pika 1 të K.Pr.P, çështja është vënë në lëvizje nga gjyqtari kryesues duke caktuar seancën gjyqësore më datë 16.10.2014, dhe urdhëruar njoftimin e palëve dhe marrjen e masave për shoqërimin e të pandehurve që ndodhen nën masa sigurimi shtrënguese.

Janë zhvilluar gjithsej **6 seanca gjyqësore**, të cilat janë dokumentuar nëpërmjet procesverbalit të mbajtur me shkrim nga sekretarja gjyqësore. Nga 6 seanca, 3 prej tyre janë shtyrë për të mundësuar njoftimin dhe prezencën e mbrojtësve, një për mos formim të trupit gjykues dhe dy për t'i dhënë kohë palëve për përgatitjen e diskutimit përfundimtar me shkrim.

Seanca e datës 16/10/2014 është shtyrë për të bërë të mundur garantimin e së drejtës së mbrojtjes për të pandehurit dhe mundësuar njoftimin e mbrojtësve të zgjedhur prej tyre. Është relatuar prezenca e palëve, të pandehurve, janë dëgjuar kërkesat e tyre lidhur me mbrojtësit. Në vendimin për shtyrjen e seancës gjyqësore është relatuar shkaku u shtyrjes, masat që duhet të merren për njoftimin dhe pjesëmarrjen e palëve si dhe është urdhëruar pezullimin i afateve të paraburgimit në referim të nenit 265 të K.Pr.P.

Seanca e datës 22.10.2014 nuk është zhvilluar për shkak të mos formimit të trupit gjykues, duke u relatuar edhe shkaku objektiv për mos prezencën e tre anëtarëve të trupit gjykues. Është relatuar prezenca e palëve dhe mbrojtësve për efekt të marrjes dijeni për seancën vijuese si dhe është urdhëruar marrja e masave për të siguruar prezencën e palëve dhe njoftimin e tyre për seancën vijuese.

Në seancën e datës 27.10.2014, pasi është verifikuar paraqitja e palëve, të pandehurve, mbrojtësve të tyre, aktet e njoftimit për secilin prej tyre, gjykimi ka vijuar me shqyrtimin e kërkesave paraprake të palëve, vendimmarrjen për procedim me gjykim të shkurtuar bazuar në parashikimet e nenit 404 të K.Pr.P dhe V. U nr. 2/2003, gjykimi ka vijuar me procedurën e gjykimit të shkurtuar sipas parashikimeve të nenit 405 të K.Pr.P. Njëkohësisht në fazën e shqyrtimit të kërkesave paraprake gjykata ka marrë në shqyrtim dhe disponuar me vendimin për kërkesën e njërit prej të pandehurve për zëvendësimin e masës së sigurimit, duke disponuar për pranimin e saj, duke relatuar shkakun e pranimit të kërkesës dhe më pas, në vendimin e arsyetuar për zëvendësimin e masës së sigurimit, duke analizuar tërësisht shkaqet ligjore dhe rrethanat faktike të zëvendësimit të masës së sigurimit. Gjykimi ka vijuar duke ndjekur etapat e gjykimit të shkurtuar, duke u deklaruar i hapur shqyrtimit gjyqësor, dhënien e fjalës prokurorit për të parashtruar faktin objekt akuze dhe provat mbi të cilat ai mbështetet, dhënien e fjalës palëve për t'u shprehur lidhur me faktin dhe aktet e paraqitura nga prokuroria, marrjen në shqyrtim të provave në bazë të neneve 151,357,371,405 të K.Pr.P dhe me pas dhënien e fjalës palëve për të parashtruar diskutimin përfundimtar. Gjykimi është ndërprerë në këtë fazë duke pranuar kërkesën e prokurorit për t'i dhënë kohë për përgatitjen e diskutimit përfundimtar me shkrim.

Seanca e datës 10.11.2014, ka vijuar me paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare të prokurorit dhe është shtyrë me kërkesë të mbrojtësve të të pandehurve, për t'i lënë kohë për përgatitjen e diskutimit përfundimtar me shkrim.

Seanca e datës 20.11.2014, pas verifikimit të paraqitjes së palëve dhe dëgjimit të kërkesave të të pandehurve lidhur me mbrojtësit e tyre, është shtyrë për të bërë të mundur prezencën e avokatit të zgjedhur nga njëri prej të pandehurve. Në vendimin për shtyrjen e seancës relatohet shkaku i shtyrjes, urdhërohet pezullimi i afateve të paraburgimit për të pandehurit si dhe marrja e masave për kryerjen e njoftimeve dhe shoqërimin e të pandehurve për seancën e ardhshme.

Seanca e datës 1.12.2014 është zhvilluar në prezencë të palëve dhe përfaqësuesve të të pandehurve, dhe pas verifikimit të paraqitjes së tyre, seanca ka vijuar me konkluzionet përfundimtare të mbrojtësve të të pandehurve dhe më pas me deklarinimin të mbyllur të shqyrtimit gjyqësor dhe shpalljen e vendimit përfundimtar, vendim për deklarinimin fajtor të të pandehurve dhe dënimin e tyre.

Vendimi përfundimtar me nr. 139, datë 1.12.2014, është i organizuar në tre pjesët kryesore: pjesa hyrëse, pjesa përshkuese arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit. Në tërësi vendimi përmban elementët e domosdoshëm sipas parashikimeve të nenit 383 të K.Pr.P.

Pjesa hyrëse e vendimit përmban të dhënat e plota lidhur me gjykatën, përbërjen e trupit gjykues, identitetin e palëve dhe mbrojtësit, akuzën si dhe kërkimet përfundimtare të palëve në proces.

Pjesa përshkuese- arsyetuese e vendimit është e organizuar në katër pjesë kryesore të cilat janë të ndara në paragrafë të numërtuar të cilët ndjekin rrjedhë dhe lidhje logjike midis tyre. Në nënndarjen e titulluar “Rrethanat e faktit”, arsyetimi fillin me parashtrimin e çështjes objekt shqyrtimi dhe ecurinë procedurale të saj duke u relatuar paraqitja e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar dhe disponimi i gjykatës për pranimin e kërkesës, së bashku me arsyetimin përkatës. Gjithashtu relatohet paraqitja dhe shqyrtimi i kërkesës së njërit prej të pandehurve për zëvendësimin e masës së sigurimit si dhe vendimmarrja e gjykatës lidhur me këtë kërkesë, së bashku me arsyet në mënyrë të përmbledhur (vendimi lidhur me kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit është zbardhur me vete dhe i është bashkëlidhur procesverbalit të seancës përkatëse në të cilën është disponuar për këtë kërkesë). Në vijim gjyqtari parashtron rrethanat e faktit të cilat kanë rezultuar të provuara në gjykim, duke referuar dhe analizuar edhe përmbajtjen e provave respektive mbi të cilat mbështeten rrethanat e faktit të provuara në gjykim.

Arsyetimi vijon me nënndarjen “Provat e marra”, në të cilën parashtrohen provat dhe aktet e marra në gjykim, në kuadër të gjykimit të shkurtuar, si dhe elementët përkatës të tyre, në raport me provueshmërinë e faktit penal objekt gjykimi. Në këtë pjesë gjyqtari ka renditur dhe përshkruar në mënyrë të përmbledhur jo vetëm provat e marra gjatë gjykimit, por edhe aktet procedurale që kanë të bëjnë me ecurinë e hetimit dhe gjykimit të çështjes të tilla si vendimet gjyqësore lidhur me vleftësimin e arrestimit apo caktimin e masave të sigurimit ndaj të pandehurve, etj.

Nënndarja e tretë e titulluar “Analiza ligjore mbi provat dhe cilësimin juridik të veprës penale”, përbën analizën ligjore të faktit penal të provuar në gjykim. Gjyqtari që në fillim të arsyetimit, pas analizës së faktit të provuar në gjykim dhe paraqitjes së provave të bërë në dy pjesët e para të arsyetimit, parashtron konkluzionin e gjykatës lidhur me ndodhjen dhe provueshmërinë e faktit penal, autorësinë e njërit prej të pandehurve dhe kryerjen e veprës prej tij në bashkëpunim me persona të tjerë, si dhe mungesën e elementëve që të provojnë bashkëpunimin e të pandehurit tjetër me të, duke vijuar më pas me analizën e plotë dhe të integruar të provave në raport me faktin penal, autorësinë e të njërit prej të pandehurve. Arsyetimi vijon me analizën e integruar të provave dhe fakteve që rezultojnë prej tyre në lidhje me rrethanat e udhëtimit së bashku të dy të pandehurve si dhe mungesën e elementëve që të provojnë bashkëpunimin e të pandehurit Sh. Sh në kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet. Në mbështetje të këtij konkluzioni, gjyqtari

merr në analizë edhe faktet mbi të cilat e mbështet prokuroria rrethanën e bashkëpunimit të të pandehurit Sh.Sh dhe autorësinë në raport me veprën për të cilën akuzohet, duke analizuar indicjet mbi të cilat mbështetet organi i akuzës në raport me parashikimet e nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale si dhe vlerën e deklarimeve të bashkë te pandehurit, duke konkluduar për mungesën e provave që të mbështesin akuzën ndaj të pandehurit Sh.Sh dhe bashkëpunimin e tij me të pandehurin tjetër. Gjithashtu gjyqtari i kushton rëndësi në arsyetim evidentimit të deklarimeve të të pandehurve dhe personave të tjerë që kanë dhënë deklarime gjatë hetimit, të cilat i vlerëson në raport me njëra tjetrën në shërbim të konkluzionit se mes tyre nuk ka kundërthënie.

Gjyqtari vijon me argumentimin lidhur me vlerësimin e të dhënave të cilat vlerësohen si indicje nga prokuroria, të cilat sipas gjykatës nuk janë të tilla dhe nuk mund të shërbejnë si indicje me vlerë provuese për të mbështetur akuzën ndaj të pandehurit por, sipas gjykatës përbëjnë të dhëna të pa mbështetura në prova të cilat janë vlerësuar në raport me parimin e prezumimit të pafajësisë parashikuar nga neni 4 i K.Pr.P. Më pas arsyetimi vijon me analizën e elementëve të anës objektive dhe subjektive të veprës penale si dhe autorësinë e të pandehurit tjetër, V.J, duke përshkruar sërish në mënyrë të përmbledhur faktin objekt akuzë, listuar provat mbi të cilat mbështetet ky fakt, duke konkluduar më pas për fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet, mbetjen e veprës në tentativë si dhe kryerjen e saj në bashkëpunim me një shtetas të pafajësuar, i cili ka qenë në rolin e porositësit dhe ndihmësit për të pandehurin V.J. Pas këtij konkluzioni, arsyetimi vijon me analizën e katër elementëve të figurës së veprës penale, duke analizuar posaçërisht secilin elementët dhe faktet përkatëse që kanë rezultuar të provuara gjatë gjykimit për secilin prej tyre.

Në analizën ligjore të elementëve të figurës së veprës penale i kushtohet rëndësi, në analizën e anës objektive, kuptimit të tentativës duke e analizuar atë në raport me format e kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, referuar edhe kuptimit të tyre sipas Konventës së OKB-së “Kundër trafikimit të paligjshëm të drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope”, ligjit nr. 7975, datë 26.7.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope” si dhe qëndrimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 3, datë 24.1.2011, konkluzioni unifikues i së cilit citohet në pjesën arsyetuese të vendimit.

Pas analizës ligjore të faktit penal dhe konkluzionit lidhur me fajësinë e njërit prej të pandehurve dhe pafajësinë e të pandehurit tjetër, arsyetimi vijon me pjesë në katërt të titulluar “Caktimi i llojit dhe masës së dënimit”. Në këtë pjesë gjyqtari ka parashtruar dhe analizuar me vetë dhe në mënyrë specifike rrethanat konkrete që ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit për të pandehurin që është gjetur fajtor. Në këtë pjesë, vec analizës së elementëve që ndikojnë në caktimin e llojit dhe masës së dënimit, arsyetohet lidhur me pa bazueshmërinë e kërkesës së mbrojtjes për ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale, lidhur me elementin cilësues të bashkëpunimit, por duke analizuar rolin e tij në kryerjen e veprës në raport me përcaktimin e rrezikshmërisë së tij që ndikon dhe është marrë parasysh në caktimin e llojit dhe masës së dënimit. Pas këtij momenti, arsyetimi vijon lidhur me disponimin për kërkesën e prokurorisë për provat materiale në referim të nenit 36 dhe 190 të K.Pr.P. Arsyetimi mbyllet me përcaktimin e institucionit në të cilin do të vuhet dënimi për të pandehurin e deklaruar fajtor dhe disponimin

për heqjen e masës së sigurimit dhe lirimin e menjëhershëm të të pandehurit për të cilin u konkludua se është i pafajshëm.

Pjesa e dispozitivit të vendimit është e qartë dhe e plotë, përmban bazën ligjore procedurale dhe materiale të vendimmarrjes, disponohet mbi deklarinin fajtor të njërit pandehur duke përmendur dispozitën, nenin përkatës, dhe masën e dënimit, uljen e dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar, përcaktimin e momentit të fillimit të kohës së vuajtjes së dënimit dhe llojin e burgut në të cilin do të vuhet dënimi, deklarinin e pafajshëm të të pandehurit tjetër, disponimin për heqjen e masës së sigurimit dhe lirimin e menjëhershëm të tij. Më pas dispozitivi vazhdon me disponimin e plotë për të gjitha provat materiale në referim të nenit 190 të K.Pr.P, për shpenzimet procedurale, si dhe përcaktimin e qartë për të drejtën e ankimit, gjykatën pranë së cilës mund të ushtrohet ankim si dhe afatin e ankimit dhe momentin e fillimit të tij.

KONKLUZIONE

- Janë zhvilluar gjithsej 6 seanca gjyqësore nga të cilat 3 kanë qenë jo produktive. Seancat janë shtyrë për shkaqe procedurale të përligjura të tilla si kërkesat e të pandehurve për mbrojtës, zëvendësimi i mbrojtësve, dhënia kohë palëve për përgatitjen e diskutimit përfundimtar, mos formim i trupit gjykues për shkaqe të përligjura. Rezulton që në çdo rast gjykata ka marrë gjithë masat e nevojshme për të siguruar vijimin e gjykimit në seancën vijuese (*masa të tilla si caktimi avokatit kryesisht, njoftimi i avokatëve të zgjedhur, marrja e masave për shoqërimin e të pandehurve në seancë pezullimi i afateve të paraburgimit*).
- Gjykimi ka zgjatur 2 muaj e 6 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale.
- Çështja është menaxhuar në mënyrë korrekte nga gjyqtari, duke përfunduar në një afat relativisht të shkurtër. Seancat janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afateve të shkurtra dhe në çdo rast brenda afatit procedural 15 ditor të parashikuar në nenin 342 të K.Pr.P.
- Shtyrja e seancave ka ndodhur për shkaqe procedurale, të tilla si mos formimi i trupit gjykues, për ti garantuar të pandehurve të drejtën e mbrojtjes, për ti dhënë kohë palëve për përgatitjen e diskutimit përfundimtar me shkrim.
- Gjykimi në tërësi është zhvilluar duke respektuar të gjithë hapat procedurale të zhvillimit të gjykimit penal të themelit, duke respektuar parashikimet e posaçme ligjore procedurale për gjykimin e shkurtuar. Vendimet e ndërmjetme për drejtimin e seancës në çdo rast evidentohen qartë, referojnë bazën ligjore përkatëse si dhe përmbajnë arsyen e vendimmarrjes.
- Dosja është e plotë dhe renditja e akteve e rregullt, sipas llojit të akteve dhe brenda llojit, sipas datave dhe përmban aktin e zhvillimit të shortit, urdhrin për formimin e trupit gjykues, vendimin për caktimin e seancës gjyqësore, njoftimet e palëve, deklarinimet e marra gjatë hetimit paraprak të cilët janë bërë pjesë e dosjes për shkak të pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, procesverbalet e seancave, diskutimet me shkrim të palëve dhe vendimin gjyqësor përfundimtar.
- Vendimi i arsyetuar përmban elementët e domosdoshëm të vendimit përfundimtar të dënimit sipas parashikimeve të nenit 383 të K.Pr.P dhe të pafajësisë për njërin prej të pandehurve, sipas një strukture të qartë dhe të organizuar në mënyrë logjike. Pjesa arsyetuese e vendimit është e strukturuar mbi bazën e një forme standarde me nënndarje të cilat përmbajnë të analizuarat ecurinë procedurale të procedimit, rrethanat e faktit të

provuara në gjykim, paraqitjen dhe analizën e provave të marra në kuadër të gjykimit të shkurtuar si dhe argumentimin ligjor të gjykatës në lidhje me cilësimin ligjor të faktit penal, elementët e figurës së veprës penale përkatëse si dhe rolin e të pandehurit. Në mënyrë të posaçme i është kushtuar rëndësi analizës së faktit në raport me rolin e të pandehurit që është gjetur i pafajshëm, duke analizuar elementët mbi të cilat mbështetet akuza e prokurorisë në raport me kuptimin e provave, indicjeve si dhe mungesën e tyre në rastin konkret në raport me ketë të pandehur.

- Gjithashtu në mënyrë të veçantë evidentohen faktet thelbësore në lidhje me ekzistencën e elementëve të anës objektive të veprës penale, autorësinë e të pandehurit që është gjetur fajtor dhe rolin e tij, duke përcaktuar provat konkrete mbi bazën e të cilave rezultojnë të provuara këto fakte. Në një pjesë të veçantë të vendimit analizohen në mënyrë të detajuar rrethanat që ndikojnë në individualizimin e dënimit për të pandehurin që është deklaruar fajtor në raport me veprën penale për të cilën procedohet.
- Dispozitivi i vendimit është i plotë, i qartë, i kuptueshëm dhe në përputhje të plotë me pjesën arsyetuese të vendimit.

Dosja 9 (4) -Çështja penale me nr. 49/199 regjistri, datë regjistrimi 18.12.2014, ndaj të pandehurit Luigj Krajni, akuzuar për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve”, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a/1-22 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 24, datë 18.2.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Çështja është regjistruar në Gjykatë më datë 18.12.2014, dhe me shortin e datës 23.12.2014 i është caktuar gjyqtarit {...}. Pas caktimit të çështjes me short, me urdhrin *pa datë*, është formuar trupi gjykues me pesë gjyqtarë për gjykimin e çështjes.

Me vendimin e datës 24.12.2014, një ditë pas caktimi me short, duke respektuar afatin procedural të parashikuar nga neni 333 pika 1 të K.Pr.P, çështja është vënë në lëvizje nga gjyqtari kryesues duke caktuar seancën gjyqësore më datë 31.1.2015 ora 11.00, dhe urdhëruar njoftimin e palëve dhe marrjen e masave për shoqërimin e të pandehurit.

Janë zhvilluar gjithsej 5 seanca gjyqësore, të cilat janë dokumentuar nëpërmjet procesverbalit të mbajtur me shkrim nga sekretarja gjyqësore. Nga 5 seanca, 1 prej tyre është shtyrë për të bërë të mundur prezencën e përfaqësuesit të prokurorisë, 1 për të bërë të mundur prezencën e mbrojtësit të të pandehurit dhe 2 për të lënë kohë palëve për përgatitjen e diskutimit përfundimtar me shkrim.

Seanca e datës 13.1.2015, pas verifikimit të paraqitjes së palëve, legjitimitit të mbrojtësit të zgjedhur prej të pandehurit, ka vijuar me kërkesat paraprake të palëve, shqyrtimin e kërkesës së të pandehurit dhe mbrojtësit të tij për procedimin me gjykim të shkurtuar, pranimin e saj me vendim, dhe më pas me procedurën e gjykimit të shkurtuar në referim të nenit 405 të K.Pr.P. Gjykimi pasi ka kaluar në të gjithë hapat procedurale të parashikuara nga neni 405 i K.Pr.P, pas administrimit të provave, është ndërprerë në fazën e konkluzioneve përfundimtare të palëve, me kërkesë të prokurorit, për përgatitjen me shkrim të tyre.

Seanca e datës 21.1.2015, pas verifikimit të paraqitjes së palëve, është shtyrë për shkak të mosparaqitjes së prokurorit, ndërsa seanca e datës 4.2.2015, pasi janë dëgjuar konkluzionet

përfundimtare të prokurorit, është shtyrë me kërkesë të avokatit të të pandehurit për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare.

Seanca e datës 11.2.2015 është shtyrë për shkak të mosparaqitjes së mbrojtësit të të pandehurit dhe me kërkesë të këtij të fundit për ti garantuar të drejtën e mbrojtjes me avokat, ndërsa në seancën e datës 18.2.2015, pas verifikimit të paraqitjes së palëve, janë dëgjuar konkluzionet përfundimtare të mbrojtjes dhe është deklaruar i mbyllur shqyrtimi gjyqësor. Pasi është kthyer nga dhoma e këshillimit, gjykata ka shpallur vendimin përfundimtar për deklarimin fajtor dhe dënimin e të pandehurit.

Vendimi përfundimtar me nr. 24, datë 18.2.2015, është i organizuar në tre pjesët kryesore: pjesa hyrëse, pjesa përshkuese arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit. Në tërësi vendimi përmban elementët e domosdoshëm sipas parashikimeve të nenit 383 të K.Pr.P.

Pjesa hyrëse e vendimit përmban të dhënat e plota lidhur me gjykatën, përbërjen e trupit gjykues, identitetin e plotë të palëve dhe mbrojtësit, akuzën si dhe kërkimet përfundimtare të palëve në proces.

Pjesa përshkuese- arsyetuese e vendimit është e organizuar në disa pjesë, duke ndjekur një strukturë të njëjtë në rastet e procedimit me gjykim të shkurtuar, në ndarjen në katër pjesë kryesore të cilat shoqërohen dhe me titujt përkatës që prezantojnë përmbajtjen e pjesës, dhe e ndarë secila prej tyre në paragrafë të organizuar në rrjedhë logjike të njëri tjetrit. Në pjesën e parë të titulluar “Rrethanat e faktit” arsyetimi fillon me prezantimin e çështjes, të pandehurin, akuzën dhe mbështetjen ligjore të saj. Më pas vijohet me përshkrimin e ecurisë procedurale të çështjes duke përshkuar kërkesën e të pandehurit për procedim me gjykim të shkurtuar, vendimmarrjen e gjykatës mbi këtë kërkesë, arsyet e pranimit të saj dhe duke referuar bazën ligjore, nenin 404 të K.Pr.P, dhe vendimin unifikues nr. 2/2003. Më pas arsyetimi vijon me paraqitjen e rrethanave të faktit në mënyrë kronologjike, sikurse kanë rezultuar të provuara nga shqyrtimi i provave të marra në kuadër të gjykimit të shkurtuar. Paraqitja e rrethanave të faktit dhe analiza e tyre përmban në mënyrë të integruar edhe provat dhe faktet që rezultojnë prej tyre në lidhje me çdo rrethanë që ka të bëjë me faktin penal, konstatimin e tij dhe rolin e të pandehurit në realizimin e faktit penal objekt akuze. Përshkrimi i faktit penal vjen në këtë pjesë të arsyetimit të vendimit nëpërmjet një paraqitje të plotë dhe të detajuar të tij, ndërthurur me faktet dhe provat respektive në të cilat ato mbështeten dhe rezultojnë të provuara.

Në pjesën e dytë të titulluar “Provat e marra”, në kuadër të gjykimit të shkurtuar, gjyqtari ka renditur dhe përshkuar në mënyrë të përmbledhur duke evidentuar atë çka është e rëndësishme për të provuarit e faktit penal, të gjitha provat që janë administruar në gjykim si dhe është parashtruar qëndrimi i të pandehurit dhe mbrojtësit të tij lidhur me provat. Në fund të kësaj pjesë parashtrohet qëndrimi i të pandehurit dhe mbrojtësit lidhur me faktin penal objekt akuze, provat e mara në gjykim si dhe kërkimet e tyre lidhur me përcaktimin e llojit dhe masën e dënimit, duke iu referuar rrethanave që ndikojnë në individualizimin e dënimit.

Në pjesën e tretë të titulluar “Analiza ligjore mbi provat e cilësimin juridik të veprës penale”, gjyqtari parashtron fillimisht konkluzionin e arritur nga analiza e faktit dhe provave në dy pjesët e para të arsyetimit, për bazueshmërinë dhe provueshmërinë e faktit penal për të cilin akuzohet i

pandehuri dhe më pas rendit edhe njëherë, pa i analizuar këtë herë, të gjitha provat e administruara gjatë gjykimit. Pas paraqitjes së provave duke i listuar ato, gjyqtari parashtron konkluzionin e arritur lidhur me autorësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet dhe më pas vijon me analizën e katër elementëve të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 283/a/1 i Kodit Penal. Në mënyrë të posaçme i kushtohet rëndësi në analizë dhe arsyetim përcaktimit të formës së kryerjes së veprës penale, duke iu referuar praktikës unifikuese të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 3/2011 si dhe analizës së faktit dhe analizës ligjore të tentativës dhe shkaqeve të ndikojnë në kualifikimin e veprës penale si të mbetur në këtë fazë.

Në pjesën e katërt të titulluar “caktimi i llojit dhe masës së dënimit” gjyqtari merr në analizë të gjithë elementët që diktojnë caktimin e llojit dhe masës së dënimit sipas nenit 47 të Kodit Penal si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese në referim të nenit 48 dhe 49 të Kodit Penal, duke evidentuar dhe analizuar në mënyrë të posaçme ato rrethana që janë prezente në rastin e të pandehurit. Në këtë pjesë të arsyetimit merret në shqyrtim dhe parashtrihen argumente lidhur me kërkimin e mbrojtjes për uljen e dënimit nën minimumin e parashikuar nga ligji duke u marrë në analizë kushtet e nenit 53 të Kodit Penal. Më pas arsyetimi vijon me vlerësimin lidhur me disponimin mbi provat materiale, si dhe llojin e institucionit të vuajtjes së dënimit për të pandehurin duke referuar parashikimet e ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”.

Pjesa e dispozitivit të vendimit është e qartë dhe e plotë, përmban bazën ligjore procedurale dhe materiale të vendimmarrjes, disponohet mbi deklarinimin fajtor të të pandehurit për veprën penale për të cilën është akuzuar, uljen e dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar, përcaktimin e momentit të fillimit të kohës së vuajtjes së dënimit dhe llojin e burgut në të cilin do të vuhet dënimi, dispononin për provat materiale në referim të nenit 190 të K.Pr.P, disponimi për shpenzimet procedurale, si dhe përcaktimin e qartë për të drejtën e ankimit, gjykatën pranë së cilës mund të ushtrohet ankim si dhe afatin e ankimit dhe momentin e fillimit të tij.

KONKLUZIONE

- Janë zhvilluar gjithsej 5 seanca gjyqësore nga të cilat 2 kanë qenë jo produktive. Seancat nuk janë zhvilluar ose janë shtyrë për shkaqe procedurale të përligjura (mosparaqitja e prokurorit dhe mbrojtësit si dhe dhënia kohë palëve për përgatitjen e diskutimit përfundimtar me shkrim) dhe rezulton qenë çdo rast gjykata ka marrë gjithë masat e nevojshme për të siguruar vijimin e gjykimit në seancën vijuese.
- Gjykimi ka zgjatur 2 muaj, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale.
- Çështja është menaxhuar në mënyrë korrekte nga gjyqtari, duke përfunduar në një afat të shkurtër. Seancat janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afateve të shkurtra dhe në çdo rast brenda afatit procedural 15 ditor të parashikuar në nenin 342 të K.Pr.P.
- Gjykimi në tërësi është zhvilluar duke respektuar të gjithë hapat procedurale të zhvillimit të gjykimit penal të themelit, duke respektuar parashikimet e posaçme procedurale për gjykimin e shkurtuar. Vendimet e ndërmjetme për drejtimin e seancës në çdo rast evidentohen qartë, referojnë bazën ligjore përkatëse si dhe përmbajnë arsyetimin e vendimmarrjes.

- Dosja është e plotë dhe renditja e akteve e rregullt, sipas llojit të akteve dhe brenda llojit, sipas datave dhe përmban aktin e zhvillimit të shortit, urdhrin për formimin e trupit gjykues, vendimin për caktimin e seancës gjyqësore, njoftimet e palëve, deklaratimet e marra gjatë hetimit paraprak të cilët janë bërë pjesë e dosjes për shkak të pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, procesverbalet e seancave, diskutimet me shkrim të palëve dhe vendimin gjyqësor përfundimtar.
- Vendimi i arsyetuar përmban elementët e domosdoshëm të vendimit përfundimtar të dënimit sipas parashikimeve të nenit 383 të K.Pr.P, sipas një strukture të qartë dhe të organizuar. Pjesa arsyetuese e vendimit është e strukturuar mbi bazën e një forme standarde me nënndarje të cilat përmbajnë ecurinë procedurale të gjykimit, rrethanat e faktit të analizuar në mënyrë të plotë dhe të qartë, siç kanë rezultuar të provuara në gjykim, ecurinë paraqitjen e provave të mara gjatë gjykimit dhe faktet esenciale që rezultojnë të provuara prej tyre, argumentimin ligjor të gjykatës në lidhje me akuzën dhe kualifikimin ligjor të saj si dhe në pjesën e fundit, rrethanave specifike në lidhje me individualizimin e dënimit.
- Dispozitivi i vendimit është i plotë, i qartë dhe në përputhje të plotë me pjesën arsyetuese të vendimit.

Dosja 10 (5) -Çështja penale me nr. 69 regjistri, datë regjistrimi 24.12.2015, ndaj të pandehurit Nikolas Jani, akuzuar për veprën penale “Shtrëngim me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie pasurie” dhe “Falsifikimi i formularëve”, parashikuar nga nenet 109/b/1 dhe 190/1 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 16, datë 3.2.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Çështja është regjistruar në datë 24.12.2015 dhe me shortin e datës 29.12.2015 i është caktuar gjyqtarit {...} në cilësinë e kryesuesit. Më urdhrin e datës 29.12.2015 është formuar trupi gjykues me pesë gjyqtarë për gjykimin e çështjes.

Me vendimin e datës 31.12.2015, dy ditë pas caktimit me short, duke respektuar afatin procedural të parashikuar nga neni 333 pika 1 të K.Pr.P, çështja është vënë në lëvizje nga gjyqtari kryesues duke caktuar seancën gjyqësore më datë 15.1.2016, dhe urdhëruar njoftimin e palëve dhe marrjen e masave për shoqërimin e të pandehurit. Janë zhvilluar gjithsej 4 seanca gjyqësore, të cilat janë dokumentuar në procesverbalin e mbajtur nga sekretarja gjyqësore.

Seanca e datës 15.1.2016, pas verifikimit të paraqitjes së palëve ka vijuar me legjitimimin e mbrojtësit të të pandehurit. Pas këtij momenti është shpallur trupi gjykues dhe i është dhënë fjala palëve për të parashtruar kërkesat paraprake. Pasi është dëgjuar kërkesa e avokatit të të pandehurit për procedim me gjykim të shkurtuar, gjykata ka disponuar me vendim për caktimin e një psikologu për të asistuar të pandehurin gjatë gjykimit, për shkak të moshës së tij, në referim të parashikimeve të nenit 35 të K.Pr.P dhe seanca është ndërprerë për të bërë të mundur njoftimin dhe prezencën e psikologes.

Në seancën e datës 20.1.2016, zhvilluar në prezencë të palëve, mbrojtësit të të pandehurit dhe psikologes së caktuar për të asistuar të pandehurin e mitur, gjykimi ka vijuar me shqyrtimin e kërkesës së të pandehurit dhe mbrojtësit të tij për procedim me gjykim të shkurtuar. Pasi janë dëgjuar palët dhe shqyrtuar aktet të cilat prokurori ka paraqitur në seancë për shkak të paraqitjes së kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar, gjykata ka disponuar me vendim të

ndërmjetëm për pranimin e kërkesës duke referuar nenin 404 të K.Pr.P dhe vendimin unifikues nr. 2/2003. më pas gjykimi ka vijuar duke ndjekur të gjithë hapat procedurale të zhvillimit të gjykimit të shkurtuar me deklarin e hapur të shqyrtimit gjyqësor, marrjen dhe administrimin e provave dhe më pas i është dhënë fjala palëve për paraqitjen e diskutimit përfundimtar. Seanca është shtyrë me kërkesë të prokurorit për ti lënë kohë për përgatitjen e diskutimit përfundimtar me shkrim.

Seanca e datës 28.1.2016, pas verifikimit të paraqitjes së palëve dhe relatimit të kërkesës së mbrojtësit, është ndërprerë për shkak të mosparaqitjes së tij me qëllim për ti garantuar të drejtën e mbrojtjes të pandehurit, ndërsa seanca e datës 3.2.2016, pas verifikimit të paraqitjes së palëve dhe relatimit të mosparaqitjes së të pandehurit si dhe deklaratës së nënshkruar prej tij, ka vijuar me deklarin e mungesës së vullnetshme të të pandehurit në referim të nenit 352/1 të K.Pr.P. Pas këtij momenti, palët kanë parashtruar konkluzionet përfundimtare me shkrim dhe më pas është deklaruar i mbyllur shqyrtimi gjyqësor. Në këtë seancë është shpallur vendimi përfundimtar për deklarin fajtor dhe dënimin e të pandehurit.

Vendimi përfundimtar me nr. 16, datë 3.2.2016, është i organizuar në tre pjesët kryesore: pjesa hyrëse, pjesa përshkuese arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit. Në tërësi vendimi përmban elementët e domosdoshëm sipas parashikimeve të nenit 383 të K.Pr.P.

Pjesa hyrëse e vendimit përmban të dhënat e plota lidhur me gjykatën, përbërjen e trupit gjykues, identitetin e palëve dhe mbrojtësit, prezencën e psikologes, akuzën ndaj të pandehurit si dhe kërkimet përfundimtare të palëve.

Pjesa përshkuese- arsyetuese e vendimit është e organizuar në pesë pjesë të titulluara sipas përmbajtjes. Në pjesën e parë të titulluar “Rrethanat procedurale të çështjes”, evidentohen elementët procedurale të gjykimit sa i përket zhvillimit të tij në prezencë të psikologes për shkak të moshës së mitur të të pandehurit si dhe kërkesa e të pandehurit për procedim me gjykim të shkurtuar si dhe vendimmarrja e gjykatës për pranimin e kërkesës, së bashku me arsyet përkatëse. Më pas vijohet me nënndarjen e titulluar “Fakti penal objekt i shqyrtimit gjyqësor”, në të cilën parashtrohet i detajuar faktit penal sikurse ka rezultuar i provuar gjatë gjykimit, nëpërmjet përshkrimit të detajuar të faktit penal, sikurse ka rezultuar nga analiza e provave të marra gjatë hetimit paraprak, të cilat janë administruar gjatë gjykimit.

Në nënndarjen e titulluar “Provat”, renditen dhe përshkruhen provat e administruara në gjykim, duke evidentuar në përshkrimin e tyre elementë të rëndësishëm për provueshmërinë e faktit penal si dhe veprimet konkrete të të pandehurit për realizimin e veprës penale. Pas paraqitjes së provave, në fund të kësaj pjese të arsyetimit parashtrohen pretendimet e mbrojtjes lidhur me motivet që kanë shtyrë të pandehurin për kryerjen e veprës penale si dhe rrethanat dhe kërkimet lidhur me llojin dhe masën e dënimit.

Pjesa e tretë e arsyetimit të vendimit e titulluar “Analiza ligjore mbi provat e cilësimin juridik të veprës penale” fillon me konkluzionin lidhur me provueshmërinë e faktit penal objekt akuze ndaj të pandehurit dhe më pas vijohet me analizën e integruar të provave mbi të cilat mbështetet ky konkluzion, lidhur me faktin penal, autorësinë, qëllimin e kryerjes së veprës penale, pasojën e shkaktuar si dhe lidhjen shkakësore mes veprimeve të të pandehurit dhe pasojës së veprës penale.

Më pas arsyetimi vijon me referimin e përmbajtjes së neneve 190/b/1 dhe 190/1 të Kodit Penal si dhe analizën, në mënyrë të përmbledhur, të elementëve të figurës së veprës penale, për secilën veprë për të cilën akuzohet i pandehuri.

Në pjesën e pestë të titulluar “Caktimi i llojit dhe masës së dënimit”, gjyqtari merr në analizë shkaqet konkrete që ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit për të pandehurin, duke evidentuar edhe aktet (provat shkresore) të marra për të provuar rrethanat konkrete të tilla si përbërja familjare e të pandehurit, të dhëna për personalitetin dhe qenien e të pandehurit në proces arsimimi, pasojat e veprës penale, kryerja e një veprë tjetër penale me qëllim realizimin e anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 190/b/1 i Kodit Penal, etj. Në mënyrë të posaçme gjyqtari merr në analizë dhe zbaton nenin 51 të Kodit Penal lidhur me caktimin e dënimit për të pandehurin e mitur, rrethanat lehtësuese prezentë në rastin konkret. Në këtë pjesë gjyqtari merr në analizë edhe kërkimin e mbrojtjes për uljen e dënimit nën minimumin e parashikuar nga ligji duke analizuar nenin 53 të Kodit Penal dhe kushtet për aplikimin e tij. Gjithashtu merret në analizë kërkimi i mbrojtjes për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, duke analizuar rrethanat specifike që kanë lidhje me rastin konkret të tilla si pasojat e veprave penale, kryerja e dy veprave, qëllimin e dënimit penal, etj. Në fund të pjesës arsyetuese të vendimit, gjyqtari ka përcaktuar vendin e ekzekutimit të dënimit me burgim, në bazë të ligjit të posaçëm, duke marrë parasysh moshën e mitur të të pandehurit.

Pjesa e dispozitivit të vendimit është e qartë dhe e plotë, përmban bazën ligjore procedurale dhe materiale të vendimmarrjes, disponohet mbi deklarinë fajtor të të pandehurit duke përmendur nenet e pjesës së posaçme, 190/b/1 dhe 190/1 të Kodit Penal si dhe dispozitën e pjesës së përgjithshme, në lidhje me caktimin e dënimit me burgim për të pandehurin e mitur, konkretisht nenin 51 të Kodit Penal, në zbatim të të cilave është përcaktuar masa e dënimit për secilën veprë. Në referim të nenit 55 të Kodit Penal disponohet për bashkimin e dënimeve, uljen e dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar sipas nenit 406/1 të K.Pr.P. Më pas është disponuar për institucionin në të cilin do të vuhet dënimi, duke iu referuar moshës së tij të mitur, si dhe për të drejtën e ankimit duke përcaktuar vendin dhe kohën brenda së cilës mund të ushtrohet kjo e drejtë.

KONKLUZIONE

- Janë zhvilluar gjithsej 4 seanca gjyqësore nga të cilat një është shtyrë për të mundësuar prezencën e psikologes për të asistuar të pandehurin e mitur, një për të bërë të mundur prezencën e mbrojtësit të të pandehurit dhe seanca e fundit për ti lënë kohë palëve për përgatitjen e diskutimit përfundimtar me shkrim.
- Gjykimi ka zgjatur 1 muaj e 9 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale.
- Çështja është menaxhuar në mënyrë korrekte nga gjyqtari, duke përfunduar në një afat të shkurtër. Seancat janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afateve të shkurtra dhe janë marrë masat për respektimin e të drejtave procedurale të palëve si dhe për të siguruar asistencë psikologjike për të pandehurin e mitur në kohën e kryerjes së veprës.
- Gjykimi në tërësi është zhvilluar duke respektuar të gjithë hapat procedurale të zhvillimit të gjykimit penal të themelit, duke respektuar parashikimet e posaçme ligjore procedurale për gjykimin e shkurtuar. Vendimet e ndërmjetme për drejtimin e seancës në

çdo rast evidentohet qartë, referojnë bazën ligjore përkatëse si dhe përmbajnë arsyen e vendimmarrjes.

- Dosja është e plotë dhe renditja e akteve e rregullt, sipas llojit të akteve dhe brenda llojit, sipas datave dhe përmban aktin e zhvillimit të shortit, urdhrin për formimin e trupit gjykues, vendimin për caktimin e seancës gjyqësore, njoftimet e palëve, deklaratimet e marra gjatë hetimit paraprak të cilët janë bërë pjesë e dosjes për shkak të pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, procesverbalet e seancave, diskutimet me shkrim të palëve dhe vendimin gjyqësor përfundimtar.
- Vendimi i arsyetuar përmban elementët e domosdoshëm të vendimit përfundimtar të dënimit sipas parashikimeve të nenit 383 të K.Pr.P, sipas një strukture të qartë dhe të organizuar në mënyrë logjike. Pjesa arsyetuese e vendimit është e strukturuar mbi bazën e një forme standarde me nënndarje të cilat përmbajnë të analizuara ecurinë procedurale të gjykimit, rrethanat e faktit, provat dhe argumentimin ligjor të gjykatës të organizuar në disa pjesë. I kushtohet rëndësi e veçantë analizës së faktit të provuar në gjykim, analizës së elementëve të figurës së veprës penale për secilën nga dy veprat për të cilat akuzohet i pandehuri, evidentimit të pasojave të veprave penale, përcaktimit të rrethanave që ndikojnë në përcaktimin dhe individualizimin e dënimit për të pandehurin si dhe analizohen të gjitha pretendimet dhe kërkimet e mbrojtjes në pjesën përkatëse të arsyetimit të vendimit (në analizën ligjore të faktit dhe pjesën që ka të bëjë me individualizimin e dënimit).
- Dispozitivi i vendimit është i plotë, i qartë dhe në përputhje të plotë me pjesën arsyetuese të vendimit.

Dosja 11 (6) -Çështja penale me nr. 148 regjistri, datë regjistrimi 7.7.2016, ndaj të pandehurit Klajdi Toçi, i akuzuar për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve”, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a/1-22 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 111, datë 26.9.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Çështja është regjistruar në datë 7.7.2016 dhe me shortin e datës 12.7.2016 i është caktuar gjyqtarit {...} në cilësinë e kryesuesit. Më urdhrin e së njëjtës datë është formuar trupi gjykues me pesë gjyqtarë për gjykimin e çështjes.

Me vendimin e datës 12.7.2016, në të njëjtën ditë të caktimi me short, duke respektuar afatin procedural të parashikuar nga neni 333 pika 1 të K.Pr.P, çështja është vënë në lëvizje nga gjyqtari kryesues duke caktuar seancën gjyqësore më datë 26.7.2016 dhe urdhëruar njoftimin e palëve (*Prokurori, i pandehuri, mbrojtësit e të pandehurit*). Janë zhvilluar gjithsej 4 seanca gjyqësore, të cilat janë dokumentuar nëpërmjet regjistrimit audio të seancave si dhe pasqyrohen në ekstraktin e mbajtur me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Seanca e datës 26.7.2016, pas verifikimit të paraqitjes së palëve dhe relatimit të akteve të njoftimit të tyre, është shtyrë për të mundësuar prezencën e avokatit të zgjedhur, gjykata ka disponuar për pezullimin e afateve të paraburgimit për të pandehurin ndërkohë që seanca e ardhshme është caktuar tej afatit 15 ditor duke relatuar si shkak pushimet vjetore në muajin gusht.

Seanca e datës 7.9.2016 është zhvilluar e plotë, duke ndjekur të gjithë hapat procedurale për verifikimin e paraqitjes së palëve, legjitimitimin e mbrojtësit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e

kërkesave paraprahe të palëve, pranimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar duke referuar arsyen e pranimit të saj dhe bazën ligjore përkatëse në vendimin e ndërmjetëm, deklarin e hapur të shqyrtimit gjyqësor sipas nenit 405 të K.Pr.P, dëgjimin e parashtrimeve të palëve, administrimin e provave në referim të nenit 371 të K.Pr.P dhe kalimin në fazën e konkluzioneve përfundimtare në referim të nenit 378 të K.Pr.P. Seanca është shtyrë me kërkesë të prokurorit për paraqitjen e konkluzioneve me shkrim.

Seancat e datave 15.9.2016 dhe 26.9.2016, zhvilluar në prezencë të palëve, kanë vijuar, përkatësisht me konkluzionet përfundimtare të prokurorit dhe më pas të mbrojtësit ë seancën e fundit, në të cilën gjykata ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor duke shpallur vendimin përfundimtar për deklarin fajtor dhe dënimin e të pandehurit.

Vendimi përfundimtar me nr. 111, datë 26.9.2016, është i organizuar në tre pjesë kryesore: pjesa hyrëse, pjesa përshkuese arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit. Në tërësi vendimi përmban elementët e domosdoshëm sipas parashikimeve të nenit 383 të K.Pr.P.

Pjesa hyrëse e vendimit përmban të dhënat e plota lidhur me gjykatën, përbërjen e trupit gjykues, identitetin e palëve dhe mbrojtësit, akuzën si dhe kërkimet përfundimtare të palëve.

Pjesa përshkuese- arsyetuese e vendimit është e organizuar në disa pjesë të cilat identifikohen nga titujt përkatës, në përputhje me përmbajtjen. Pjesa e parë e titulluar “Rrethanat e faktit”, përmban në pjesën hyrëse të saj ecurinë procedurale të çështjes në të cilën evidentohet kërkesa për procedim me gjykim të shkurtuar dhe disponimi i gjykatës lidhur me këtë kërkesë, së bashku me arsyen e pranimit të saj. Më tej arsyetimi vijon me përshkrimin, në mënyrë të detajuar dhe të plotë, të rrethanave të faktit të cilat kanë rezultuar të provuara në gjykim si dhe veprimet e të pandehurit në raport me faktin penal.

Në nëndarjen e titulluar “Provat” renditen të gjitha provat e marra në gjykim, në kuadër të procedimit me gjykim të shkurtuar, duke cituar ose përshkruar në mënyrë të përmbledhur, për secilën prej tyre, pjesë të përmbajtjes të cilat sjellin elementë të fakteve të provuara në gjykim. Në fund të kësaj pjesë të arsyetimit parashtrrohet qëndrimi i mbrojtjes dhe të pandehurit lidhur me faktin dhe provat si dhe kërkimet e tyre lidhur me përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit si dhe rrethanat që kërkohet të mbahen parasysh nga gjykata në caktimin e dënimit.

Nëndarja e titulluar “Analiza ligjore mbi provat e cilësimit juridik të veprës penale” përmban një analizë të plotë dhe të integruar të provave me elementët e analizës së veprës penale për të cilën procedohet. Që në fillim të kësaj pjesë të arsyetimit gjyqtari parashtron konkluzionin mbi provueshmërinë e faktit penal objekt akuze, shoqëruar me citimin edhe njëherë të të gjithë provave të administruara në gjykim si dhe analizën e fakteve konkrete të provuara pranë tyre, në shërbim të konkluzionit të të provuarit të faktit penal, autorësisë së të pandehurit si dhe vlerësimit se vepra penale ka mbetur në fazën e tentativës. Më pas analiza e gjyqtarit përqendrohet në evidentimin dhe analizën e elementëve të figurës së veprës penale, objektit, anës objektive duke analizuar posaçërisht formën e kryerjes së veprës, mbetjen e saj në fazën e tentativës, subjektin dhe anën subjektive. Në këtë pjesë të arsyetimit, elementët e figurës së veprës penale analizohen nga pikëpamja ligjore duke u ndërthurur edhe me të dhënat që rezultojnë nga provat e administruara, nëpërmjet të cilave rezultojnë të provuar secili prej këtyre

elementëve. I kushtohet rëndësi e posaçme në arsyetim formave të kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, posaçërisht formës së eksportimit, duke referuar dhe cituar në mbështetje të argumentit edhe konkluzionet unifikuese të vendimit nr. 3/2011. Gjithashtu, analizohet edhe mbetja e veprës penale në fazën e tentativës si dhe përgjegjësia penale për këtë fakt, në mbështetje të konkluzioneve unifikuese të vendimit si më sipër.

Në nënndarjen e titulluar “Caktimi i llojit dhe masës së dënimit”, analizohen në mënyrë specifike kushtet dhe kriteret për përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit për të pandehurin konkret, rrethanat lehtësuese dhe rënduese që janë prezent në këtë rast si dhe ndikimi i faktit që vepra penale ka mbetur në fazën e tentativës, në përcaktimin e masës së dënimit. Merret në analizë përmbajtja e nenit 23 të Kodit Penal duke u përcaktuar dhe lloji i tentativës (tentativë e plotë) për efekt të ndikimit të saj në aspektin e përcaktimit të masës së dënimit. Në këtë pjesë të arsyetimit parashtrihen dhe analizohen pretendimet e mbrojtjes së të pandehurit për caktimin e dënimit në minimumin e parashikuar nga dispozita, duke u evidentuar argumentet e gjykatës në lidhje me mospranimin e këtij kërkimi. Pas analizës së plotë në lidhje me llojin dhe masën e dënimit, pretendimet e mbrojtjes së të pandehurit në këtë aspekt, arsyetimin vijon me disponimin për provat materiale dhe më pas në lidhje me përcaktimin e institucionit në të cilin do të vuhet dënimi me burgim, duke referuar ligjin e posaçëm nr. 8328, datë 16.4.1998.

Pjesa e dispozitivit të vendimit është e qartë dhe e plotë, përmban bazën ligjore procedurale dhe materiale të vendimmarrjes, disponimet mbi deklarinimin fajtor të të pandehurit duke përmendur dispozitën, nenin përkatës, dhe masën e dënimit, uljen e dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar, përcaktimin e momentit të fillimit të kohës së vuajtjes së dënimit dhe llojin e burgut në të cilin do të vuhet dënimi, disponimin për provat materiale në referim të nenit 190 të K.Pr.P, disponimin për shpenzimet procedurale, si dhe përcaktimin e qartë për të drejtën e ankimit, gjykatën pranë së cilës mund të ushtrohet ankim si dhe afatin e ankimit dhe momentin e fillimit të tij.

KONKLUZIONE

- Janë zhvilluar gjithsej 4 seanca gjyqësore nga të cilat vetëm një seancë jo produktive për shkak të mosparaqitjes së mbrojtësit të të pandehurit dhe shtyrjen e saj për të mundësuar respektimin e të drejtës së tij për t’u asistuar në gjykim nga mbrojtësi.
- Gjykimi ka zgjatur 2 muaj e 19 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale.
- Çështja është menaxhuar në mënyrë korrekte nga gjyqtari duke përfunduar në një afat të shkurtër. Seancat janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afateve të shkurtra dhe në çdo rast brenda afatit procedural 15 ditor të parashikuar në nenin 342 të K.Pr.P, përveç seancës së parë e cila është planifikuar tej afatit 15 ditor për shkak të pushimeve vjetore të gjykatës në muajin gusht.
- Shtyrja e seancave ka ndodhur për shkaqe procedurale, për t’i garantuar të pandehurit të drejtën e mbrojtjes, për t’i lënë kohë prokurorit dhe më pas mbrojtësit për përgatitjen e diskutimit përfundimtar me shkrim.
- Gjykimi në tërësi është zhvilluar duke respektuar të gjithë hapat procedurale të zhvillimit të gjykimit penal të themelit, duke respektuar parashikimet e posaçme ligjore

procedurale për gjykimin e shkurtuar. Vendimet e ndërmjetme për drejtimin e seancës në çdo rast evidentohen qartë, referojnë bazën ligjore përkatëse si dhe përmbajnë arsyen e vendimmarrjes.

- Dosja është e plotë dhe renditja e akteve e rregullt, sipas llojit të akteve dhe brenda llojit, sipas datave dhe përmban aktin e zhvillimit të shortit, urdhrin për formimin e trupit gjykues, vendimin për caktimin e seancës gjyqësore, njoftimet e palëve, deklaratimet e marra gjatë hetimit paraprak të cilët janë bërë pjesë e dosjes për shkak të pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, procesverbalet e seancave, diskutimet me shkrim të palëve dhe vendimin gjyqësor përfundimtar.
- Vendimi i arsyetuar përmban elementët e domosdoshëm të vendimit përfundimtar të dënimit sipas parashikimeve të nenit 383 të K.Pr.P, sipas një strukture të qartë dhe të organizuar. Pjesa arsyetuese e vendimit është e strukturuar mbi bazën e një forme standarde me nënndarje të cilat përmbajnë të analizuarat ecurinë procedurale të gjykimit, faktin penal të provuar në gjykim, provat, analizën ligjore të faktit penal si dhe kushtet dhe kriteret për individualizimin e dënimit. I kushtohet rëndësi e veçantë analizës së elementëve të anës objektive të veprës penale, mbetjes së saj në fazën e tentativës, kriterëve të individualizimit të dënimit, etj.
- Dispozitivi i vendimit është i plotë, i qartë dhe në përputhje të plotë me pjesën arsyetuese të vendimit.

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e

gjqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *”...Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi shumë të mira në interpretimin dhe zbatimin e ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Analizon normën ligjore materiale të zbatueshme në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Ai ndalet për të identifikuar kërkimet e organit të prokurorisë dhe prapësimet e mbrojtjes, i analizon ato në raport me provat e paraqitura dhe konkludon për faktin penal si dhe për masën e dënimit që duhet caktuar.... Gjyqtari {...} ka njohuri shumë të mira të së drejtës penale, sidomos për ato vepra që përfshihen në kompetencën lëndore të gjykatave për krime të rënda....Gjithashtu ai zotëron njohuri të rregullave procedurale të gjykimit të zakonshëm penale (dosjet 2 dhe 3), të gjykimit të shkurtuar (dokumenti 1, dosja 1), të masave të sigurimit (dosja 5) apo të masave parandaluese civile ndaj pasurisë së lidhur me krimin e organizuar(dokumenti 3)...”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Përcaktimi i fakteve të çështjes, në 14 vendimet e analizuara, referuar natyrës së gjykimit (gjykim penal themeli, kërkesë penale apo gjykim në lidhje me kërkesat për sekuestrim/konfiskim pasurie) apo llojit të gjykimit të zhvilluar (gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar), fakti penal parashtrohet në nënndarjen e parë të çdo vendimi, në një pjesë të titulluar “Rrethanat e faktit”, në të cilën gjyqtari, pasi evidenton fillimisht elementë të ecurisë procedurale të çështjes (kërkesa për gjykim të shkurtuar, kompetenca në disa raste, zhvillimi i gjykimit në mungesë të të pandehurit, etj), vijon me përshkrimin e faktit penal sikurse ai ka rezultuar i provuar në gjykim, nga tërësia e provave të administruara. Paraqitja dhe analiza e rrethanave të faktit është në çdo rast e detajuar, e qartë dhe e plotë duke përshkruar ngjarjen gjatë së cilës ka ndodhur fakti penal, rolin e të pandehurit/ve në realizimin e tij, veprimet që tregojnë bashkëpunimin midis të pandehurve apo midis tyre me persona të pidentifikuar, etj.

Pas paraqitjes dhe analizës së faktit penal në pjesën e parë të arsyetimit të vendimit, në një pjesë të dytë të tij, të titulluar “provat e marra”, si në çështjet në të cilat është proceduar me gjykim të shkurtuar ashtu edhe në ato në të cilat është proceduar me gjykim të zakonshëm, gjyqtari bën

paraqitjen e provave duke evidentuar, në një pjesë të tyre, elementët e faktit që rezultojnë të mbështetur në secilën provë. Në çështjet në të cilat është proceduar me gjykim të zakonshëm, kjo pjesë e arsytimit dhe paraqitja e provave bëhet në mënyrë më të zgjeruar dhe përshkruese se sa në çështjet kur provat e marra gjatë hetimit paraprak, janë kthyer në prova të gjykimit për shkak të gjykimit të shkurtuar. Paraqitja e rrethanave të faktit në një pjesë të veçantë dhe paraqitja e provave mbi të cilat ai mbështetet, duke veçuar pjesë të përmbajtjes së tyre që i shërbejnë vërtetimit të ekzistencës së faktit penal dhe rolit të të pandehurve, i jep qartësi faktit penal dhe mbështetet provueshmërinë e fakteve objekt gjykimi në secilin vendim.

Gjithashtu, paraqitja dhe analiza e rrethanave të faktit, kur është e nevojshme, përqendrohet edhe në evidentimin e elementëve apo veprimeve që provojnë ekzistencën e rrethanave të tilla si, formën e kryerjes së veprës penale (vendimi 1, 2, dosja 1, 2, 3, 8, 10, 11), elementët e bashkëpunimit ose mungesën e tyre (vendimi 1, 2, dosja 1, 2, 3, 7, 8, 9, 10) mbetjen e veprave penale në fazën e tentativës (vendimi 1, 2, dosja 1, 3, 9, 11), lidhjen shkakësore, autorësinë, cilësinë dhe rolin e secilit të pandehur në faktin penal të provuar, analizën e elementëve cilësues të veprave penale për të cilat procedohet, etj. Po ashtu i kushtohet rëndësi evidentimit të fakteve të cilat ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit, në secilin vendim penal themeli për të cilin gjykata ka vendosur dënimin e të pandehurit/ve. Në këto raste, faktet përkatëse janë marrë në analizë në fund të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit, duke i analizuar ato në mënyrë specifike dhe konkrete së bashku me kriteret ligjore të individualizimit të dënimit.

Në çështjet me objekt sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë (vendimi 3, dosja 4) gjyqtari i kushton rëndësi të veçantë fakteve të çështjes, jo vetëm duke i përshkruar por edhe duke i analizuar në mënyrë të plotë dhe të detajuar ato, si përsa i përket procedimit penal me të cilin lidhet procedimi pasuror, ashtu edhe përsa i përket përshkrimit dhe analizës së procedimit pasuror dhe fakteve që kanë rezultuar për shkak të tij.

Po ashtu, provat dhe faktet e paraqitura nga mbrojtja e të pandehurit/të paditurit, evidentohen në mënyrë të hollësishme në përmbajtjen e arsytimit të vendimit si dhe në pjesën që i kushtohet individualizimit të dënimit në rastet kur provat dhe faktet kanë lidhje me këtë aspekt. Në paraqitjen e fakteve gjyqtari i kushton vëmendje të veçantë përballjes së rrethanave të faktit të vërtetuara me ato të pretenduara nga palët.

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha vendimet e analizuara, gjyqtari përcakton qartë natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, e cila orjenton më pas ndërtimin e një strukturë specifike në organizimin e arsytimit të vendimeve, në çështje me natyra të ndryshme (penale themeli, kërkesa me objekt sekuestrim ose konfiskim pasurie, kërkesa me objekt vlerësim arresti dhe caktim mase sigurimi).

Në çështjet që kanë të bëjnë me kërkesat për sekuestrim ose konfiskim pasurie, përcaktimi i natyrës së çështjes, karakterit të posaçëm të saj si dhe qëllimin e procedurave të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë, si masa që zbatohen ndaj pasurisë së personit të dyshuar dhe jo ndaj tij si person, bëhet që në fillim të pjesës arsyetuese të vendimit. Në këto procese, në përcaktimin e natyrës së çështjes, si çështje që drejtohet mbi pasurinë e personit, argumentit të gjyqtarit mbi natyrën e çështjes, i shtohet edhe kujdesi që ai tregon për të përcaktuar se natyra e këtij

procedimi sipas legjislacionit vendas, është në harmoni me legjislacionin ndërkombëtar (vendimi 3).

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në 14 vendimet e vëzhguara, evidentohet aftësia e gjyqtarit për të përcaktuar qartë dhe saktë ligjin e zbatueshëm, duke evidentuar në gjithë përmbajtjen e vendimit, dispozitat e ligjit procedural penal dhe ligjit material, në vendin e duhur dhe në shërbim të analizës ligjore të çështjes.

Konkretisht, gjyqtari ka referuar në çdo rast, si pjesë e integruar e arsytimit të vendimit, dispozita të ligjit procedural penal në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatës (dosja 3, dosja 4, dosja 10, vendimi 1, vendimi 2), procedurën e gjykimit të shkurtuar (vendimi 1, dosja 1, dosja 7, dosja 8, dosja 9, dosja 10, dosja 11), ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale (vendimi 1, dosja 9), dispozitat ligjore lidhur me çmuarjen e provave dhe vlerën provuese të deklarimeve të bashkë të pandehurve, vlerën dhe peshën provuese të deklarimeve të bëra nga i pandehuri në fazën e hetimeve paraprake (vendimi 2, dosja 2, dosja 3, dosja 6), dispozitat procedurale që përcaktojnë pavlefshmërinë e akteve dhe papërdorshmërinë e provave (vendimi 2), detyrimin ligjor të organit të akuzës për të kryer hetim të plotë dhe të gjithanshëm si dhe barra e provës për të provuar akuzën e ngritur (vendimi 2), etj.

Në çështjet me objekt sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë gjyqtari përcakton ligjin e zbatueshëm (Ligji nr. 10 192, datë 03.12.2009, Kodi i Procedurës Civile, neni 274 i K.Pr.P dhe neni 36 i K.Penal), citon dispozita të veçanta lidhur me fushën e zbatimit të ligjit, marrëdhënien e procedimit pasuror me procedimin penal, kushtet e pranimit të kërkesës për konfiskimin e pasurisë (vendimi 3), kushtet dhe kriteret ligjore të vendosjes së masës së sekuestrimit preventive (dosja 4). Dispozitat referohen si pjesë e integruar e arsytimit të vendimit, posaçërisht dispozitat me natyrë procedurale të ligjit të posaçëm me nr. 10192, datë 3.12.2009 si dhe dispozita procedurale të Kodit të Procedurës Civile lidhur me dhënien e mundësisë palëve për të realizuar mbrojtjen (nenet 4 dhe 14 të K.Pr.C), kryerjen e ekspertimit, barrën e provës së palëve lidhur me pretendimet e ngritura prej tyre, etj.

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, në çdo rast referohen dispozita të Kodit Penal, të pjesës së posaçme në lidhje me veprat penale për të cilat procedohet si dhe dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal në lidhje me:

- bashkëpunimin, elementët e anës objektive dhe subjektive të bashkëpunimit kur ai përben rrethanë cilësuese të veprës penale (vendimi 2, vendimi 2, dosja 1, 3, 8).
- kuptimin e tentativës dhe përgjegjësinë penale për veprat e mbetura në këtë fazë (vendimi 1, 2, dosja 1, 2, 3, 7, 8, 9 dhe 11)
- format e veçanta të kryerjes së veprës penale të “Trafikimit të narkotikëve” apo “Trafikimit të qenieve njerëzore”, duke iu referuar për përcaktimin e tyre dispozitës së posaçme të Kodit Penal së bashku me referimin e parashikimeve të Ligjit “Për lëndët narkotike dhe barnat psikotrope” si dhe Konventave respektive të Këshillit të Evropës dhe Kombeve të Bashkuara.
- kriteret ligjore të individualizimit të dënimit duke referuar parashikimet e nenit 47, 48 dhe 49 të kodit Penal. Në identifikimin e ligjit të zbatueshëm në raport me përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit, gjyqtari ka referuar nenin 53 në lidhje me uljen e dënimit në minimum (dosja 1, dosja 2, dosja

10), si dhe kushtet dhe kriteret për aplikimin e pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien e të pandehurit në provë, referuar nenit 59 të Kodit Penal (dosja 2, dosja 7, dosja 10) .

- në çështjet me objekt sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë, gjyqtari identifikon dispozitat e ligjit të posaçëm në lidhje me kushtet dhe kriteret ligjore që duhet të rezultojnë të provuara për të aplikuar, sipas rastit sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë (vendimi 3, dosja 4) si dhe identifikon parashikimet e këtij ligji lidhur me natyrën e procedimit dhe aplikimin e masave në kuadër të procedimit pasuror (vendimi 3), etj.

Sa i përket aspektit të evidentimit të konfliktit të normave, kur ka qenë e nevojshme (në rastin konkret vetëm në një çështje, vendimi 3) në çështjet me objekt konfiskimin e pasurisë, gjyqtari evidenton ligjin e posaçëm që përcakton fushën e veprimit dhe qëllimin e ligjit dhe normat e ligjit penal që përcaktojnë natyrën e procedimit penal dhe qëllimin e tij.

Në raste të veçanta dhe kur ka qenë e nevojshme, gjyqtari ka identifikuar për efekt të veprimeve procedurale, si ligj të zbatueshëm, edhe dispozita të Konventës së Këshillit të Evropës “Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën penale” (dosja 6).

Gjithashtu, gjyqtari ka identifikuar si ligj të zbatueshëm edhe:

- dispozita të Konventës së Palermos dhe Konventës së Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore” në lidhje me dhënien e kuptimit të trafikimit të qenieve njerëzore. Në dhënien e kuptimit të këtij koncepti sipas legjislacionit shqiptar, gjyqtari referon përputhjen e legjislacionit penal shqiptar me Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër kimit të organizuar dhe protokolleve shtesë të saj (dosja 6).

- dispozita të Konventës së OKB-së “Për trafikun e paligjshëm të drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope” për dhënien e kuptimit të tranzitimit si formë e kryerjes së veprës penale (dosja 7);

- dispozita të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (dosja 2, dosja 3, vendimi 2, vendimi 3) lidhur me elementë të procesit të rregullt ligjor;

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira për identifikimin tepër të qartë dhe të plotë të fakteve të çështjes, identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, referimin, duke evidentuar edhe konfliktin në dukje të normave, në rastet kur ka qenë e nevojshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin e “aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” vlerësohet “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë :

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se :
“..Njeh parimet e përgjithshme të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe i zbaton ato në praktikë, si dhe i bën ato pjesë të vendimeve gjyqësore shprehimisht. Njeh dhe zbaton të drejtën ndërkombëtare (shih dosjet 2 dhe 3), njeh dhe zbaton vendimet e GJEDNj (shih dosjet 2 dhe 3), njeh dhe zbaton vendimet e Gjykatës Kushtetuese (shih dokumentin 2, dosjet 2 dhe 3) si dhe vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë (shih dokumentet 1 dhe 2, si dhe dosjet 1,2 dhe 3)...Bën lidhjen e pjesës së përgjithshme me atë të posaçme të Kodit Penal, duke identifikuar rastin kur vepra penale është kryer në bashkëpunim (dokumenti 1, dosja 1 dhe 3), kur vepra penale nuk është përfunduar dhe ka mbetur në tentativë (dokumenti 1 dhe dosjet 1 dhe 3), si dhe zbaton me korrektësi kriteret e individualizimit të masave të dënimit (dokumenti 1 dhe 2, dosjet 1,2 dhe 3)...”

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Dispozitat ligjore të ligjit penal procedural dhe material, jo vetëm referohen, por merren në analizë si pjesë e integruar e arsytimit të gjykatës në gjithë përmbajtjen e pjesës arsyetuese të vendimit, shoqëruar fillimisht me një interpretim të pavarur të tyre nga ai i aplikimit mbi faktet e çështjes, apo rrethanat procedurale konkrete.

Gjyqtari i kushton vëmendje të posaçme interpretimit të normave procedurale, kryesisht në lidhje me:

- llojin e gjykimit të aplikuar (gjykim i posaçëm apo i shkurtuar) ku në çdo rast referohet neni 404 i K.Pr.P dhe jepet kuptimi i tij si dhe kushtet për pranimin ose jo të kërkesës për procedim me këtë lloj gjykimi (vendimi 1, dosja 1, 7,8,9,10,11) duke referuar në mbështetje të interpretimit të ligjit procedural edhe qëndrimin e Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr.3/2003 si dhe në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 4, datë 10.2.2012 si dhe praktikën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (referohet vendimi nr. 62, datë 29.2.2012, nr. 64, datë 5.3.2014) në një rast që kërkesa e të pandehurit nuk është pranuar për shkak se gjykata ka vlerësuar se çështja nuk mund të zgjidhej në gjendjen që ishin aktet (dosja 2);
- kompetencën lëndore të gjykatës (dosja 3, dosja 4, dosja 10, vendimi 1, vendimi 2);
- respektimin e të drejtave dhe garancive procedurale për të pandehurin e huaj për tu asistuar nga përkthyesi dhe për të patur mbrojtës (vendimi 2);
- marrjen dhe vlerësimin e provave (vendimi 1,2, dosja 1,2,3,6,7,8,9,10,11), vlerën provuese të thënieve të të pandehurit në procedim të lidhur, deklaratimet e të pandehurit gjatë fazës së hetimit paraprak dhe vlerën provuese të tyre (dosja 3), deklaratimet e dëshmitarëve në kuadër të kundërshtimit të dëshmisë dhe vlerën provuese të tyre, etj.
- pavlefshmërinë e akteve dhe papërdorshmërinë e provave (vendimi 2);

- ndryshimin e kualifikimit ligjor të faktit penal, paraqitjen e akuzës së re gjatë gjykimit si dhe kushtet e pranimit të këtyre kërkimeve si dhe procedimin në lidhje me njoftimin e të pandehurit lidhur me këto zhvillime procedurale (dosja 6) si dhe analiza e tyre në rastet e vlerësimit për mospranimin e kërkesës së mbrojtjes për ndryshimin e kualifikimit ligjor të faktit penal (dosja 8);
- fushën e zbatimit të ligjit, natyrën e veçantë të procedimit në çështjet me karakter pasuror, rregullat e veçanta procedurale të zhvillimit të gjykimit, barrën e provës, marrjen e provës me ekspert, vlerësimin e qëndrimit të palëve, etj (vendimi 3, dosja 4);
- kushtet ligjore të vlefhtësisë të ligjshëm të arrestimit si dhe kushtet dhe kriteret ligjore të caktimit të masave të sigurimit personal (dosja 5).

Sa i përket interpretimit të ligjit material të zbatueshëm, në çdo rast referohen, citohen herë pas here dhe analizohen në mënyrë të plotë dispozitat të Kodit Penal, të pjesës së posaçme në lidhje me veprat penale për të cilat procedohet si dhe dispozitat të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal të cilat janë vlerësuar me vend për t'u marrë në analizë në mbështetje të arsytimit të vendimit, në lidhje me:

- bashkëpunimin, elementët e anës objektive dhe subjektive të bashkëpunimit kur ai përben rrethanë cilësuese të veprës penale (vendimi 2, vendimi 2, dosja 1, 3, 8). Në të gjitha këto raste kur bashkëpunimi ka përbërë rrethanë cilësuese të veprës penale të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, kuptimi dhe analiza e këtij instituti është bërë në mënyrë të plotë si për elementët të anës objektive ashtu edhe të anës subjektive të veprës, duke mbështetur interpretimin e ligjit në qëndrimin unifikues të K.B të Gj.L në vendimin nr. 4/2011.
- kuptimin e tentativës dhe përgjegjësinë penale për veprat e mbetura në këtë fazë (vendimi 1,2, dosja 1, 2, 3, 7, 8, 9 dhe 11). Në analizën e institutit të tentativës, gjyqtari i kushton rëndësi klasifikimit të saj si tentative e metë apo e plotë, për efekt të përcaktimit të përgjegjësisë penale të të pandehurve. Gjithashtu kur është rasti, interpreton nenin 22 të K.P në përputhje me praktikën unifikuese dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, konkretisht vendimin nr. 3, datë 24.1.2011;
- format e veçanta të kryerjes së veprës penale të “Trafikimit të narkotikëve” apo “Trafikimit të qenieve njerëzore”, duke iu referuar për përcaktimin e tyre dispozitës së posaçme të Kodit Penal së bashku me referimin dhe interpretimin e parashikimeve të Ligjit “Për lëndët narkotike dhe barnat psikotrope” si dhe Konventave respektive të Këshillit të Evropës dhe Kombeve të Bashkuara si dhe vendimin unifikues nr. 3/2011(dosja 11).
- kriteret ligjore të individualizimit të dënimit duke referuar parashikimet e nenit 47, 48, 49, 53, 55 dhe 59 të Kodit Penal, duke interpretuar në mënyrë logjike dhe sistematike dispozitat penale. Në analizën e ligjit në raport me përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit, gjyqtari ka analizuar në mënyrë të posaçme kuptimin e nenit 53 në lidhje me uljen e dënimit në minimum (dosja 1, dosja 2, dosja 10), si dhe kushtet dhe kriteret për aplikimin e pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien e të pandehurit në provë, referuar nenit 59 të Kodit Penal (dosja 2, dosja 7, dosja 10). Interpretimi ligjor është bërë duke i dhënë përgjigje edhe pretendimeve të mbrojtjes së të pandehurve për aplikimin ose jo të këtyre dispozitave.
- në çështjet me objekt zbatimin e masës së sekuestrimit ose konfiskimit të pasurisë, gjyqtari interpreton dispozitat e ligjit të posaçëm në lidhje me kushtet dhe kriteret ligjore që duhet të rezultojnë të provuara për të aplikuar, sipas rastit sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë (vendimi 3, dosja 4) si dhe interpreton parashikimet e këtij ligji lidhur me natyrën e procedimit, ndryshimin e tij nga procedimi penal dhe lidhjen e tyre me njëri tjetrin, ndikimin e fakteve që rezultojnë nga procedimi penal me faktet dhe aplikimin e masave në kuadër të procedimit pasuror (vendimi 3), etj.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, në çdo rast janë respektuar me korrektësi aspektet e parimit të procesit të rregullt ligjor, duke referuar dhe interpretuar në disa raste, edhe aspekte të veçanta të këtij parimi të tilla si e drejta e të pandehurit që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht dhe e drejta për të pyetur dhe kërkuar të merren në pyetje dëshmitarët (neni 6 pg 1 dhe neni 6 pg 3 shkronja “d” të KEDNJ) (vendimi 2, dosja 3).

Gjithashtu janë zbatuar edhe parime të tjera të procesit penal të tilla si veprimi në kohë i ligjit penal material parashikuar nga neni 3 i K. Penal që bën fjalë për zbatimin e ligjit penal favorizues, parimi “in dubio pro reo” parashikuar nga neni 4 i Kodit të Procedurës Penale, (“çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit” dosja 8).

Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante, në shumicën e vendimeve të analizuar, rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij, posaçërisht në rastet që lidhen me:

- aplikimin ose jo të procedimit me gjykim të shkurtuar (Vendimi 1, dosja 1, 7,8,9, 10 dhe 11). Në këto vendime, në çdo rast është referuar dhe analizuar, së bashku me bazën ligjore procedurale, edhe vendimi unifikues nr. 2, datë 29.1.2013 si dhe në një rast, edhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 4, datë 10.2.2012 si dhe qëndrimet e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në vendimet nr. 62, datë 29.2.2012 dhe nr.64, datë 5.3.2014 ;
- përjashtimin nga përgjegjësia penale për shkak të mbajtjes së lëndës narkotike për përdorim vetiak (vendimi 1). Në këtë rast në mbështetje të analizës lidhur me rrethanat e faktit dhe përgjegjësinë penale të të pandehurit M.D, gjyqtari ka referuar dhe interpretuar qëndrimin e Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr. 1, datë 27.3.2008 sa i përket përcaktimit të « dozës së vogël » së lëndës narkotike ;
- vlerësimin e bashkëpunimit si element cilësues i veprës penale (vendimi 1, vendimi 2, dosja 3). Në këto raste gjyqtari ka referuar dhe zbatuar praktikën unifikuese të Gj.L në vendimin nr. 4, datë 15.4.2011 lidhur me vlerësimin e elementëve të anës objektive dhe subjektive sa i përket bashkëpunimit, marrëveshjes mes të pandehurve, etj.
- vlerësimin lidhur me formën e kryerjes së veprës penale të «Trafikimit të lëndëve narkotike » dhe mbetjen e saj në fazën e tentativës (vendimi 1,dosja 2, dosja 3 dosja 11). Në këto raste analizohet forma e kryerjes se veprës penale, interpretohet neni 283/a i K.Penal, ligjet e posaçme, dispozitat e akteve ndërkombëtare (siç është analizuar më sipër) dhe në mbështetje të argumentit të gjykatës, referohet edhe vendimi unifikues nr. 3, datë 24.1.2011 ;
- përdorimin e deklarimeve të marra prej të pandehurit në fazën e hetimit paraprak si dhe vlerësimin e vlerës provuese të tyre (vendimi 2, dosja 3). Në këto raste, në marrjen dhe çmuarjen e deklarimeve të të pandehurit gjatë hetimit, gjyqtari interpreton neni 370 të K.Pr.P, duke arritur në konkluzionin se vlera provuese e deklarimeve çmohet në gjykim, pas analizës së kujdesshme në raport me provat e marra gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në mbështetje të këtij vlerësimi, gjyqtari referon dhe citon qëndrimin e gjykatës Kushtetuese në vendimin nr.19, datë 18.9.2008 si dhe vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut me datë 27 shtator 1990.

Në tërësi, në vendimet përfundimtare të vëzhguara, interpretimi i dispozitave ligjore, përveç analizës specifike të kuptimit të tyre, pasurohet me referimin dhe analizën e dispozitave të akteve ndërkombëtare që gjejnë zbatim si dhe me praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë, praktiken

gjqësore të Kolegjit Penal të GJ.L, praktikën e Gjykatës Kushtetuese dhe jurisprudencën relevante të GJEDNJ.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira të interpretimit të ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe, kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësorë unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.B. ARSYETIMI LIGJOR

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë :

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se :”*Nga pikëpamja formale ai respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor rregullisht të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten me gjatësi normale dhe të kuptueshme. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor...Dispozitivi hartohet me tekst të qartë dhe të plotë, duke treguar sipas rastit të gjitha disponimet e gjykatës që shoqërojnë vendimin e fajësisë ose të pafajësisë, vendin e vuajtjes së dënimit, disponimin për provat materiale e gjer tek e drejta e ankimit për palët.*”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Gjuha e përdorur nga gjyqtari në vendimet përfundimtare, gjatë gjykimit dhe në aktet procedurale të dosjeve të analizuara është në çdo rast e thjeshtë, e drejtpërdrejtë, e qartë dhe e kuptueshme për pjesëmarrësit në proces, si dhe për lexuesin e akteve. Mënyra e organizimit dhe shprehjes në arsyetimin e vendimeve dhe përdorimi i thjeshtë dhe i kujdesshëm e gjuhës, përzgjedhja e fjalëve, organizimi i tyre në fjali dhe më pas në paragrafë që kanë lidhje logjike mes njëri tjetrit, në të gjitha aktet e marra në shqyrtim, reflekton qartësinë e mendimit dhe

arsyetimit të vendimeve gjyqësore, të organizuar mbi baza logjike dhe vazhdimësie, duke mos lënë hapësirë për kuptim të gabuar apo të ndryshëm të mendimit të shprehur nga lexuesi i akteve.

Në të gjitha vendimet e vëzhguara, nuk rezultojnë të jenë përdorur terma teknikë apo fjalë që krijojnë konfuzion në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren, përveç termave të referuar në përshkrimin apo citimin e përmbajtjes së provave të tilla siç janë aktet e ekspertimit, terma të cilët janë të njohur dhe kuptimi i tyre është i qartë nga konteksti apo lloji i provës në të cilën janë fiksuar këto terma.

Janë përdorur të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe, janë respektuar rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës në formimin e fjalëve dhe fjalive, duke i bërë vendimet tërësisht të qarta dhe të shkruara në mënyrë korrekte në këtë aspekt.

Gjyqtari përdor përgjithësisht fjali me gjatësi mesatare për të shprehur mendimin, të cilat janë të qarta, të kuptueshme dhe të organizuara në rrjedhë logjike të njëra tjetrës. Gjithashtu paragrafët dhe nënndarjet e arsyetimit të vendimit janë në vijimësi logjike të mendimit dhe nuk krijojnë shkëputje të logjikës së arsyetimit, brenda së njëjtës nënndarje të arsyetimit të vendimit apo në gjithë vendimin në tërësi.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRË ORGANIZUAR E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë :

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim);

Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD -së lidhur me këtë tregues, konkludohet se :” *Subjekti i rivlerësimit {...} harton vendime me strukturë të standardizuar. Vendimet përfundimtare të tij respektojnë plotësisht kërkesat e ligjit procedural penal. Struktura është e qëndrueshme, e mirë organizuar dhe e standardizuar. Përmbajtja e*

vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimeve ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Analiza ligjore është e detajuar duke paraqitur normën penale të zbatueshme dhe duke dhënë arsyet pse ajo zbatohet në rastin konkret. ...”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Vendimet përfundimtare të vëzhguara janë të organizuara sipas një strukture të qartë dhe përgjithësisht të njëjtë, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese - arsyetuese dhe dispozitivin e vendimit, sipas parashikimeve të nenit 383, të Kodit të Procedurës Penale. Të gjitha vendimet ndjekin kryesisht të njëjtën strukturë, me disa specifika që diktohen nga procedura e ndjekur për gjykimin si dhe objekti i çështjes.

Pjesa hyrëse e të gjitha vendimeve përmban të gjithë elementët e nevojshëm në lidhje me përcaktimin e gjykatës, përbërjen e trupit gjykues, kohës së zhvillimit të gjykimit, të dhënat e plota të palëve dhe përfaqësuesve të tyre, akuzën e plotë ose objektin e kërkesës dhe nenet përkatëse të Kodit Penal ose ligjeve të posaçme në rastin e çështjeve me objekt specifik (ligji antimafia), si dhe kërkimet përfundimtare të palëve në mënyrë të plotë ose të përmbledhur.

Pjesa përshkruese- arsyetuese e vendimeve gjithashtu ndjek një strukturë të mirë përcaktuar, e cila ndiqet pothuajse në çdo rast, të organizuar nënndarje të titulluara sipas përmbajtjes së tyre, duke orientuar qartë lexuesin. Organizimi i pjesëve të arsyetimit të vendimit ka ndjekur të njëjtën strukturë, duke filluar me paraqitjen rrethanave procedurale të çështjes, paraqitjen e faktit penal të provuar gjatë gjykimit, përshkrimin e provave të marra gjatë gjykimit, pjesë në fund të së cilës parashtrihen dhe pretendimet e mbrojtjes së të pandehurit, analiza ligjore mbi provat dhe cilësimin juridik të veprës penale si dhe caktimin e llojit dhe të masës së dënimit, pjesë në fund të së cilës evidentohen edhe disponimet lidhur me kërkesën për disponimin mbi provat materiale si dhe për përcaktimin e institucionit në të cilin do të vuhet dënimi për të pandehurin.

Pjesët kryesore të arsyetimit të vendimit, të organizuara përgjithësisht sipas strukturës së mësipërme, përveç specifikave të diktuara nga natyra e kërkesës, sikurse është rasti i kërkesave për sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë (vendimi 3, dosja 4) ose kërkesave të fazës së hetimit paraprak (dosja 5) në të cilat nuk ka nënndarje lidhur me individualizimin e dënimit, organizohen në brendësi të tyre në disa nënndarje të tjera sipas specifikave (provat me dëshmitarë të marra gjatë gjykimit, provat shkresore të shqyrtuara, provat e marra me kërkesë të mbrojtjes, etj) duke theksuar edhe në këto nënndarje specifikën përkatëse nëpërmjet fjalisë hyrëse. E gjithë përmbajtja e vendimit është e ndarë në paragrafë të cilat në shumicën e vendimeve përmbajnë edhe numërtim, të cilët lidhen me njëri tjetrin duke krijuar vijueshmëri të arsyetimit.

Dispozitivi i vendimeve është i plotë, i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, duke përmbajtur në mënyrë të qartë të gjitha disponimet e gjykatës lidhur me fajësinë ose pafajësinë e të pandehurve, akuzën përkatëse, nenet respektive të Kodit Penal, llojin dhe masën e dënimit, bashkimin e dënimeve dhe uljen e dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar kur është aplikuar, kohën e fillimit të llogaritjes së tij, institucionin e vuajtjes së dënimit, disponimin e plotë për provat

materiale, shpenzimet procedurale si dhe të drejtën e ankimit. Pjesa urdhëruese e vendimit është e qartë, koncize, e plotë, e lexueshme dhe e kuptueshme duke bërë të qarta disponimet e gjykatës lidhur me të gjithë elementët e disponimit në vendimin përfundimtar në funksion të qartësisë së tij për palët dhe lexuesin si dhe ekzekutimit të tij.

Në rastin e disponimit për kërkesën e prokurorisë për konfiskimin e pasurisë, si një lloj i veçantë procedimi dhe vendimmarrje, vendimi është sërish i organizuar sipas një strukture të qartë dhe të kuptueshme, të organizuar në nënndarje dhe paragrafë të cilët, edhe pse qëndrojnë të ndarë dhe të titulluar sipas përmbajtjes, lidhen me njëri tjetrin në mënyrë logjike. Në këtë rast dispozitivi i vendimit përmban disponimet e plota sipas përcaktimeve të ligjit të posaçëm nr. 10192, posaçërisht neneve 26 dhe 27 të tij që përcaktojnë elementët e vendimit të gjykatës për konfiskimin e pasurisë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit. Në të gjitha vendimet e analizuara, ndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirëpërcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecures logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, i bën vendimet lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme dhe orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë :

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim);

Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se :”..Analiza ligjore është e detajuar duke paraqitur normën penale të zbatueshme dhe duke dhënë arsyet pse ajo zbatohet në rastin konkret. Në analizën ligjore nuk mungojnë sipas rasti referenca në normat ndërkombëtare, KEDNj, por edhe referenca në jurisprudencën e GJEDNj, Gjykatës Kushtetuese dhe në jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë. Gjyqtari në çdo rast të vëzhguar, qoftë dokument ligjor apo dosje, vlerëson dhe çmon provat në raport me kërkesat e ligjit penal, sqaron se çfarë u provua me përmbajtjen e tyre dhe argumenton se përse janë të bazuara ose të pabazuara pretendimet e palëve në proces. Në lidhje

me vlerësimin e provave dhe analizën e tyre ligjore duhet evidentuar se gjyqtari në një rast konkret, ka deklaruar me vendim të ndërmjetëm si të papërdorshme një prove të marrë në fazën e hetimit paraprak duke përjashtuar marrjen e saj si provë në gjykim (dosja 3)...Jep përgjigje të argumentuar ligjore se përse nuk janë të pranueshme pretendimet e të pandehurit për uljen e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji penal apo pse nuk duhet zbatuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim....”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Përveç analizës së plotë të faktit penal në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit, fakti rimerret sërish në analizë, në mënyrë të integruar me analizën e ligjit, në pjesën e tretë të arsytimit të vendimit, në raport me ekzistencën dhe provueshmërinë e elementëve të figurës së veprës penale për të cilën procedohet, rolin e të pandehurit/pandehurve në realizimin e faktit penal objekt akuze, vlerësimit të ndryshëm të gjykatës lidhur me kualifikimin ligjor të faktit penal, kryesisht ose duke iu përgjigjur pretendimeve të mbrojtjes së të pandehurit për ndryshimin e kualifikimit (dosja 1, dosja 8), vlerësimin për bazueshmërinë ose jo të pretendimeve të palëve lidhur me kërkimin për pafajësinë e të pandehurit ose pushimin e akuzës/çështjes (vendimi 1, vendimi 2, dosja 1, dosja 3, dosja 6, dosja 8, dosja 9. Gjyqtari në çdo rast ka përshkruar dhe analizuar në mënyrë të plotë dhe të qartë faktin penal të provuar në gjykim si dhe paraqitjen dhe analizën e integruar të provave në raport me faktin penal, duke organizuar më pas analizën ligjore të çështjes në funksion të drejtpërdrejtë të arritjes dhe mbështetjes së konkluzioneve të tij.

Në secilin vendim, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit apo llojit të gjykimit të zhvilluar (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*), analiza dhe arsytimi i gjykatës shtjellohen në mënyrë logjike, duke integruar interpretimin dhe analizën ligjore të elementëve të veprës penale, koncepteve dhe instituteve, të shoqëruar në çdo rast me analizën e fakteve të provuara në gjykim.

Në paraqitjen e faktit penal dhe provave, evidentohet një analizë e mirëfilltë dhe e plotë e të dhënave që rezultojnë nga provat të vlerësuara në tërësi dhe në raport me njëra tjetrën, në mbështetje të konkluzionit mbi faktin e pranuar si të provuar në gjykim. Paraqitja dhe analiza e elementëve të faktit penal në lidhje me veprën penale si dhe autorësinë, si në pjesën ku fakti paraqitet në një nënndarje të veçantë ashtu edhe në pjesën e arsytimit ligjor të gjykatës ku ai integrohet në mënyrë të natyrshme me analizën ligjore, përbën një analizë të plotë, të gjithanshme dhe të mirëfilltë të tij, si produkt i vlerësimit të integruar dhe tërësor të provave të marra dhe shqyrtuara gjatë gjykimit.

Karakteristikë e gjyqtarit është veçimi dhe analiza më e detajuar e fakteve esenciale të cilat kanë rezultuar të provuara në gjykim dhe marrja në analizë e tyre në drejtim të ekzistencës së elementëve të figurës së veprës penale për të cilën procedohet dhe autorësinë e saj, paraqitja e provave në lidhje me secilin fakt, duke lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë provën/provat përkatëse me aspektin ligjor konkret për të cilin ajo shërben, si dhe elementin që sjell secila provë në shërbim të provueshmërisë së tij, duke evidentuar qartë dhe në mënyrë të natyrshme lidhjen shkak-pasojë mes veprimeve të të pandehurve në raport me faktin penal të provuar. Gjithashtu, gjyqtari është ndalur, kur ka qenë e nevojshme, në evidentimin dhe analizën e shkaqeve që kanë ndikuar në kryerjen e veprës penale të cilat sjellin efekte në kualifikimin ligjor

të saj (dosja 6), përcaktimin e formës së kryerjes e veprës penale në rastet e procedimit për veprat penale të trafikimit të narkotikëve ose qenieve njerëzore, përballjen e deklarimeve kontradiktore të të pandehurve gjatë hetimit apo gjyqimit, me qëllim përcaktimin e besueshmërisë si dhe vlerës provuese të këtyre deklarimeve, vlerësuar në raport me provat e tjera të marra në gjykim, etj.

Në çdo rast dispozitat e ligjit procedural penal dhe civil (procedimi pasuror) referohen dhe analizohen në mbështetje të vlerësimit të gjyqtarit në raport me zbatimin e tyre apo në mbështetje të rrethanave specifike procedurale në të cilat ato gjejnë zbatim. Interpretimi dhe analiza e integruar e normave ligjore procedurale dhe materiale, në raport me faktet e provuara në gjykim, i shërben arsyetimit për çdo fakt që lidhet me provueshmërinë e elementëve të veprave penale për të cilat procedohet, ecurinë procedurale të gjyqimit, kushteve dhe kritereve ligjore të individualizimit të dënimit, kushteve dhe kritereve ligjore të aplikimit të masave të sigurimit personal dhe pasuror, konfiskimin e pasurisë, etj.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsyetimit me të cilën lidhet pretendimi (me aspektet procedurale të gjyqimit, marrjen e provave dhe mënyrën e marrjes së tyre, provueshmërinë e faktit, cilësimin ligjor të faktit penal, për llojin dhe masën e dënimit, etj). Duke u marrë në shqyrtim dhe analizuar, jo në një pjesë të veçantë të arsyetimit, por në pjesën përkatëse të arsyetimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret, pretendimet e palëve gjithnjë kanë marrë një përgjigje të argumentuar dhe analizuar plotësisht, në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme si pjesë e arsyetimit tërësor.

KONKLUZIONI

Në tërësi, në të gjitha vendimet e gjyqtarit, analiza ligjore si në lidhje me aspekte procedurale të zhvillimit të gjyqimit, mënyrën e marrjes së provave apo vlerësimin e atyre, ashtu edhe në analizën ligjore të veprës penale ose objektit të kërkesës penale në shqyrtim, është një analizë e plotë, e thellë, gjithëpërfshirëse dhe shteruese. Ajo përmbush në çdo rast jo vetëm standardet e procesit të rregullt ligjor, por pasurohet edhe me qëndrime të praktikës gjyqësore, të cilat duket se janë në vëmendje të veçantë të gjyqtarit, duke u integruar në mënyrë të natyrshme dhe në masën e duhur në arsyetim. Kjo mënyrë arsyetimi i jep vlerë të shtuar dhe cilësi të larta analizës dhe argumentimit të vendimeve. Vlerë e shtuar e cilësisë së arsyetimit të vendimeve gjyqësore, është edhe referimi dhe interpretimi i normave të akteve të së drejtës ndërkombëtare, të cilën gjyqtari duket se e ka patur në vëmendje në çdo rast, për të mbështetur interpretimin mbi kuptimin e dispozitave të ndryshme të legjislacionit vendas, apo për të vlerësuar nëse legjislacioni i brendshëm përputhet me standardet e vendosura nga aktet e së drejtës ndërkombëtare.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “cilësia e analizës dhe argumentit logjik” është “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarit”

KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se :”Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari përgjithësisht ka qenë e shpejtë, në intervale kohore nga 1 ditë (dosjet 4 dhe 5) deri në 4 muaj e 3 ditë (dosja 3). Në dy dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë dy muaj (dosja 2) dhe 21 ditë (dosja 1). Në të 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se është respektuar afati ligjor (dosja 4 dhe 5) apo ai standard i gjykimit (dosja 1, 2 dhe 3). Gjykimi brenda afateve është konstatuar edhe në 3 dokumentet e përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, ku është analizuar data e regjistrimit të çështjes në gjykatë në raport me datën e dhënies së vendimit përfundimtar. Kështu kohëzgjatja e gjykimit në këto 3 dokumente ka qenë 4 muaj e 12 ditë (dokumenti 1), 10 muaj e 10 ditë (dokumenti 2) dhe 1 vit (dokumenti 3) .”

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të behët duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari.

Në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve penale të themelit. Ndërkohë për shqyrtimin e kërkesave të fazës së hetimeve paraprake dhe kërkesave për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë në bazë të ligjit të posaçëm, parashikohen afate ligjore gjykimi.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se vetëm për tre prej tyre (dosja 4, dosja 5 dhe vendimi 3) ligji procedural ka parashikuar afat ligjor shqyrtimi.

Konkretisht për kërkesat penale me objekt “Vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi”, neni 259/5 i Kodit të Procedurës Penale (sipas formulimit të dispozitës në kohën e zhvillimit të gjykimit) parashikon shqyrtimin e kërkesës brenda afatit 48 orë nga momenti i paraqitjes së kërkesës së prokurorisë në gjykatë. Në rastin konkret (Dosja 5) seanca gjyqësore është planifikuar dhe zhvilluar brenda 26 orësh nga momenti i regjistrimit të saj në gjykatë, duke respektuar afatin ligjor 48 orësh nga momenti i regjistrimit të saj sipas nenit 259 pika 5 të K.Pr.P¹¹.

Në rastin e kërkesave për sekuestrimin e pasurisë, neni 12 pika 1 i Ligjit nr. 10192 datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, parashikon afatin e shqyrtimit të tyre brenda pesë ditëve nga momenti i paraqitjes së saj nga prokuroria. Në rastin konkret (dosja 4) kërkesa është shqyrtuar për 1 ditë, duke respektuar afatin ligjor të shqyrtimit të saj. Ndërkohë, në lidhje me kërkesat për konfiskimin e pasurisë, neni 23 i Ligjit nr. 10192 datë 3.12.2009, parashikon shqyrtimin e tyre brenda tre muajve nga data e paraqitjes së kërkesës në gjykatë dhe në çdo rast jo më vonë se një vit nga data e paraqitjes së kërkesës, në rastin e çështjeve komplekse. Në rastin konkret (vendimi 3) gjykimi ka zgjatur 1 vit, duke përfunduar brenda afatit ligjor maksimal një vjeçar të parashikuar në nenin 23 pika 2 të Ligjit nr. 10192, sipas parashikimeve të këtij Ligji në kohën e zhvillimit të gjykimit në fjalë, duke marrë parasysh ndikimin e kompleksitetit të çështjes në kohëzgjatjen e gjykimit.

Për sa më sipër, duke iu referuar tre çështjeve për të cilat ligji parashikon afate ligjore shqyrtimi, rezulton se këto afate janë respektuar. Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar tre çështjeve të analizuara më sipër në të cilat afati ligjor i gjykimit është respektuar, aftësia e gjyqtarit në lidhje me këtë tregues, duhet të pikëzohet në nivelin maksimal të tij.

¹¹ Në nenin 259 pika 5 të K.Pr.Penale parashikohet se :”5. Arrestimi ose ndalimi e humbet fuqinë kur vendimi i gjykatës për vleftësimin nuk është shpallur brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme nga çasti në të cilin kërkesa e prokurorit është paraqitur në gjykatë. ”.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, në çështjet e analizuara për të cilat ligji ka parashikuar afat shqyrtimi, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i afateve ligjore” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi nuk ka asnjë çështje të shqyrtuar jashtë afatit ligjor.

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se nga ana e gjyqtarit janë respektuar standardet minimale kohore të gjykimit, duke iu referuar të njëjtit konkluzion të cituar në treguesin më sipër, për shkak se analiza e kohëzgjatjes së gjykimit për çështjet me afati ligjor dhe standard minimal kohor është bërë së bashku në raport¹².

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Për 8 nga çështjet e vëzhguara për të cilat nuk parashikohet afati ligjor gjykimi dhe 2 nga vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim, gjykimi ka përfunduar brenda standardit minimal kohor sipas Vendimit nr.261/2 të KLD¹³. Vetëm në një nga çështjet e përzgjedhura për vlerësim dhe konkretisht në dosjen 6 e cila i përket çështjes me nr. akti 03/04/08/20/61 akti, çështja është regjistruar në gjykatë më datë 23.4.2010 dhe gjykimi ka përfunduar më datë 26.3.2014, duke zgatur për një periudhë kohore prej 3 vite e 11 muaj, tej standardit minimal kohor 12 mujor për gjykimin e çështjeve penale për vepra penale për të cilat parashikohet dënimi më shumë se 10 vjet burgim ose burgim të përjetshëm.

¹²Shih konkluzionin e Raportit të Inspektoratit të KLD-së, cituar në treguesin më sipër.

¹³ Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se :” Standardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjykimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes si me poshtë: a. Gjykimet penale në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 4 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo më tej se 12 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.”.

Kjo çështje, ka zgjatur tej standardit kohor për disa arsye procedurale të cilat kanë qenë determinante për ecurinë e gjyqimit të tilla si : ngritja e mosmarrëveshjes së kompetencës lëndorë në Gjykatën e Lartë dhe pritja për t'u shprehur kjo gjykatë (nga seanca e datës 12.10.2010 deri në seancën e datës 26.1.2011, për një periudhë kohore prej 3 muaj e 14 ditë); kërkimi dhe pritja e informacionit nga Interpol Tirana lidhur me arrestimin e të pandehurit jashtë shtetit dhe vendndodhjen e tij (seanca e datës 26.1.2011 deri në seancën e datës 25.5.2011, për një periudhë prej 4 muajsh), dërgimi për herë të parë, përsëritja dhe pritja e përgjigjes për dy letërporositë e dërguara autoriteteve spanjolle të drejtësisë lidhur me procedurën e ekstradimit dhe vendndodhjen e të pandehurit (seanca e datës 25.5.2011 deri në seancën e datës 30.10.2012, për një periudhë prej 1 viti e 5 muaj e 5 ditë). Nëse afatit tërësor të kohëzgjatjes së gjyqimit prej 3 vite e 11 muaj do t'i zbritej kohëzgjatja e gjyqimit për efekt të kryerjes së veprimeve procedurale komplekse si më sipër (të cilat në tërësi kanë zgjatur për rreth 2 vite e 20 ditë), atëherë gjykimi, do të kishte përfunduar për një periudhë prej 1 viti e 10 muaj. Veç kohëzgjatjes së veprimeve si më sipër, rezulton se gjykimi, në disa seanca është shtyrë për të siguruar njoftimin dhe prezencën e prokurorisë, njoftimin dhe prezencën e mbrojtësve të të pandehurit, njoftimin e rregullt të të pandehurit para deklarimit të mungesës së tij, duke ndjekur të gjithë hapat procedurale të njoftimit të të pandehurit sipas parashikimeve të neneve 140 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.

Pavarësisht kohëzgjatjes së gjyqimit për një periudhë e cila tejkalon afatin standard të gjyqimit për çështjet penale krime për të cilat parashikohet dënimi me burgim 10 vjet ose dënimi me burgim të përjetshëm, rezulton nga ecuria procedurale e gjyqimit, se kohëzgjatja e gjyqimit është kushtëzuar nga zbatimi i rregullave procedurale që garantojnë zhvillimin e procesit të rregullt ligjor me qëllim garantimin e njoftimit të rregullt dhe për të siguruar pjesëmarrjen e të pandehurit në gjykim.

Nëse do t'i referohemi përlllogaritjes së afatit të gjyqimit për të gjitha çështjet për të cilat ligji nuk parashikon afat ligjor dhe për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, rezulton se kohëzgjatja e tyre ka qenë nga 21 ditë (dosja 1) minimumi deri në 3 vjet e 11 muaj maksimumi (dosja 6).

Nëse në këtë vlerësim nuk do të merrej parasysh kohëzgjatja e dosjes 6, për të cilën standardi minimal kohor është tejkalar për shkaqet procedurale të përshkruara më sipër, të cilat janë pasqyruar në mënyrë të detajuar për çdo seancë, në përshkrimin e dosjes 6¹⁴, , rezulton se kohëzgjatja e gjyqimit të çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor ka qenë nga 21 ditë (dosja 1) deri në 10 muaj e 10 ditë (vendimi 2), tërësisht brenda standardit minimal kohor në fuqi për 10 nga 11 çështjet e vëzhguara.

Kryesisht gjykimi për 9 çështjet e përzgjedhura me short ka zgjatur nga 1 muaj e 3 ditë minimalisht, në 6 muaj e 3 ditë maksimalisht, por në çdo rast brenda standardit minimal kohor.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga 11/çështjet për të cilat zbatohen standartet minimale kohore, vetëm njëra prej tyre, ka përfunduar tej afatit prej 12/muajsh. Për sa më sipër, duke iu referuar në tërësi kohëzgjatjes së gjyqimit për 11 çështjet për të cilat zbatohet standardi minimal

¹⁴Shih përshkrimin e detajuar të ecurisë procedural të çështjes në faqen 15 të këtij raporti.

kohor, çështja e përfunduar jashtë afatit zë vetëm 9 % të tyre, prandaj gjyqtari duhet të vlerësohet për këtë tregues me pikët maksimale. Pavarësisht mënyrës së llogaritjes, edhe nëse ajo do të dilte mbi 9%, duke analizuar shkaqet që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit tej standardit dhe veprimet procedurale të kryera nga gjyqtari për të menaxhuar ecurinë e kësaj çështje, vlerësoj se vonesa në shqyrtim nuk kanë ndodhur për shkak të përgjegjësisë së gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar në të gjitha çështjet e analizuar, duke bërë përjashtim për njëjën prej tyre, kohëzgjatja e së cilës është deteminuar nga kompleksiteti i veprimeve procedurale të nevojshme për t'u kryer dhe jo si pasojë e menaxhimit të procesit nga gjyqtari. Gjithsesi kjo çështje nuk ndikon në pikëzim, pasi kjo çështje zë vetëm 9% të gjithë çështjeve të analizuar.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i standardeve minimale kohore” gjyqtari pikëzohet me 5 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara prej tij tej standardit minimal, është 9%.

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin e analizimit të aftësive profesional të Inspektoratit të KLD-së nuk ka të dhëna apo konkluzione lidhur me këtë tregues.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve që trajtohen në gjykata e posaçme (Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda në periudhën e vlerësimit).

Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues, do të bëhet duke iu referuar 9 çështjeve të përzgjedhura me short dhe 2 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, për të cilat zbatohet

standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjykimit¹⁵. Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështje, në raport me standardin minimal kohor për kategori (*të gjitha çështjet e marra në analizë janë çështje penale krime*), për 9 çështjet e përzgjedhura me short dhe 2 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim, mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për kategorinë e çështjeve “penale krime”, rezultojnë të jetë rreth 211 ditë ose rreth 7 muaj¹⁶. Pra, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është më e shkurtër se standardi minimal kohor për gjykimin e çështjeve penale të themelit në gjykatat e shkallës së parë, për të gjitha çështjet e kësaj kategorie. Ndërkohë, nëse nga kjo përllogaritje do të përjashtohet kohëzgjatja e gjykimit për dosjen 6, kohëzgjatja e së cilës është përcaktuar nga shkaqe procedurale objektive të cilat nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, sikurse u analizua në treguesin më sipër, kohëzgjatja mesatare e gjykimit për 10 çështje do të ishte 92 ditë ose 3 muaj e 2 ditë, dukshëm më e shkurtër se standardi minimal kohor për këtë kategori çështjesh.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, për të gjitha kategoritë e çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor si dhe ka të dhëna burimore, ka qenë më e shkurtër se standardi minimal kohor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” gjyqtari pikëzohet me 5 pikë, pasi ajo është më e shkurtër se standardi minimal kohor.

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD -së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit {...}, në periudhën e rivlerësimit, ka kryer detyrën e gjyqtarit dhe të kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Ai ka deklaruar se gjatë tre viteve të fundit i janë caktuar për gjykim 245 çështje nga të cilat 45 penale themeli, 56 kërkesa penale, 138 masa sigurimi, 4 masa sekuestro dhe 2 konfiskime. Ka mbartur në tre vitet e fundit të detyrës 4 çështje që sipas gjyqtarit i janë caktuar për gjykim në periudhën nëntor-dhjetor 2016. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 98.4 %. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata, për efekt të organizimit të shortit, konstatohet se në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013-8.10.2016, gjyqtari {...} ka*

¹⁵ Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se :” *Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi.*”

¹⁶ Kohëzgjatja mesatare e gjykimit për 11 çështje gjyqësore, duke përfshirë edhe kohëzgjatjen e gjykimit për 2 nga 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari.

përfunduar gjithsej 217 çështje gjyqësore, nga të cilat 212 çështje penale dhe 5 çështje civile antimafia.”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në total në gjithë periudhën e vlerësimit gjyqtarit {...} i janë caktuar: në vitin 2014 - 17 çështje penale si gjyqtar kryesues dhe 61 çështje si anëtar, kërkesa penale, masa sigurimi përgjime, 299 në tërësi. Ka përfunduar si kryesues 14 çështje penale; në vitin 2015 - 15 çështje penale si gjyqtar kryesues dhe 56 çështje si anëtar, kërkesa penale, masa sigurimi përgjime, 167 në tërësi. Ka përfunduar si kryesues 9 çështje penale; në vitin 2016 - 14 çështje penale si gjyqtar kryesues, kërkesa penale, masa sigurimi përgjime, 167, në tërësi 202 në tërësi. Ka përfunduar si kryesues 10 çështje penale si kryesues. Në vitin 2016 ka mbartur 4 çështje për vitin 2017. (*sipas Raportit të analizimit të aftësive profesionale, faqe 3*). Ndërkohë rezulton se ka përfunduar në gjithë periudhën e vlerësimit, sipas tabelave me të dhëna statistikore të administruara në faqen 312 deri 318 të dosjes së rivlerësimit, 217 çështje, nga të cilat 36 çështje me palë kundërshtare (*çështje penale themeli dhe çështje me objekt konfiskimin e pasurive në kuadër të Ligjit nr.10192 datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” i ndryshuar*).

Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabelat me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës së vlerësimit, mbetet e pamundur përlllogaritja e rendimentit sipas të dhënave statistikore që administrohen në dosje dhe, për pasojë, do të merret i mirëqenë rendimenti 98.4 % i përcaktuar në faqen 29 të Raportit, faqe 2396 e dosjes së rivlerësimit.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 98.4 %.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” gjyqtari pikëzohet me 8 pikë, pasi ky rendiment është në masën 98,4%.

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në sekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);
- Informacioni i përcjellë nga gjykata¹⁷ lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Referuar Raportit për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLGJ-së, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se: “..Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtari {...} i kushton rëndësi maksimale arsyetimit në kohë të vendimeve, pasi të gjitha vendimet që iu përkasin atyre dosjeve janë dorëzuar të arsyetuara në respektim të afatit ligjor. Duke konsideruar të dhënat e mësipërme, konstatohet se gjyqtari {...} ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë.”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Dosja 1, që i përket vendimit me nr. 145, datë 15.12.2014 është dorëzuar më datë 19.12.2014 (4 ditë);

Dosja 2, që i përket vendimit me nr. 40, datë 6.3.2015 është dorëzuar më datë 11.3.2015 (5 ditë);

Dosja 3, që i përket vendimit me nr. 47, datë 7.4.2016 është dorëzuar më datë 12/4/2016 (5 ditë);

Dosja 4, që i përket vendimit me nr. 11, datë 20.7.2016 është dorëzuar më datë 22.7.2016 (2 ditë);

Dosja 5, që i përket vendimit me nr. 411, datë 21.8.2014 është dorëzuar më datë 24.8.2014 (2 ditë);

Sipas informacionit të dërguar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar më datë 17.12.2020, lidhur me 6 dosjet e përzgjedhura me shortin e datës 3.11.2020, ora 9.30, rezulton se:

Dosja 6, që i përket vendimit me nr. 74, datë 23.6.2014 është dorëzuar më datë 27.6.2014 (4 ditë);

Dosja 7, që i përket vendimit me nr. 104, datë 2.12.2013 është dorëzuar më datë 4.12.2014 (2 ditë);

Dosja 8, që i përket vendimit me nr. 139, datë 1.12.2014 është dorëzuar më datë 1.12.2014 (0 ditë);

Dosja 9, që i përket vendimit me nr. 24, datë 18.2.2015 është dorëzuar më datë 23.2.2015 (5 ditë);

Dosja 10, që i përket vendimit me nr. 16, datë 3.2.2016 është dorëzuar më datë 5.2.2016 (2 ditë);

Dosja 11, që i përket vendimit me nr. 111, datë 26.9.2016 është dorëzuar më datë 29.9.2016 (3 ditë).

¹⁷ Informacioni i dërguar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nëpërmjet postës elektronike më datë 17.12.2020.

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit për kategorinë “kërkesa penale të fazës së hetimit paraprak” (dosja 4 dhe dosja 5) është 2 ditë. Për kategorinë penale krime koha mesatare e arsyetimit të vendimit për 9 dosje (dosja 1, 2, 3, 6,7,8,9,10,11) është 3 ditë.

Në KPRP në fuqi para ndryshimeve me Ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 10/ditor, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit. Në këto kushte në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10/ditor i ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë. Duke qenë se koha mesatare e dorëzimit të vendimit të arsyetuar nga ana e gjyqtarit në rastin konkret, është 2 ditë për një kategori dhe 3 ditë për kategorinë tjetër, ajo është më e shkurtër se gjysma e afatit të ankimit, çka vlerësohet si një shkallë e lartë kujdesi që gjyqtari ka treguar për arsyetimin në kohë të vendimeve.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi kjo kohë është më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve.

2.B. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JO-PRODUKTIVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga Inspektorati i KLD-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “..Gjyqtari {...} ka planifikuar dhe ka zhvilluar me korrektesë veprimet e duhura procedurale për zhvillimin dhe përfundimin e gjykimit në një afat të arsyeshëm kohor. Kështu në 2 dosje të vëzhguara, për vlefësim arresti dhe caktim mase sigurimi

si dhe masë sigurimi pasuror, vendosje sekuestro, kanë përfunduar në 1 seancë gjyqësore e cila ka qenë produktive, ndërsa numri i seancave gjyqësore për çështjet e themelit ka qenë i ndryshëm. Kështu doja 1 ka përfunduar me 2 seanca, që të dyja produktive; dosja 2 ka përfunduar me 5 seanca, nga të cilat 4 kanë qenë produktive; dosja 3 ka përfunduar me 12 seanca nga të cilat 7 kanë qenë produktive. Këto të dhëna tregojnë se në 21 seanca gjyqësore të vëzhguara, 15 kanë qenë produktive ndërsa 6 kanë qenë jo produktive...”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :

Nga 11 çështjet e përzgjedhura për vlerësim, 9 prej tyre janë çështje me palë kundërshtare dhe i përkasin kategorive “penale krime” ndërsa 2 prej tyre janë të kategorisë “kërkesa penale të fazës së hetimit paraprak”. Lidhur me numrin e seancave gjyqësore, për 9 çështjet të cilat vlerësohen si çështje me palë kundërshtare për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, rezulton si më poshtë:

Në çështjet e përzgjedhura me short, administruar në dosjen e rivlerësimit:

Dosja 1, çështja me nr. regjistri 180, datë regjistrimi 24.11.2014, nr. vendimi 145, datë vendimi 15.12.2014. Janë zhvilluar **2 seanca gjyqësore** të dokumentuara nëpërmjet procesverbalit të seancës, të dyja produktive;

Dosja 2, çështja me nr. regjistri 72, datë regjistrimi 8.1.2015, nr. vendimi 40, datë vendimi 6.3.2015. Janë zhvilluar **5 seanca gjyqësore**, nga të cilat 1 joproduktive dhe 4 produktive.

Dosja 3, çështja me nr. regjistri 49/201, datë regjistrimi 4.12.2015, nr. vendimi 47, datë vendimi 7.4.2016. Janë zhvilluar **12 seanca gjyqësore** nga të cilat 5 joproduktive dhe 7 produktive.

Në çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit:

Dosja 6, çështja me nr. regjistri 3/4/8/20/61, datë regjistrimi 23.4.2010, nr. vendimi 74, datë vendimi 26.3.2014. Janë zhvilluar **107 seanca gjyqësore**, nga të cilat 30 janë seanca produktive ndërsa 77 të tjera pas verifikimit të paraqitjes së palëve, relatimit të akteve të njoftimit, korrespondencës së kryer në institucionet përkatëse për njoftimin e të pandehurit, dëshmitarëve apo kryerjen e verifikimeve të urdhëruara nga gjykata, janë shtyrë për të bërë të mundur realizimin e njoftimeve, prezencën e prokurorit, mbrojtësve, njoftimin e rregullt të të pandehurit, pritjen e për ekzekutim të letërporosive, kryerjen e verifikimeve lidhur me faktin e vdekjes së viktimës, dhënien kohë palëve për t’u përgatitur lidhur me ecurinë procedurale të gjykimit (ndryshimin e akuzës etj), mos formim të trupit gjykues, njoftimin e të pandehurit lidhur me ndryshimin e kualifikimit ligjor të akuzës, akuzën e re të paraqitur gjatë gjykimit, etj.

Dosja 7, çështja me nr. regjistri 132, datë regjistrimi 28.10.2013, nr. vendimi 104, datë vendimi 2.12.2013. Janë zhvilluar gjithsej **3 seanca gjyqësore** produktive..

Dosja 8, çështja me nr. regjistri 158, datë regjistrimi 25.9.2014, nr. vendimi 139, datë vendimi 1.12.2014. Janë zhvilluar gjithsej **6 seanca gjyqësore** nga të cilat 3 kanë qenë jo produktive. Seancat janë shtyrë për shkaqe procedurale të përligjura të tilla si njoftimi dhe prezenca e mbrojtësit (2 seanca) dhe mosformim të trupit gjykues (1 seancë) dhe rezulton qenë çdo rast gjykata ka marrë gjithë masat e nevojshme për të siguruar vijimin e gjykimit në seancën vijuese.

Dosja 9, çështja me nr. 49/199 regjistri, datë regjistrimi 18.12.2014, nr. vendimi nr. 24, datë 18.2.2015. Janë zhvilluar gjithsej **5 seanca gjyqësore** nga të cilat 2 kanë qenë jo produktive. Seancat nuk janë zhvilluar ose janë shtyrë për shkaqe procedurale të përligjura (*mosparaqitja e*

prokurorit dhe mbrojtësit) dhe rezultojnë që çdo rast gjykata ka marrë gjithë masat e nevojshme për të siguruar vijimin e gjykimit në seancën vijuese.

Dosja 10, çështja me nr. 69 regjistri, datë regjistrimi 24.12.2015, nr. vendimi 16, datë 3.2.2016. Janë zhvilluar gjithsej **4 seanca gjyqësore** nga të cilat vetëm 1 seancë jo produktive, e shtyrë për të bërë të mundur prezencën e mbrojtësit të të pandehurit.

Dosja 11, çështja me nr. regjistri nr. 148 regjistri, datë regjistrimi 7.7.2016, nr. vendimi 111, datë 26.9.2016. Janë zhvilluar gjithsej **3 seanca gjyqësore** dhe rezultojnë vetëm një seancë jo produktive, e shtyrë për të mundësuar njoftimin dhe paraqitjen e mbrojtësit të të pandehurit.

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, rezultojnë se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtari në 9 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare (penale themeli) variojnë nga 2 (dosja 1) deri në 107 seanca gjyqësore (dosja 6). Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar 9 çështjeve të vëzhguara, rezultojnë të jetë 16 seanca gjyqësore. Nëse nga kjo përlllogaritje do të përjashtoheshin 107 seancat e zhvilluar gjatë gjykimit të çështjes që i përket dosjes 6, e cila ka zgjatur në kohë për shkaqet procedurale që nuk varen nga gjyqtari, analizuar më sipër në raport, numri mesatar i seancave gjyqësore për 8 çështjet e mbetura, rezultojnë të jetë 5 seanca.

Nga vëzhgimi i 9 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura (çështje themeli me palë) me short për vlerësim, rezultojnë se gjyqtari ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar në çdo rast ligjin procedural (neni 333 dhe 342/2 të K.Pr.P), përveçse kur distanca nga njëra seancë tek tjetra ka qenë më e largët se 15 ditë për shkak të pushimeve vjetorë në muajin gusht, për shkak të pritjes së Gjykatës së Lartë për t'u shprehur për konfliktin e kompetencës apo për pritjen e informacionit dhe ekzekutimit të letërporosive të dërguara nga gjykata (shih dosjen 6. Gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë, pavarësisht numrit të lartë të të pandehurve dhe mbrojtësve respektive, për shkak të natyrës së çështjeve, që ka sjellë si pasojë zhvillimin e një numri të lartë seancash në disa raste.

Në çështjet në të cilat seancat gjyqësore nuk janë çelur për shkak të mosformimit të trupit gjykues apo angazhimit të anëtarëve të trupit gjykues në aktivitete pune, rezultojnë që seancat vijuese të jenë planifikuar në një kohë shumë të afërt dhe janë marrë masa efektive për të siguruar vijimin pa vonesë të gjykimit. Në të gjitha rastet e tjera, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si njoftimi i të pandehurve, njoftimi i mbrojtësve të të pandehurve, njoftimi për të marrë pjesë i prokurorit, njoftimi i ekspertit psikolog për të asistuar të pandehurin e mitur, dërgimi i njoftimeve për komunikimin e akuzës së re si dhe ndryshimin e kualifikimit ligjor të saj, pritja për ekzekutimin e letërporosive të dërguara nga gjykata, etj. Në çdo rast të shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese sipas parashikimeve të nenit 342/2 të K.Pr.P, përveçse kur kjo ka qenë objektivist e pamundur.

Referuar sa më sipër, për treguesit e “*numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive*”, duke iu

referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 9 çështjeve¹⁸ të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është 16 seanca. Nëse në këtë llogaritje nuk do të përfshihet dosja nr.6, numri mesatar i seancave gjyqësore rezulton 5.

Pavarësisht numrit mesatar të seancave, gjyqtari në çdo rast ka treguar kujdes duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet. Shkaqet e shtyrjeve lidhen me kryerjen e veprimeve procedurale të domosdoshme sikundër ekzekutimi i letërporosisë, njoftimi i të pandehurit, mbrojtësve, dëshmitarëve..etj apo kushte procedurale që lidhen me pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit, të drejtën e prokurorit zëvendësues për tu njohur me aktet, formimin e trupit gjykues, njoftimin e akuzave të reja.. etj

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproduktive dhe administrimin e procesit në tëresi është e lartë, prandaj gjyqtari duhet të vlerësohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi numri mesatar i seancave gjyqësore në dosjet e analizuara, nuk vjen për shkaqe që janë përgjegjesi e gjyqtarit. Gjyqtari ka treguar shkallë të lartë aftësie në shmangien e seancave joproduktive.

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga Inspektorati i KLD-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi mjaft të mira për

¹⁸ Referuar Metodologjisë së Pikëzimit “Për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh (civile, administrative, penale, dhe sipas shkallëve të gjykimit), duke përfshirë ato pa palë ndërgjyqëse”.

planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Në të 5 çështjet gjyqësore, ai ka marrë masa për planifikimin e seancës gjyqësore në kohën e duhur, duke respektuar të drejtën e palëve për t'u përgatitur për gjykim. Në të 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar respektimi i afateve ligjore të nenit 333 të K.Pr.P në caktimin e seancës së parë, si dhe në dërgimin e njoftimeve për palët. Po ashtu, në rastet kur gjykimi është zhvilluar në më shumë se një seancë, ai ka planifikuar seancën e radhës në të gjitha rastet brenda afatit 15 ditor të përcaktuar nga neni 342/2 i K.Pr.P....Në çeljen e seancave ka patur edhe raste të fillimit me vonesë nga orari i planifikuar, por në rastet kur vonesa ka qenë mbi 15 minuta, shkak është relatuar rregullisht nga gjyqtari kryesues. Në një rast i është bërë vërejtje prokurores për ardhjen me vonesë në seancë. Megjithatë në asnjë rast vonesa në fillimin e seancës nuk ka shkaktuar dështimin e saj. Tre prej çështjeve të vëzhguara janë dokumentuar me regjistrim audio, në funksion të transparencës dhe solemnitetit të gjykimit. Gjatë gjykimit ai identifikon veprimet procedurale që duhet të kryen dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre. I kushton rëndësi të drejtave të palëve duke filluar nga e drejta e pjesëmarrjes, e drejta për tu mbrojtur, e drejta për përkthyes deri tek e drejta për të paraqitur prova dhe për të pasur një vendim të arsyetuar...”

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Nga 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, 9 prej tyre i përkasin kategorive të çështjeve me palë kundërshtarë dhe 2 çështje i përkasin kategorisë së kërkesave penale të hetimit paraprak.

Gjyqtari ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës së parë gjyqësore në çdo rast 0 deri 3 ditë pas caktimit të çështjes me short dhe në të njëjtën ditë me nxjerrjen e urdhrat të Kryetarit për formimin e trupit gjykues, duke respektuar afatin procedural 10 ditor të parashikuar nga neni 333/1 i Kodit të Procedurës Penale.

Seancat gjyqësore për 9 dosjet që i përkasin çështjeve të themelit, janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afatit procedural 15 ditor të parashikuar nga neni 342/2 i K.Pr.P, përveç rasteve të periudhës së lejes në muajin Gusht si dhe rastin e pritjes së Gjykatës së Lartë për t'u shprehur për çështjen e konfliktit të kompetencave (dosja 6), të cilat përbëjnë të vetmet raste të tejkalimit të afatit 15 ditor për caktimin e seancave në procesin penal. Në rastin e shqyrtimit të kërkesave së prokurorisë në lidhje me kërkesat penale të hetimit paraprak për vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi (dosja 5) dhe vendosjen e masës së sekuestros preventive në zbatim ligjit antimafia (dosja 4) gjykata ka marrë masa efektive për të mundësuar planifikimin dhe zhvillimin e seancave brenda afatit ligjor 48 orësh në rastin e vleftësimit të arrestit dhe 5 ditor në rastin e shqyrtimit të kërkesës për sekuestrimin e pasurisë.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur me regjistrim audio si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Seancat gjyqësore janë zhvilluar në mënyrë korrekte duke ndjekur ecurinë procedurale të gjykimit penal sipas parashikimeve të nenit 335 e vijues të K.Pr.P dhe 405 e vijues në rastet e

procedimit me gjykim të shkurtuar. Gjatë zhvillimit të gjykimit gjyqtari tregon kujdes të posaçëm për të relatuar regjistrimin e seancës në sistemin audio, relatimin e verifikimit të paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, marrjen e vendimeve për zhvillimin e gjykimit në mungesë sipas parashikimeve të nenit 351 dhe 352 të K.Pr.P, sipas rastit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar (gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar), administrimin e provave, dhënien e fjalës palëve për diskutimin përfundimtar, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (njoftimin e palëve, shoqërimin e të pandehurve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.).

Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes (*në rastet e disponimit për kërkesat paraprake të palëve, zëvendësimin ose jo të mbrojtësve që nuk janë paraqitur, shtyrjen e seancave, ndryshimin e cilësimit juridik të faktit penal apo paraqitjen e një akuze të re nga e prokurorisë, etj.*).

Në dosje te vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur përgjithësisht në orarin e caktuar, me përjashtim të ndonjë rasti të çeljes me vonesë me disa minuta, shoqëruar me relatimin e shkakat që ka pasjellë vonesën në çeljen e seancës, por nuk rezulton që seancat të mos jenë zhvilluar për shkak të kësaj vonese, përveç një rasti në të cilin seanca nuk është zhvilluar për shkak se tre nga pesë anëtarët e trupit gjykues kanë qenë duke zhvilluar një proces gjyqësor i cili për shkak të natyrës së tij komplekse, parashikohej që të zgjaste për një kohë të gjatë (dosja 8).

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 20 pikë.

2.C. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE

2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga Inspektorati i KLD-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të përzgjedhura me short u konstatua se ato përgjithësisht kanë qenë të rregullta, të sakta dhe të plota.”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e akteve i bën dosjet gjyqësore lehtësisht të aksesueshme duke përmbajtur aktin e shortit, urdhrin e formimit të turpit gjykues, vendimin e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet në rend kronologjik, provat e administruara për herë të parë në dosje për shkak të pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, procesverbalet e seancave sipas datave, diskutimet me shkrim të palëve dhe, sipas rastit provat bashkëlidhur bashkë me diskutimin përfundimtar në lidhje me personalitetin e të pandehurit dhe vendimin përfundimtar të gjykatës.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave). Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 5 pikë.

2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të përzgjedhura me short u konstatua se ato përgjithësisht kanë qenë të rregullta, të sakta dhe të plota..”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, evidentuar dhe përshkruar në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së, dhe më sipër në raportin e vlerësimit, rezulton se: “nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se ato kanë qenë të rregullta, të sakta dhe të plota..”

Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosjet gjyqësore të vëzhguara ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance, shkresat drejtuar institucioneve ndihmëse, vendimet gjyqësore) si dhe aktet e paraqitura nga palët (provat e administruara për herë të parë në seancë për shkak të zhvillimit të gjykimit të shkurtuar, diskutimet përfundimtare të palëve). Nuk konstatohet mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” është “shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	98

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

Lidhur me këtë nën kriter në raportin e Inspektoratit të KLD-së, konkluzionet se: “..Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave , rezulton se gjatë periudhës 3 vjeçare të rivlerësimit, për

gjiqtarin {...} janë paraqitur 2 ankesa (në vitin 2014), në Inspektoratin e KLD-së. Dy ankesat e paraqitura në vitin 2014, verifikuar bazuar në raportin periodik të vetë kryetarit në lidhje me vendimet e cenuara, i janë regjistruar gjyqtarit për vlerësim profesional dhe etik. Ndërsa nga të dhënat e regjistrit për procedimet disiplinore nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit {...}. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative në këtë aspekt”.

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarin {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk janë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Në raportet përkatëse të Inspektoratit të KLD rezulton se, shkak i referimit për t’u mbajtur në konsideratë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit ka qenë cenimi i vendimit nga gjykata më e lartë për mënyrën e zbatimit të ligjit në lidhje me:

- disponimin e gjykatës për mospranimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar si dhe refuzimin e kërkesës së një të dënuari për revokim të dënimit të tij me gjobë (materiali 1, i cili ka të bënë me vendimin nr. 13, datë 28.1.2013 dhe vendimin nr. 69, datë 14.11.2012, i cili është njëkohësisht një vendim që nuk bën pjesë në periudhën e vlerësimit);
- mënyrën e zbatimit të ligjit procedural në lidhje me mospranimin e kërkesës për procedime gjykim të shkurtuar (materiali 2);

Në relacionet e hartuara nga Inspektorati i KLD nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarit.

Ndërkohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 227, datë 17.1.2020, rezulton se KPK ka shqyrtuar dhe vlerësuar elementë që mund të ndikojnë në vlerësimin lidhur me etikën e gjyqtarit, të cilat pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit profesional, janë gjetur të pa bazuara.¹⁹

Për periudhën e vlerësimit tetor 2013-tetor 2016, gjatë së cilës ka filluar dhe përfunduar verifikimi nga Inspektorati i KLD-së, për dy vendimet e parashtruara në materialin 1 në të cilat gjyqtari ka pasur rolin e anëtarit, si dhe gjatë së cilës ka përfunduar gjykimi i 1 çështje të parashtruar në materialin 2, çështje në të cilën gjyqtari ka pasur rolin e kryesuesit të trupit

¹⁹ Shih faqen 59 dhe 60 të vendimit të KPK, administruar në dosje.

gjykues, nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe analizuara në relacionet përkatëse, nuk rezultojnë të dhëna që mund të analizohen dhe vlerësohen në drejtim të cënimit të etikës, pasi ato referohen vetëm si fakt që ndikon në përqindjen e vendimeve të cënuara, të cilat nuk përbëjnë burim më vete vlerësimi.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtarit në treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARIT

Lidhur me këtë nën kriter në raportin e Inspektoratit të KLD-së, konkludohet se: *“Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me integritetin e tij ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm..”.*

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLD;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarin {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Rezultoni të jenë paraqitur dy ankesa, referuar dhe analizuar në treguesin më sipër, të cilat janë verifikuar nga Inspektorati i KLD dhe janë referuar për t’u mbajtur në konsideratë për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit. Në materialet për verifikimin e ankesave rezulton se nuk janë konstatuar të dhëna që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga vendimin e KPK-së, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI-së dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, konkludohet se “*Trupi gjykues, referuar nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV, të nenit 51, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit, z. {...}: 64 a. ka kryer deklarin të mjaftueshëm dhe të saktë të pasurisë; b. nga analiza financiare rezulton se me të ardhurat e fituara nga punësimi tij dhe i personit të lidhur me të, si dhe huat ka pasur burime të mjaftueshme dhe të ligjshme financiare për kryerjen e investimeve dhe të shpenzimeve të deklaruara. Për sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. {...}, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.*”..

Në të njëjtën kohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 227, datë 17.1.2020, janë shqyrtuar dhe vlerësuar elementë në lidhje me integritetin e gjyqtarit, të cilat pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit figurës, janë gjetur të pa bazuara duke konkluduar se :”*Komisioni, pasi mori në konsideratë provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, shpjegimet e dhëna prej tij, si dhe hetimin e thelluar të kryer, arriti në përfundimin se: 1. Nuk u vërtetua që subjekti i rivlerësimit të ketë apo të ketë pasur, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte, kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimin të organizuar. 2. Nuk u vërtetua pjesëmarrja e subjektit të rivlerësimit, në pozicionin e anëtarit apo kryesuesit të trupës gjyqësore, në proceset gjyqësore me persona të dyshuar si të përfshirë në krimin e organizuar, duke hequr çdo dyshim mbi përfshirje të subjektit të rivlerësimit në veprimtari korruptive... 4. Subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës²⁰”.*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarit në treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 40 pikë.

3.C PAANËSIA E GJYQTARIT

²⁰ Faqe 51 e vendimit të KPK nr. 227, datë 17.1.2020.

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së konkludohet se: *“Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit...në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. në 2 raste është konstatuar se i pandehuri ka qenë i huaj dhe gjyqtari ka marrë masat për t’i garantuar të drejtën e mbrojtjes dhe të përkthimit, me referenca tek procesi i rregullt ligjor. Rastet e tjera nuk lidhen me çështje të tjera të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Nuk është konstatuar përdorimi i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjerë që vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. po ashtu nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar rregullat procedurale, me pasojë cenimin e parimit të gjykatës së paanshme.”*

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në 3 vendimet gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtari dhe aktet e 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të tij. Gjithashtu nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit. Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga gjyqtari.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit në treguesin “shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Të dhënat statistikore.

Në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga KLGJ, lidhur me kërkesat për përjashtim, konstatohet se; ”.. në pesë dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve.”

Nga analiza e burimeve të vlerësimi lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarit, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit.

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (11 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari) nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit.

Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, në kushtet kur në rastet e gradimit dispozitat e Ligjit për Statusin, zbatohen për aq sa është e mundur, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është i pakonsiderueshëm.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit Për këto arsye, për këtë tregues vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit duhet të vlerësohet si i pakonsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, për në treguesin “numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet si “i pakonsiderueshëm”.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (*kryesisht procesverbaleve të seancave, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore*) rezulton se gjyqtari, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë, transparent, i kuptueshëm. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi i tij është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve (*institucioneve të paraburgimit, drejtorive të policisë etj, për marrjen e masave për njoftimin apo shoqërimin e të pandehurve, zyrës së gjendjes civile, autoriteteve gjyqësore të huaja të cilave iu*

është drejtuar kërkesa për ndihmë juridike, etj) në aktet shkresore është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize, e saktë dhe e kuptueshme, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “komunikimi i qartë dhe transparent” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cënim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve të procedimit. Në një çështje në të cilën i pandehuri ka qenë në moshë të mitur, gjyqtari rezulton të ketë respektuar me korrektësi normat procedurale për pjesëmarrjen e tij në gjykim nën asistencën e mbrojtësit, psikologut dhe prindërve të të pandehurit (dosja 10), duke garantuar mbrojtjen e posaçme të të dhënave personale dhe konfidencialitetit. Gjithashtu, në çështjet në të cilat të pandehurit kanë qenë të huaj (vendimi 2 dhe dosja 1), gjyqtari ka marrë të gjitha masat për të siguruar përkthimin si dhe të drejtën e mbrojtjes së të pandehurve.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me këtë nën kriter në raportin e Inspektoratit të KLD-së konkludohet se “..Në 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit {...} për të bashkëpunuar me kolegët apo administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Rezultoi se në të gjitha rastet ku subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesë e një trupi gjykues të formuar nga pesë gjyqtarë, ai ka bashkëpunuar me ta dhe administratën gjyqësore për të zhvilluar seancën sipas rregullave procedurale. Po ashtu, nuk janë konstatuar vonesa në arsyetimin e vendimit dhe depozitimin e dosjes gjyqësore në sekretari.”.

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, burime vlerësimi janë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës së ndonjë të dhënë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave burimore për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, vlerësoj se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin) dy nga te burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar një burimi si dhe prezumimit se mungesa e të dhënave për trajtimin pa respekt të punonjësve të administratës gjyqësore, keqtrajtimin e tyre nëpërmjet fjalorit të papërshtatshëm, përjashtimit social ...etj, duhet të vlerësohet si shkallë e lartë komunikimi dhe bashkëpunimi të gjyqtarit me administratën gjyqësore.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera te vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivelin të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave të tjera për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, vlerësoj se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARIT PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

Lidhur me këtë nën kriter në raportin e Inspektoratit të KLD-së konkludohet se “..Subjekti i rivlerësimit {...}, për tre vitet e fundit, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit, i ngarkuar vetëm me çështje penale të krimit të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit, si dhe për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive. Nga viti 2012 e në vijim është në vazhdim të Shkollës së Doktoraturës, Departamenti i së Drejtës Penale, Fakulteti Juridik, Universiteti i Tiranës, në proces mbrojtje të titullit “Doktor”. Subjekti i rivlerësimit {...}, për shkak të funksionit të gjyqtarit të shkallës së parë, i nënshtrohet detyrimit programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Të dhënat tregojnë se ai ka qënë shumë i gatshëm për t’u angazhuar në aktivitete profesionale....Së fundmi, duhet evidentuar se gjyqtari {...} ka qënë aktivizuar dhe si pedagog i jashtëm i Sh.M, ekspert trajnues, udhëheqës stazhi e mbrojtje teme diplome, anëtar i komisionit të hartimit të tezave e të korigjimit të provimit të pranimit. Për shkak të funksionit, është aktivizuar dhe në përbërje të Komisionit të KLD-së për mbrojtjen e gjyqtarëve, në përbërje të Bordit Drejtues të Zyrës së Administrimit Gjyqësor si dhe në angazhime të tjera për shkak të detyrës.”.

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARIT NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDIET TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së, vërtetimit me nr. 454/1 prot datë 18.10.2016 të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetë deklaramit për aftësitë profesionale të gjyqtarit së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se ai ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e ekspertit dhe pjesëmarrësit.

Konkretisht, referuar akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit dhe vërtetimit me nr. 454/1 prot datë 18.10.2016 të Shkollës së Magjistraturës, gjyqtari {...} është angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e ekspertit në 11 aktivitete trajnuese, gjithsej 15 ditë dhe në cilësinë e pjesëmarrësit në 15 aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 24 ditë trajnimi.

Duke iu referuar nenit 55, pika 9²¹ të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në programimin e trajnimit vazhdues në cilësinë e trajnerit ose lehtësuesit ka vlerë edhe për efekt të përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e programit të trajnimit vazhdues duke u përlllogaritur 1 ditë pjesëmarrje si trajner e barabartë me 2.5 ditë si pjesëmarrës dhe 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues me 2 ditë si pjesëmarrës. Referuar këtij parashikimi, rezulton se gjyqtari {...}, gjatë periudhës tre vjeçare të vlerësimit ka marrë pjesë në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës për 61.5 ditë në gjithë periudhën e vlerësimit.

Rezulton gjithashtu se gjyqtari ka marrë pjesë në 21 aktivitete profesionale, gjithsej 50 ditë, jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës të cilat, rezultojnë të jenë aktivitete të formimit profesional, 15 prej tyre (seminar, konferencë, simpozium) si dhe aktiviteteve ndërinstitucionale të tilla si vizita studimore, mbledhje ekspertësh, tryeza të rumbullakëta, etj.

Sa më sipër, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në 41 aktivitete trajnuese, në programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe jashtë tij, të cilat kanë zgjatur në tërësi për 93.5 ditë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht të për tema që i përkasin së drejtës penale dhe procedurale penale, hetimit pasuror, pastrimit të produkteve të veprës penale, terrorizmit etj, gjithsej 41 aktivitete të zhvilluara për 93.5 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tre vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Sh. M dhe trajnime të tjera profesionale është më shumë se 15/ditë dhe më pak se 120 ditë, duke u pikëzuar me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARIT PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

²¹Në nenin 55, pika 9 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës parashikohet se :”Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përlllogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë:

- 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrje në trajnim.

Ky kontribut vlen vetëm për përlllogaritjen e ditëve si pjesëmarrës në Formimin Vazhdues dhe nuk sjell efekte financiare.”.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtarit në veprimtari trajnuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklaramentit për aftësitë profesionale të gjyqtari, rezulton se ai është angazhuar në programin e formimit vazhdues së Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e ekspertit në 11 aktivitete trajnuese brenda Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në 21 aktivitete të tjera jashtë këtij programi. Gjithashtu, rezulton se gjyqtari {...} është angazhuar në cilësinë e pedagogut të jashtëm të Shkollës së Magjistraturës, kohë gjatë së cilës ka qenë udhëheqës stazhi dhe udhëheqës në tema diplome (*Raporti i analizimit të aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së, faqe 33 si dhe të dhënat e dosjes personale të gjyqtarit*).

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtarin {...}, duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij në cilësinë e ekspertit në disa aktivitete trajnuese në Shkollën e Magjistraturës si dhe angazhimi i e tij në cilësinë e pedagogut të jashtëm në Sh. M, për shkak të së cilit ka qenë udhëheqës në tema diplome dhe stazhin profesional të kandidatëve, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si ekspert dhe njëkohësisht, rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë stazhit profesional.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, për treguesin “disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARIT NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në formularin e vetëdeklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtari, është referuar për angazhimin e tij në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë apo veprimtari të tjera të tilla si pjesëmarrje në konferenca shkencore, mësimdhënie, etj. Konkretisht rezulton angazhimi i gjyqtarit në disa aktivitete profesionale të cilat vlerësohen si veprimtari ndër-institucionale që kanë pasur si qëllim shkëmbimin e eksperiencave në fushën e së drejtës, si më poshtë:

- Vizitë studimore në Gjykatën e Palermos, Seksioni për Konfiskimin Pasuror, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Konfiskuara, organizuar nga projekt TAIEX i Komisionit Evropian, datë 4-6 mars 2013;
- Vizitë në Mbretërinë e Bashkuar, organizuar nga fondacioni SLYNN, datë 8-12 dhjetor 2013;
- Mbledhje e Ekspertëve në kuadër të projektit Matra Coprol e organizuar nga Ministria e Jashtme Hollandeze, 11 maj 2014;
- Vizitë studimore në Hagë, organizuar nga Komitetit Hollandez i Helsinkit, Shkolla Gjyqësore U3, projekti Matra Coprol, 31 janar-5 shkurt 2015;
- Vizitë studimore në Këshillin e Evropës dhe pjesëmarrje në mbledhjet e Komitetit Saturn, për menaxhimin e kohës gjyqësore, projekti CEPEJ, 30-31 mars 2015;

Gjithashtu, duke iu referuar Raportit të Inspektoratit të KLD-së, formularit të vetëdeklarimit të gjyqtarit, rezulton angazhimi i tij në përbërje të Komisionit për Mbrojtjen e Gjyqtarëve pranë KLD dhe në përbërje të Bordit Drejtues të Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtarin {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në veprimtari ndër institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, për treguesin “angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtari pikëzohet me 5 pikë.

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Sipas formularit të vetëdeklarimit²² për aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit dhe dosjen personale të gjyqtarit, rezulton se, gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtari ka realizuar publikime ligjore akademike me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës si më poshtë:

- Botim shkencor në Revistën Shkencore Ndërkombëtare “International of Clinical Toxicology”, 2013, 27-30, mbi mjekësinë toksikologjike në gjykatat shqiptare, bashkautor. Kjo revistë shkencore ndërkombëtare ka bord editorial e pajisur me numër identifikimi ISSN.

KONKLUZIONI

Pavarësisht se është vetëm një botim, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, tipologjise dhe impaktit të botimit shkencor, për gjyqtarin {...} ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, për treguesin “publikime ligjore akademike” gjyqtari pikëzohet me 5 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”

KRITERI	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

²²Formulari i vetëdeklarimit, faqe 7 dhe 8 si dhe kopje e publikimeve bashkëlidhur formularit.

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	98	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	100	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	398	Shkëlqyeshëm